

◊  
KONTROLLI I LARTË I SHTEJTIT  
◊

# RAPORT

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË  
KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Tiranë, 2016



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT MBI LIGJSHMËRINË DHE**  
**RREGULLSHMËRINË FINANCIARE TË USHTRUAR NË**  
**KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE.**

Auditimi është kryer ne bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.1131/1.prot., datë 15.12.2015, i ndryshuar, me objekt: “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”.

Auditimi është kryer nga:

1. ...
2. ...
3. ...

Auditimi ka filluar më, 15.12.2015

Auditimi ka përfunduar më, 25.03.2016



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

	<b>Faqe</b>
<b>PERMBAJTJA</b>	
<b>Përmbledhje</b> .....	3-13
<b>Hyrje</b> .....	4-13
<b>Rezultatet e auditimit</b> .....	13-90
I. Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.....	13-15
II. Në lidhje me hartimin e zbatimit të buxhetit.....	15-27
III. Mbi auditimin e zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	28-37
IV. Mbi auditimin e administrimit të pronës shtetërore. Zbatimi dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	37-43
V. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit .....	43-45
VI. Mbi auditimin e procedurave të prokurimeve publike.....	45-81
VI.1. Mbi auditimin e procedurave të prokurimeve publike për vitin 2014 dhe 2015.....	45-49
VI.2. Mbi auditimin e dy Projekteve ( SEV dhe SEN).....	49-81
VII. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm .....	82-98
VIII. Të ndryshme.....	89-90
<b>Rekomandimet</b> .....	90-98



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

**Përmbledhje**

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ( KQZ), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me administrimin dhe menaxhimin financiar dhe të përdorimit të fondeve publike për aritjen e objektivave të këtij institucioni në zbatim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Programimit dhe zbatimit të buxhetit të institucionit. Administrimit të pronës publike, materialeve zgjedhore dhe procedurat e prokurimit të fondeve publike. Gjithashtu sipas shkresës së Kryetarit të KLSH nr. 1131/4, datë 15.03.2016, “Për një ndryshim në Programin e Auditimit nr 1131/1, datë 11.12.2015” është parashikuar dhe u auditua zbatimi i procedurave të prokurimit për dy projekte ( të filluara nga viti 2012 dhe të përfunduara gjatë vitit 2013) që nga faza e prokurimit deri në atë të implementimit e që kanë të bëjnë me projektin e ngritjes së Sistemit Elektronik të Verifikimit në Qarkun e Tiranës, e cila këtu e më poshtë do të quhet (SEV) dhe ngritjen e Sistemit Elektronik të Numërimit në Qarkun e Fierit e cila këtu e më poshtë do të quhet ( SEN ).

Gjatë viteve të fundit subjekti është audituar nga KLSH dhe në përfundim të auditimit të kaluar, krahas të metave dhe mangësive të konstatuara janë bërë rekomandimet përkatëse, e konkretisht në ripunimin e rregullores së brendshme të institucionit të KQZ, në përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar, në evadimin e mallrave stoqe e me qarkullim të ngadalshëm të krijuara në periudhat e mëparshme si rrjedhojë e ndryshimeve të procedurave zgjedhore etj.

**Procesi i auditimit, u krye sipas drejtimeve të mëposhtme:**

1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm ushtruar nga KLSH
2. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
3. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.
4. Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin. ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.
5. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
6. Auditimi për prokurimin e fondeve publike.
7. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
8. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit.

**Objektivat e auditimit:**

Në zbatim të programit të auditimit objektivi kryesor është dhënia e një opinioni nëse nga strukturat përkatëse të këtij institucioni fondet e akorduara nga buxheti i shtetit në funksion të kësaj veprimtarie, janë përdorur konform akteve ligjore në fuqi dhe në mënyrë efektive.

**Kriteret e vlerësimit:**

Kriteret e vlerësimit bazohen në procedurat e përcaktuara nga Ministria e Financave në funksion të vetëvlerësimit, në zbatim të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

**Hyrje**

Në zbatim të Programit të Auditimit nr 1131/1, datë 11.12.2015, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, u krye auditimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Kryetarja z. [ ] me objekt auditimi "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare".

Auditimi u krye nga data 15.12.2015 deri më datën 25.03.2016, sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e auditimit, të ndryshuar, për periudhën e veprimtarisë së ushtruar nga subjekti i audituar (KQZ) nga data 01.01.2014 deri më datën 31.12.2015, si dhe shtesës së programit të auditimit nr. 1131/4, datë 15.03.2016, mbi auditimin e procedurës së prokurimit të tenderit me objekt: "Realizimin e Sistemit Elektronik të Verifikimit të kartave të identitetit në Qarkun Tiranë (SEV) dhe Sistemin Elektronik të Numërimit të votave në Qarkun Fier (SEN).

Misioni i auditimit u realizua me objekt: "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit financiar". Gjatë këtij auditimi janë verifikuar sipas rastit dokumentacioni i plotë (njëpasnjëshëm) dhe me zgjedhje. Përveç auditimit të dokumentacionit auditimi është bazuar edhe në këshillimin dhe ballafaqimet me stafin administrativ të subjektit të audituar.

Në përfundim të auditimit me personat përkatës dhe ato përgjegjës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, u mbajtën aktverifikime dhe procesverbale, për të cilat pasi u shqyrtuan vërejtjet dhe shpjegimet e këtyre punonjësve, duke u marrë në konsideratë ato që kishin argumentim e mbështetje ligjore, u përgatit Projektraporti i Auditimit i cili u dërgua në KQZ me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.1131/9 datë 18.04.2016. Në lidhje me Projektraportin e Auditimit nga personat e atakuar u dërguan observime me shkresat nr. 226/12, datë 17.05.2016 (Protokolluar në KLSH me nr. 1131/11, datë 17.05.2016), observime këto të bëra nga: Kryetarja e KQZ znj. [ ]

Observime janë bërë me shkresën e datës 17.05.2016 dhe nga [ ] (protokolluar në KLSH me nr. 1131/12 datë 17.05.2016).

Observacione janë dërguar nga znj. [ ] me detyrë Drejtore e Sistemeve Informatike pranë Ministrisë së Brendëshme me shkresën nr.1921/3 datë 22.04.2016 ( e protokolluar në KLSH me nr. 1131/10 datë 25.04.2016).

Me personat e atakuar në Projektraportin e Auditimit u organizua një takim përmbyllës e ballafaques. Ky takim u zhvillua në datë 01.06.2016 ora 11.00 në ambientet e KLSH ku merrnin pjesë: [ ]

[ ] (si në objeksionet e bëra prej saj ndaj procesverbalit ashtu dhe të Projektraportit të Auditimit) se nuk është thirrur më parë për tu takuar nga grupi i auditimit por dhe nga pretendimet e ringritura për këtë çështje nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016, të organizuar në ambientet e KLSH, nga ana e KLSH nëpërmjet shkresës së Sekretares së Përgjithshme të [ ]

Nisur nga, pretendimet e titullares së KQZ z. [ ] (si në objeksionet e bëra prej saj ndaj procesverbalit ashtu dhe të Projektraportit të Auditimit) se nuk është thirrur më parë për tu takuar nga grupi i auditimit por dhe nga pretendimet e ringritura për këtë çështje nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016, të organizuar në ambientet e KLSH, nga ana e KLSH nëpërmjet shkresës së Sekretares së Përgjithshme të [ ]



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

KLSH me nr.1131/12 datë 03.06.2016 ju kërkua dhe ju shpreh gadishmëria z. për takim, nëse ajo dëshironte, në KLSH deri në datën 08.06.2016. Kjo kërkesë me shkrim u bë pavarësisht se në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ u konsiderua e tepërt kërkesa me shkrim pasi ai merrte përsipër që këtë kërkesë dhe gadishmëri për takim të KLSH t'ia përcillte titullares së institucionit të KQZ.

Deri më datë 08.06.2016 znj. \_\_\_\_\_ nuk u paraqit në takim.

Pas takimit përmbyllës, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ me shkresën nr. 226/13, datë 02.06.2016 ( nr. 1131/13, datë 03.06.2016 në KLSH) u dërguan dokumentacion shtesë për të mbështetur pretendimet e tyre.

**Këto materiale dokumentare janë:**

**Vendimi i KQZ nr.589 datë 18.06.2013** "Për zbatimin e procedurave të identifikimit dhe regjistrimit të pjesmarrësve në zgjedhjet e datës 23.06.2013 në mënyrë manuale dhe mos aplikimin e teknologjisë elektronike për këtë qëllim SEV, në Qarkun e Tiranës".

**Vendimi i KQZ nr. 22, datë 28.12.2012** "Për emërimin e dy auditëve teknikë" z. \_\_\_\_\_ propozuar nga Kryetarja e KQZ si dhe z. \_\_\_\_\_ propozuar nga zëvendëskryetari i KQZ.

**Vendimin e KQZ nr. 166, datë 22.02.2013** "Për caktimin e masës së shpërblimit për audituesit teknikë".

**Udhëzimin e KQZ nr.2, datë 28.12.2012** "Për miratimin e rregullave për kryerjen e auditimit për verifikimin e të dhënave të regjistrit kombëtar të gjendjes civile ( RKGJC) dhe në (SEV).

**U paraqitën gjithashtu:**

**Raporti i Audituesit teknikë të KQZ z. \_\_\_\_\_** "Mbi testin e zhvilluar më datë 08.06.2013 për SEV Qarku Tiranës. Drejtuar ky Raport KQZ i protokolluar në KQZ me nr. 5412, datë 16.06.2013, Kur në fakt vetë Raporti mban datën 17.06.2016!?!".  
**Shkresë Kthim përgjigje drejtuar KQZ nga audituesi teknikë z. \_\_\_\_\_** protokolluar në KQZ me nr. 544, datë 18.06.2013.

**Koment i KLSH mbi këto materiale të dërguara:**

Nga ana e përfaqësuesve të KQZ në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016 të zhvilluar në ambientet e KLSH u pretendua se, disponoheshin Raporte të audituesve teknikë të emërtuar nga KQZ. Ky pretendim kishte të bënte me konkluzionet e KLSH përsa i përket sistemit SEN të Qarkut Fier dhe në fakt dërgojnë (Raporte auditimi) materiale që i përkasin Sistemit SEV të Qarkut Tiranë. Gjë që ngarkon këto persona me përgjegjësi. Pasi krijon përshtypjen se bëhet me qëllim krijimin e tymnajave në punën audituese. Gjithashtu megjithëse KLSH as nuk është shprehur dhe as nuk e sheh të nevojshme për tu shprehur në lidhje me këto dy "Raporte" pasi ato janë bërë mbi bazën e dokumentacioneve shkresore dhe jo nga auditimi në terren i provave. Megjithatë nuk mund të kaloj pa u evidentuar fakti se një Raport i audituesit teknikë (i propozuar nga Kryetarja e KQZ) përgatitet më datë 17.06.2013 dhe protokollohet në KQZ me datë 16.06.2013!?!?. Po ashtu mjafton të lexosh dhe "Raportin" e audituesit tjetër teknikë dhe konstatohet lehtësisht se në mënyrë të përmbledhur është në të njëjtën linjë me ato që ka konstatuar dhe Auditimi i KLSH në lidhje me Sistemin SEV të Qarkut Tiranë.

**Janë dërguar nga KQZ dhe: pesë CD me pamje filmike dhe fotografike nga provat e SEV dhe SEN.**

**Koment i KLSH mbi këto materiale të dërguara:**



KONTROLLI I LARTË I SHETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

*Në lidhje me këto materjale mund të konstatohet se, ato mund të shërbejnë për dokumentim vetëm të faktit se janë zhvilluar provat por nuk sjellin asnjë fakt teknik për zhvillimin e tyre. KLSH në auditimin e tij si dhe në këtë Raport Përfundimtar Auditimi nuk ka pretenduar që nuk janë zhvilluar provat e këtyre dy Projekteve ( SEN dhe SEV) por ka pretenduar dhe vazhdon të pretendoj se ana e auditimit teknik të tyre nga KQZ ka qenë jashtë kontrollit. Gjë që vihet re dhe në këto materjale. Në këto CD për Projektin SEV të Qarkut Tiranë nuk tregohet në asnjë vend leximi i Chipave ( me dhe pa kontakt). Shihet në një rast leximi i MRZ (vetëm për një kartë ID)  
Në të tilla kushte këto objeksione (si dokumentare dhe CD) nuk shërbejnë për të hedhur poshtë pretendimet e ngritura nga Grupi i Auditimit të KLSH por në të kundërt.*

Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha vërejtjeve, observimeve e pretendimeve të bëra nga ana e subjektit të audituar dhe personat e atakuar si dhe rishikimit të materjaleve nga ana e KLSH u përgatit ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

**Auditimi u krye mbështetur në:** dispozitat ligjore që rregullojnë funksionimin e KLSH dhe KQZ, e konkretisht: Ligji nr 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave për buxhetin, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, VKM nr. 446, datë 27.04.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 475, datë 13.07.2007, VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” dhe Rregullorja e funksionimit të KQZ, VKM nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen zhvillimin, prodhimin bashkëprodhimin e programeve, spoteve publicitare a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohën e transmetimit, nga organet e administratës shtetërore”, ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Urdhri i Ministrit të Financave nr, 23, datë 24.02.2011 “Mbi përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” etj.

#### **GJETJE NGA AUDITIMI**

**1. Nga auditimi i llogaritjes së raporteve mjekësore për vitet 2014 dhe 2015, rezultoi se: nuk është mbajtur tatimi për raportet mjekësore.** Vlera e përlllogaritur e raporteve mjekësore shtohet në fund, pasi pagës i ish-in mbajtur tatimi mbi pagën, sigurimet shoqërore/shëndetësore e suplementare për ditët që punonjësi kishte qenë në punë. Pra në rast se punonjësi ka marrë raport nën 14 ditë, pagesë e cila përballohet nga fondi i pagave të KQZ-së, nuk është bashkuar me pagën e përfituar nga puna, në mënyrë që tatimi të llogaritet për të dy këto të ardhura. Kjo mënyrë llogaritje është në kundërshtim me nenin 8 “E ardhura e tatueshme” pika “a” të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe pika 2 “Tatimi mbi të ardhurat personale”, pika 2.3 “Të ardhurat e tatueshme”, pika 2.3.1 të Udhëzimit nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

2. Nga auditimi u konstatua se: Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së është nëpunës Autorizues, në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe koordinator risku pasi kjo kompetencë rezulton se nuk është deleguar. Në zbatim të nenit 21 të këtij ligji, konstatohet që nuk ka pasur një procedurë konkrete për formalizimin dhe dokumentimin e procedurave për menaxhimin e riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit. Është treguar kujdes vetëm në disa raste specifike dhe kryesisht të lidhura me administrimin e procesit zgjedhor. Nga auditimi konstatohet se për vitin 2014 nuk ka një regjistër risku për këtë institucion duke mos përmbushur kështu nenin 8, pika 8/a të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ku shprehet qartë se *“Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: Hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ato drejtojnë, të planeve strategjike vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planveprimeve për arritjen e objektivave”*.

3. Nga auditimi u konstatua se: Listëpagesat e dorëzuara në thesar nga ana e KQZ janë të nënshkruara nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe nga Drejtori i Financës por nuk janë të nënshkruara nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore në kundërshtim kjo me pikën 69, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* trajtuar më hodhësisht në pikën III të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi”.

4. Nga auditimi u konstatua se: Sipas memorandumit të bashkëpunimit me nr. 518, datë 15.04.2014 midis KQZ dhe USAID është nënshkruar marrëveshja me kompaninë Maqedonase *“MARRËVESHJA”* me objekt: *“Të përshkruajë rolet, rezultatet dhe përgjegjësitë që lidhen me zbatimin e softwareve-it në programin AlbERT, përditësimin të administrimit të zgjedhjeve lokale për KQZ të planifikuara gjatë periudhës Prill-Shtator 2014”*.

Në përfundim të shërbimit të kryer nuk është llogaritur dhe ndalur tatimi në burim në masën 15 % mbi të ardhurat e realizuara në shumën prej **789,031 lekë**, si subjekt i pa regjistruar në QKR për kohën që do ushtrojë këtë veprimtari dhe për sa kohë që nga ana e KQZ-së nuk janë plotësuar praktikatat për përfitimin e përjashtimit bazuar në Marrëveshjen e eliminimit të taksimit të dyfishtë midis Shqipërisë dhe Maqedonisë. Faturat e paraqitura nga shoqëria e kontraktuar janë të printuara në format letër model A4, pa asnjë të dhënë që të provojë miratimin nga shteti Maqedonas, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar, neni 4, germa “h”, ku përcaktohet se: *“të ardhurat e realizuara nga shërbimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një person jorezident”*, dhe neni 33, pika 4, ku përcaktohet se: *“Një tatimpagues jorezident, i cili përfiton të ardhura si ato të përmendura në shkronjat “d”, “dh” ose “e” të paragrafit të parë të këtij neni, mund të tathohen njëjloj si në rastin kur këto të ardhura të ishin përfituar në ndjekjen e një veprimtarie të ndërmarrë prej tij nëpërmjet një njësie të përhershme në Republikën e Shqipërisë”* dhe me udhëzimin e ministrit të financave nr. 5, datë 30.01.2006 *“Për Tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”* me ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014, neni 9, *“Tarifat tatimore”*, pika 2.4 *“Të ardhura të tatueshme”* ku është përcaktuar se, të ardhurat e tjera që nuk përfitohen ndryshe në dispozitat të tjera të këtij ligji tathohen në masën 15 %.

5. Nga auditimi për shpenzimet e kryera nëpërmjet veprimeve të bankës për periudhën objekt auditimi prej datës 01.01.2014 deri 31.12.2015, u konstatua se,  
... ka përfituar bonus për shpenzime transporti gjithsej në vlerën prej 495,000 lekë, pagesë e cila nuk është bashkuar me pagën mujore dhe nuk është llogaritur dhe ndalur





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

tatimi në burim në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, neni 9, "Tarifat tatimore" ku është përcaktuar se:

*"Pagat dhe shpërblimet, në lidhje me marrëdhëniet e punës aktuale, do të taten sipas tarifave të përshkruara në pasqyrën nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji, dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar ku përcaktohet se: "Tatimi mbi të ardhurat personale, përfshin të gjitha llojet e të ardhurave të individëve, të parashikuara në këtë ligj, neni 7 "Shtrirja e detyrimit", si rrjedhojë e këtij veprimi të ardhurat e përfituara nga bonusi nuk janë llogaritur dhe ndalur tatimi në burim në masën 23%, duke sjellë si pasojë shmangie nga detyrimet tatimore në vlerën 109,150 lekë.*

6. Nga auditimi mbi respektimin e dispozitave ligjore për auditimin e fondeve buxhetore për financimin e veprimtarisë së partive dhe shpenzimeve në zgjedhjet vendore 2015, subjektet zgjedhore pjesëmarrëse janë financuar në vlerën 65,000,000 lekë. Shpërndarja e këtij fondi është bërë në bazë të nenit 87/2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, sipas të cilit janë financuar 61 subjekte politike. Në përfundim të rillogaritjeve KQZ ka përcaktuar se 46 subjekte duhet të kthejnë vlerën prej 11,688,138 lekë, si diferencë midis paradhënies së përfituar dhe vlerës që ka dalë nga rillogaritja e rezultatit sipas grumbullimit të votave në fakt në zgjedhjet vendore.

Nga këto; 31 subjekte politike që nuk kanë kaluar pragun 0.5 %, duhet të kthejnë vlerën prej 2,583,323 lekë, dhe 15 subjekte të tjera ndonëse kanë kaluar pragun pas korigjimit të rezultatit duhet të kthejnë vlerën prej 9,104,825 lekë.

Nga të dhënat që disponon KQZ, konstatohet se, subjektet zgjedhore (partitë politike) fituese që u ka lindur e drejta të përfitojnë më shumë se paradhënia, nuk kanë kërkuar të bëhen veprimet e rillogaritjes për kthimin e paradhënies nga partitë që janë në koalicion ndonëse nuk kanë kaluar pragun zgjedhor.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, pasi nuk penalizon partitë që nuk kalojnë pragun zgjedhor, duke ndihmuar në mënyrë artificiale subjektet zgjedhore (partitë) për moskthimin e fondeve publike të përfituara padrejtësisht. Kjo mënyrë funksionimi sjell si pasojë që këto parti jo vetëm të mos penalizohen apo mos regjistrim në zgjedhjet pasardhëse, por edhe të ndikojnë në mënyrë indirekte në rritjen e kostos së zgjedhjeve pasardhëse, si dhe të shpenzimeve të tjera që lidhen me hartimin dhe printimin e fletëve të votimit.

7. Nga auditimi i raporteve të auditimit të subjekteve zgjedhore, ekspertët kontabël ndonëse kanë evidentuar se, shpenzimet janë kryer konform dispozitave ligjore, në disa raste shpenzimet nuk i kanë evidentuar sipas natyrës dhe destinacionit të përdorimit të tyre e konkretisht: Për shpenzimet blerje "pajisje të ndryshme kompjuterike", nuk ka të dhëna në se janë dokumentuar dhe kontabilizuar në aktiv të bilancit kontabël të subjektit të audituar. Kështu përmendim; auditimin e kryer nga znj. \_\_\_\_\_ në subjektin zgjedhor "Partia

Demokristiane Shqiptare" për blerje pajisje kompjuterike në shumën 247,920 lekë, apo shpërblime të ndryshme në shumën 292,000 lekë për të cilat nuk është evidentuar në se është bërë veprimi kontabël në aktivet e subjektit apo mënyra e pagesës për shpërblime, tatimi i ndalur në burim dhe i xhiruar në degën e tatim Taksave, duke lënë shteg që shpenzimet të mos pasqyrojnë realitetin për të cilat janë financuar, dhe evazion fiskal për të ardhurat tatimore.

8. Nga auditimi u konstatua se: Nga disa ekspertë kontabël, pasqyrat e shpenzimeve janë nënshkruar në mënyrë të njëanshme vetëm nga eksperti kontabël, pa u konfirmuar nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

financierët e partive politike, për të justifikuar kryerjen e auditimit në prani të subjektit zgjedhor, në kundërshtim me standardet e auditimit, ndër të cilat përmendim raportet e auditimit të subjekteve zgjedhore; "Partia e Ballit Kombëtar", "Partia Demokratike e re Europiane" dhe "Partia Socialiste e Vërtetë 91".

9. Nga auditimi u konstatua se: Në raportin e auditimit të hartuar nga ekspertja kontabël konstatohet se, "Partia Balli Kombëtar" ka përfituruar fonde nga buxheti i shtetit në shumën 875,920 lekë, të cilat janë depozituar në llogarinë bankare. Sipas të dhënave të raportit të auditimit, janë përdorur vetëm 250 lekë "shpenzime për komision bankar". Në raportin e auditimit nuk ka të dhëna në se janë verifikuar burime të tjera të të ardhurave, pasi audituesja shprehet se, "kjo parti nuk ka përdorur shpenzime në fushatën zgjedhore". Nga rillogaritjet e kryera në përfundim të zgjedhjeve, Partia "Balli Kombëtar", duhet të rikthejë shumën prej 237,515 lekë, të cilat nuk i ka rikthyer me kalimin e afatit 90 ditor të përcaktuar në kodin zgjedhor.

10. Nga auditimi u konstatua se: Në raportin për auditimin e "Partisë për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë" paraqitur nga eksperti kontabël konstatohet se, ky subjekt zgjedhor nuk ka përfituruar fonde publike, sponsorizime apo donacione nga individë apo subjekte të ndryshme. Me ekspertin kontabël është lidhur kontrata nr. 7760, datë 07.10.2015, për 25 orë auditim në vlerën prej 75,000 lekë. Sipas aneksit bashkëlidhur raportit për "Auditimin e Partisë për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë", janë shpenzuar 10 orë pune dhe jo 25 orë që janë parashikuar në kontratën e lidhur me Ekspertin Kontabël.

Këto të dhëna tregojnë se ka munguar rakordimi midis të dhënave të kontratës dhe dokumentacionit të paraqitur nga eksperti kontabël protokolluar me nr. 7910/1, datë 11.11.2015, për faktin se midis këtyre dy programimeve ka diferencë të pajustificuar për 15 orë në vlerën 45,000 lekë.

11. Nga të dhënat e raporteve të auditimit konstatohet se, edhe në ato raste që subjektet politike zgjedhore kanë përfituruar paradhënie në vlerën prej 83,333 lekë dhe nuk kanë kryer asnjë shpenzim, vlera e përfituruar paradhënie është gjendje në llogarinë rrjedhëse bankare të subjektit. Në këto raste eksperti kontabël nuk ka rekomanduar pranë KQZ, për të marrë masa të menjëhershme për bllokimin e llogarive të tyre pranë bankës ku janë depozituar; kështu përmendim auditimin e kryer tek "Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë" dhe "Partia Ardhmëria Shqiptare" të cilat kanë përfituruar respektivisht nga buxheti 83,333 lekë dhe në përfundim kjo vlerë nuk është përdorur por është gjendje në llogarinë bankare të subjektit zgjedhor dhe nuk është rikthyer vlera e përfituruar paradhënie prej 83,333 lekë brenda 90 ditëve në KQZ.

Për auditimin e këtyre subjekteve ekspertët kontabël kanë shpenzuar 1,423 ore auditim në vlerën prej 4,239,000 lekë, respektivisht; 992 ore pune në vlerën 2,976,000 lekë për auditimin e partive politike që janë financuar minimalisht në vlerën prej 83,333 lekë vetëm nga buxheti i shtetit dhe 18 kandidatë të pavarur që nuk kanë asnjë të ardhur dhe nuk kanë kryer shpenzime, janë shpenzuar gjithsej 441 orë pune në vlerën prej 1,293,000 lekë, me një mesatare të lartë rreth 25 orë auditimi për çdo kandidat të pavarur, për të cilët nuk rezulton të jenë shpenzuar kohe pune për verifikim të mëtejshëm, duke sjellë si pasojë shpërdorim të fondeve publike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

12 Nga auditimi u konstatua se: Në disa raste nuk është bërë e mundur auditimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi shumë subjekte zgjedhore nuk kanë deklaruar në KQZ adresën e selisë së partisë, si dhe nuk u mundësua asnjë numër kontakti me telefon (shprehje e përdorur nga ekspertët kontabël). Në këto raste, ndonëse ekspertët kontabël janë ndodhur në kushte të njëjta, janë paguar me orë të ndryshme kështu:

-Për auditimin e subjektit zgjedhor "Partia e Reformave Demokratike" audituesi është paguar me 35 orë auditim në vlerën 105,000 lekë (3,000 lekë/orë);

-Për auditimin e subjektit zgjedhor "Partia Fronti i Majtë", audituesja është paguar me 7 orë në shumën 21,000 lekë;

-Audituesja është paguar 105 orë në vlerën 315,000 lekë ndërkohë që është shprehur se nuk ka audituar asnjë prej 4 subjekteve zgjedhore të regjistruar për mungesë adresash apo numër kontakti telefoni, të subjekteve zgjedhore "Partia Ora e Shqipërisë", dhe 3 kandidatë të pavarur.

Konstatohet se, edhe në ato raste që ekspertët kontabël nuk kanë kryer asnjë orë pune disa prej tyre kanë përfituar pagesa më të larta se të tjerët duke u favorizuar në këtë mënyrë padrejtësisht. Po kështu, për subjektin zgjedhor që nuk i është nënshtruar auditimit, KQZ nuk ka marrë asnjë masë konkrete për penalizimin e tyre sipas dispozitave ligjore, që parashikohet në nenin 91, pika 5 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet se: "*Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në këtë Kre, nga subjektet zgjedhore, në rast se nuk përbën veprë penale është kundravajtje administrative dhe ndëshkohet sipas parashikimeve të pjesës XIV të këtij Kodi*". Në fakt ky është orientim i gabuar pasi sanksionet janë parashikuar në Pjesën XIII "Përgjegjësitë dhe Sanksionet" dhe jo XIV të Kodit dhe konkretisht sipas, nenit 173 "Sanksionet në lidhje me financimin e fushatës" në pikën 2, parashikohet: "*Mosbashkëpunimi me auditin e KQZ-së nga ana e subjektit zgjedhor dënohet me gjobë nga 1,000,000 lekë deri në 2,000,000 lekë*" dhe në pikën 3 të po këtij neni parashikohet se: "*Refuzimi për të bërë transparent burimet e financimit të fushatës, apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e auditit, dënohet me gjobë nga 2,000,000 lekë deri në pezullimin për 5 vjet të financimit publik për partinë politike*".

13. Nga auditimi u konstatua se: Në 3 raste, raportet e auditimit janë hartuar vetëm në bazë të deklaratave të subjekteve zgjedhore, në të cilat përfaqësuesi apo finansiari i subjektit deklaroi se nuk ka përfituar as fonde publike, sponsorizime dhe as kanë kryer shpenzime, në 1 rast raportet janë hartuar ditën e deklarimit të subjektit zgjedhor dhe në dy raste janë hartuar 1 ditë më vonë se deklarata e subjektit, fakt që tregon se është shpenzuar një kohe tepër minimale për auditim duke pasqyruar veprimtarinë e subjekteve në 1.5 faqe format A4 pa asnjë informacion për të ardhurat dhe shpenzimet, për të cilat është kryer pagesë për 25 orë pune, e konkretisht:

-Kandidati i pavarur për në Bashkinë Tepelenë, në datën 23.10.2015 deklaroi se nuk ka përfituar asnjë financim apo sponsorizim, dhe po në datën 23.10.2015 ekspertja kontabël hartoi raportin e auditimit për të cilën paguhet me 25 orë në vlerën 75,000 lekë.

-Subjekti zgjedhor "Partia Demokratike për Ndryshim", deklaroi se, nuk ka marrë fonde publike dhe nuk disponon asnjë dokument që ka bërë shpenzime. Raporti i auditimit hartohet në datën 11.11.2015, ndërsa deklarata e drejtuesit të partisë mban datën 10.11.2015. Në këtë raport nuk ka asnjë të dhënë nëse audituesit kanë bërë verifikime konform "Kodit Zgjedhor në RSH" neni 91 pika 3, ku përcaktohet se: "Subjekti zgjedhor që auditohet duhet të vërë në dispozicion çdo informacion që disponojnë bankat, apo të autorizojë audituesin për tërheqjen



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

e informacionit nga persona të tretë”, për të justifikuar në këtë mënyrë pagesën për 25 orë në vlerën prej 75,000 lekë;

-Subjekti zgjedhor kandidati i pavarur ..... deklaroi në datën 12.11.2015 se nuk ka përfutur fonde publike dhe as nuk ka kryer shpenzime, raporti hartohet nga ..... 1 ditë më pas në datën 13.11.2015, pa kryer asnjë verifikim tjetër, për të justifikuar pagesën për 25 orë në shumën 75,000 lekë.

Për mangësitë e trajtuara më lart mbajnë përgjegjësi ekspertët kontabël, respektivisht:

nuk kanë respektuar parimet standarde të kontabilitetit në auditimin e pasqyrave financiare dhe nenin 91, të “Kodit Zgjedhor në RSH” në kryerjen e auditimit të subjekteve zgjedhore.

14. Nga auditimi i ushtruar në përlogaritjen dhe shpërndarjen e fondeve për subjektet politike të regjistruar në fushata të ndryshme zgjedhore dhe rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë për periudhat e mëparshme, u konstatua se, janë debitorë, 8 subjekte zgjedhore, nga të cilat, në llogarinë debitorë të tjerë të KQZ janë pasqyruar partitë politike që figurojnë me detyrime të pashlyera në zgjedhjet e vitit 2003 në shumën prej 1,621,920 lekë dhe detyrimet e 5 partive politike në vlerën prej 12,728,006 lekë të pashlyera pranë Ministrisë së Financave nga zgjedhjet e vitit 2009. Këto detyrime vazhdojnë të jenë të pashlyera, përderisa nuk janë marrë masa administrative nga KQZ, për mos regjistrim në zgjedhjet e radhës pa u shlyer detyrimet e mëparshme.

15. Nga verifikimi i kryer në inventarin fizik për gjendjen fizike të aktiveve dhe të objekteve inventar konstatohet se, në magazinë gjenden sasira të konsiderueshme për mallra, materiale dhe objekte inventari të destinuara vetëm për veprimtaritë zgjedhore (parlamentare dhe vendore) që kanë si origjinë blerjet dhe furnizimet e kryera ndër vite, të cilat kanë jo vetëm kosto të lartë por edhe vlera përdorimi. Sipas të dhënave që disponon KQZ, këto objekte inventari dhe materiale zgjedhore nuk gjejnë përdorim pasi partitë për çdo zgjedhje vendore apo parlamentare kërkojnë të bëhen ndryshime të kodit zgjedhor duke nxjerrë jashtë funksioni infrastrukturën zgjedhore.

Sipas inventarit fizik të kryer në magazinë në muajin janar 2015, KQZ disponon materiale dhe objekte zgjedhore në sasira të konsiderueshme të cilat sipas kontabilitetit llogariten në vlerën prej **208,529,995 lekë**, respektivisht; 36,640 copë kuti votimi të dimensioneve, formave dhe ngjyrave të ndryshme në vlerën prej 166,576,691 lekë dhe 188,692 copë kode dhe vula sigurie në vlerën prej 41,953,304 lekë.

Sipas të dhënave që disponon KQZ për zgjedhjet e përgjithshme të Kuvendit nevojiten mesatarisht 8,000 kuti votimi pra rreth 25 % e gjendjes së tyre, ndërsa për zgjedhjet e pushtetit vendor nevojiten mesatarisht rreth 12.000 copë kuti votimi ose rreth 30 % e kutive që janë gjendje në magazinën e KQZ-së.

Rritja e gjendjes stok të materialeve dhe objekteve zgjedhore ka ardhur duke u rritur nga një zgjedhje në tjetrën pasardhëse për faktin se, kërkesat e partive dhe ndryshimet e shpeshta të kodit zgjedhor, si dhe specifikimet teknike që shtohen në çdo zgjedhje vendore apo parlamentare, kanë sjellë si pasojë rritjen e stokut në magazinë dhe përdorimin pa efektivitet të fondeve publike.

16. Nga auditimi u konstatua se nga KQZ përgjatë vitit 2013 me qëllim zbatimin e detyrimeve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë janë realizuar procedurat e prokurimeve për dy projekte të konkretisht Projekti Sistemi elektronik i Verifikimit ( SEV) për Qarkun Tiranë dhe Projekti Sistemi Elektronik i Numërimit ( SEN)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

për Qarkun Fier. Të dy këto procedura prokurimi nuk mundën të implementohen në praktikë. **Konstatohet se implementimi i tyre në shkallë Republike është i pa mundur** për arsye të vlerës tepër të lartë financiare të kërkuar për këtë qëllim si dhe të dyshimit për mungesën e të dhënave në Kartat ID dhe Pasaportave Biometrike përsa i përket Chip-ave me dhe pa kontakt të lëshuara para vitit 2014 (për të cilën as Ministria e Brendshme me përgjigjet që i ka kthyer KLSH me shkresën nr. 1921/1, datë 25.03.2016 në lidhje me shkresën e KLSH nr.1131/5 datë 21.03.2016) nuk tregojnë gjendjen e të dhënave “de facto” por vetëm atë “de jure”). Arsye tjetër është edhe mënyra e palosjes së fletës së votimit të kërkuar nga teknologjia numëruese që është në kundërshtim me traditën e mësuar nga shqiptarët në votime e që rrit riskun e dështimit të numërimit.

17. Gjithashtu në përfundim nga auditimi mbi këto dy Projekte Pilot ( SEV dhe SEN) konstatohet se: Të dy këto Projekte kanë qenë plotësisht të dështuara dhe për të cilat janë paguar shuma prej **2,563,349.5 Euro** përbën dëm ekonomik për buxhetin e Shtetit e cila ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Kontraktor si përgjegjës që në hartimin e kontratave për të dy projektet si dhe në lidhjen e tyre ashtu dhe në ndjekjen e zbatimit të këtyre, kontratave. Për të cilën janë ngarkuar me përgjegjësi personat konkret e që trajtohen më hollësisht në Pikën VI.2 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

18. Nga auditimi u konstatua se: Në lidhje me aktivitetin e shtuar në drejtim të prokurimeve publike të realizuara nga ana e KQZ për llogari të vitit zgjedhor 2015 vihet re se: Mallra dhe shërbimet e kërkuara në drejtim të specifikimeve teknike të tyre janë objekt i vendimarrjes politike të KQZ duke përfshirë këtu dhe eksperiencën e mëparshme për të njëjtat blerje mallrash, shërbime apo materiale zgjedhore. Në këto kushte është e natyrshme që në këto procedura të zhvilluara janë paraqitur e do të paraqiten gjithmonë e më pak konkures, minimalisht dy ose dhe vetëm një ofertues të cilët përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktor. Gjithashtu ajo që konstatohet është dhe fakti që megjithëse ka gjendje në magazinë kërkohen të blihen materiale shtesë për zgjedhjet si përshembull vulat e sigurisë. Këto vula kërkohen nga përfaqësuesit e partive politike thjesht me ngjyrë tjetër nga ato të përdorurat në zgjedhjet e mëparshme dhe një gjë e tillë vendoset me vendim të anëtarëve të KQZ. Një gjë e tillë nuk ka asnjë efekt rritës në sigurinë e integritetit të zgjedhjeve në drejtim të sigurimit të kutive të votimit por vetëm efekt psikologjik në kërkesat e partive të cilat shoqërohen me efekte ekonomike për taksapaguesit shqiptar. Kështu gjatë vitit 2015 është zhvilluar procedura e prokurimit për blerje Kode sigurie për të cilën është marrë Vendimi i KQZ nr.14, datë 27.01.2015 në të cilën megjithëse pranohet se ka gjendje në magazinë të KQZ Kode Sigurie( KS) dhe Kode Sigurie Rezervë (KSR) theksohet se: *Meqenëse partitë propozuan më datë 21.01.2015 këto kode të blihen në sasinë prej 175.000 copë dhe të jenë me ngjyrë të zezë ku përfshihen dhe ngjyrë qielli e hapur për koder sigurie rezervë në sasinë prej 16.500 copë.* Në datën e zhvillimit të këtij tenderi ka paraqitur ofertë vetëm një ofertues që është ai i një here më parë e konkretisht “ ( Hong Kong) .

Në lidhje me të gjithë këtë prokurim rezulton se janë bërë shpenzime të cilat sjellin efekte ekonomike negative në Buxhetin e Shtetit pikërisht për faktin se një sasi e këtyre kodeve por me ngjyrë tjetër gjenden në magazinat e KQZ. Kode këto të përdorura që nga viti 2009. Në magazinat e KQZ ndollen dhe Kode Sigurie të përdorura para vitit 2005 që janë të një prodhuesi tjetër ku konstatohet se kosto e tyre me ndryshimet nga plastikë në çelik ka ardhur duke u rritur me disa herë. Kështu një Kod Sigurie plastik që ndollet në magazinat e KQZ është e regjistruar me një vlerë të përafërt prej **10.6 lekë/copë** ndërsa kodet e fundit prej çeliku kanë një vlerë prej **122.8 lekë/copë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Kosto e shtuar me blerje të herë pas hershme përbën dhe blerja e “Dhomave të fshehta” dhe kutive të kartonit për materialet zgjedhore të cilat specifikohen nga KQZ me Vendim e KQZ nr.19 datë 02.02.2015. Këto materiale do të duhej të ishin të përdorshme në disa votime dhe jo të konsumueshme vetëm për një palë zgjedhje.

Gjithashtu konstatohet se nga administrata e KQZ pothuaj të gjitha procedurat e prokurimeve të zhvilluara në lidhje me procesin e votimeve të vitit 2015 kanë për bazë të specifikimeve teknike të materialeve dhe shërbimeve të kërkuara miratimin e tyre me Vendim të KQZ. Kështu dhe specifikimet e fletëve të votimit janë miratuar sipas lidhjes nr.1 bashkalidhur me Vendimin të KQZ nr.104 datë 09.04.2015 ( i ndryshuar me Vendimin nr. 459 datë 19.05.2015) ku për ilustrim kërkohen që letra e votimit të ketë një sërë elementësh si: *të jetë me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, e ratifikuar në fazën përfundimtare, i çertifikuar me certifikatë origjine, i vazhdueshëm me skicë speciale, me mikroprintime, element në printim që shikohet me rreze ultraviolet. Apo parashikohet dhe barkod.* Të gjitha këto element nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se rrisin në mënyrë të dukshme vlerën e tyre si dhe bëjnë që të mos ketë konkurim në këto procedura duke bërë që kjo sasi leku e taksapaguesve shqiptar të perfundojnë jashtë vendit. Vendimi i KQZ nga ana tjetër është i bazuar në nenin 98 pika 1 e Kodit Zgjedhor që parashikon që: *“Fletët e votimit për zgjedhje përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre me trashësi ose element konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesë të pasme të saj, si dhe të përmbajne element sigurie, sipas përcaktimeve me akt normative të KQZ-së. Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimi si dhe element të tjerë që nuk lexohen me sy të lire.....”*

Nga auditimi konstatohet se, nga ana e administratës së KQZ (Njësisë së prokurimit dhe KVO) nuk i ngelet shumë për të bërë, në drejtim të realizimit të procedurave të prokurimit duke pasur parasysh këtu dhe afatin e shkurtër për realizimin e tyre dhe specifikimeve të para caktuara dhe miratuara me Vendim të KQZ.

Në përfundim konstatohen: shpenzime të shtuara krejtësisht të pa nevojshme për procese zgjedhore e për të cilat duhet të ngarkohet me përgjegjësi KQZ por që në fakt përgjegjësia kryesore i takon politikës e cila që në hartimin e legjislacionit jo vetëm që lejon por kërkon që të bëhen këto shpenzime duke i atribuar vehtes shpenzime të cilat duken sikur janë të një shteti supermodern me financa të pafundme dhe ku Partitë si subjekte zgjedhore jo vetëm që nuk kontribuojnë asgjë por kërkojnë dhe përfitojnë dhe të ardhurat e taksapaguesve shqiptar.

*Në lidhje me këto pika janë paraqitur objeksione nga personat e atakuar në Projektraportin e Auditimit por ato në mënyrë më të detajuar janë të trajtuara në pikat respektive të mëposhtme të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi pasi këtu kemi të bëjmë me pjesën përmbledhëse të konstatimeve nga auditimi.*

#### **REZULTATET E AUDITIMIT:**

##### **I.Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm.**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përfundim të auditimit në KQZ, me shkresën nr. 166/6 datë 07.06.2012, ka dërguar rekomandimet dhe Raportin Përfundimtar të auditimit të ushtruar në KQZ. Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përfundim të verifikimit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna rezultojnë se:

Nga KLSH janë rekomanduar:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

### I. Masa organizative

Rekomanduar gjithësej nga KLSH 5 masa, nga të cilat 2 janë realizuar plotësisht, 1 është pjesërisht e realizuar, 1 rekomandim nuk është marrë në konsideratë dhe 1 është pa realizuar.

Në mënyrëq më të detajuar paraqiten si më poshtë:

**Rekomandim 1:** Marrjen e masave për ndërtimin e një linje të re me qëllim shkëputjen e energjisë elektrike dhe lidhjen e pavarur të saj nga DSHQ, me qëllim likuidimin e këtyre shpenzimeve sipas sasisë së shpenzuar në fakt. **(Realizuar)**

Për zbatimin e këtij rekomandimi KQZ i është drejtuar me shkresën zyrtare DSHQ dhe CEZ Shpërndarje, DSHQ për bashkëpunim dhe CEZ Shpërndarje "për ndarjen e matjes së energjisë elektrike". Deri në momentin kur KQZ-ja ishte e vendosur në ambientet e Pallatit të Kongreseve, vendosja e një linje të re të energjisë të pavarur nga DSHQ nuk u realizua. KQZ aktualisht e ushtron funksionin e saj në ambiente të reja të pavarura nga DSHQ, kështu që ky rekomandim quhet i realizuar.

**Rekomandim 2:** Bashkëveprimin e KQZ-së me Ministrinë e Brendshme, për marrjen e masave dhe kryerjen e një procedure prokurimi të përqendruar, pasi magazinat e KQZ, janë brenda territorit të Rezervave të Përgjithshme të Shtetit. Në këtë mënyrë bashkimi i fondeve të dy institucioneve, do të favorizojë kushtet për një pjesëmarrje më të gjerë të operatorëve ekonomikë, me pasojë rritjen e konkurrencës dhe uljen e shpenzimeve për këtë zë.

**(Nuk është marrë në konsideratë nga ...)**

**Rekomandim 3:** Rivlerësimin e objektit depo (magazinë) me sipërfaqe 960 m<sup>2</sup> me vlerë kontabile 259,352 lekë, me çmimet e tregut, hipotekimin dhe kontabilizimin e vlerës së re në llogarinë përkatëse "aktive të trupëzuara". **Konsiderohet pjesërisht i realizuar.**

Për zbatimin e këtij rekomandimi KQZ i është drejtuar zyrtarisht Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit me shkresën nr. 1960, datë 26.02.2013. Ky rekomandim është pjesërisht i realizuar pasi është bërë hipotekimi i objektit por nuk është bërë indeksimi i vlerës së magazinës me sipërfaqe 960 m<sup>2</sup> për tu kontabilizuar në Aktivet e Qëndrueshme të Institucionit.

**Rekomandim 4:** Në zgjedhjet e ardhshme KQZ, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të marrin masat për arkëtimin, apo sistemimin e detyrimeve të krijuara në zgjedhjet e mëparshme nga 8 subjekte zgjedhore në vlerën prej 14,349,926 lekë. **(Pa realizuar)**

Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve.

**Rekomandim 5:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar të vitit 2012, të bëjë ndryshimet përkatëse, për të zbatuar me rigorozitet pikën 12 të VKM nr. 864, ku është përcaktuar që shpenzimet për telefona celularë të mos kalojnë masën 2 % të totalit të shpenzimeve operative. Gjithashtu, ky rekomandim të shoqërohet edhe me shfuqizimin e urdhrin të Kryetarit të KQZ-së nr. 61, datë 20.09.2010 "Për përcaktimin e limiteve mujore të telefonisë celulare për anëtarët e KQZ-së", dhe përcaktimin e limiteve konform dispozitave ligjore në fuqi. **(Realizuar)**

Për zbatimin e këtij rekomandimi Sekretari i Përgjithshëm i KQZ, ka nxjerr urdhrin e brendshëm që përcakton limitet mujore të telefonisë celulare duke ulur deri në 30 % tarifimin që mbulohen nga institucioni.

### II. Masa zhdëmtimi

Rekomanduar gjithësej nga KLSH 2 masa për zhdëmtim të cilat nuk janë realizuar, këto dy rekomandime nuk janë marrë në konsideratë nga ish Kryetari i KQZ-së të asaj periudhe, konkretisht :

**Rekomandim 1:** Mbështetur në nenin 27 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Për Kodin e Punës" me ndryshimet e mëvonshme, të nxirret urdhri për shpërblim dëmi, të kryen



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDIFIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat, për 24 punonjës në vlerën prej 792,000 lekë, për sa përfituar shpërblime në kundërshtim me pikën 1, germa "b" të VKM nr. 591, datë 23.07.2010 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore", VKM nr. 472, datë 02.07.2011, "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore të vitit 2011", pika 1, germa "b". (Pa Realizuar)

**Rekomandim 2:** Të kërkohet në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës 287,352 lekë, të përfituara padrejtësisht shoqëria " " shpk, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" dhe udhëzimin e ministrit të financave nr. 3, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", pika 7 "Furnizimet e tatueshme dhe ato të përjashtuara", gërmat "b, c". (Pa realizuar)  
 Në lidhje me këtë pikë nga ana e grupit të auditimit u mbajt Aktverifikimi nr. 1 datë, 15.03.2016 për të cilën nuk u paraqitën vërejtje. Vërejtje nuk u paraqitën as në lidhje me Projektraportin e Auditimit.

**II. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të KOZ.**

**Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të KOZ.**

Nga auditimi kryer për zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit për periudhën objekt kontrolli u konstatua:

**a. Projektbuxheti afatmesëm 2014-2016**, është hartuar në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" si dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 22.02.2013 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016, si dhe tavanët përgatitorë të PBA miratuar me VKM nr. 138, datë 20.02.2013. Projektbuxheti afatmesëm është dërguar brenda afatit datë 30.04.2013. në projektbuxhetin afatmesëm janë parashikuar shpenzimet si për buxhetin e vitit 2014 ashtu edhe për vitin 2015 si vit zgjedhor për pushtetin vendor, respektivisht sipas tabelës së mëposhtme.

Planifikimi i Shpenzimeve të Programit		2016		PSHP 7						
PSHP Forma 3		Aktivitete të Programit sipas Rezultateve								
Emri i Entit:		Komisioni Qendror i Zgjedhjeve								
Numri i Grupit:		73								
Nr. Titulli i Programit		1610								
Emri i Programit		Planifikim, menaxhim dhe administrim								
Numri i Produktit		A								
Emri i Produktit		Punonjes te motivuar dhe te trajnuar								
Numri i Aktivitetit		A 1								
Emri i Aktivitetit		Përshkrimi i Aktivitetit								
Kosto e Aktivitetit (në mijë lekë)	Paga 600	Sig. Shoq. 601	Operative 602	Subvencion 603	Trans. e Brendshme 604	Trans. E Jashtme 605	Trans. Per Buxhetet Familjare dhe Individet 606	Shp. Kap. Te Patrupezuara 230	Shp. Kap. Te Trupezuara 231	
	68300	10700	17680	0	0	200	3120	0	3000	
Numri i Aktivitetit		A 2								
Emri i Aktivitetit		Përshkrimi i Aktivitetit								
Kosto e Aktivitetit (në mijë lekë)	Paga 600	Sig. Shoq. 601	Operative 602	Subvencion 603	Trans. e Brendshme 604	Trans. E Jashtme 605	Trans. Per Buxhetet Familjare dhe Individet 606	Shp. Kap. Te Patrupezuara 230	Shp. Kap. Te Trupezuara 231	
	0	0	0	0	0	0	0	0	0	





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Në mënyrë analitike sipas produkteve programet paraqiten si më poshtë:

*Në mijë lekë*

Grupi Titulli	Zërat	Paga	Sig Shoq	Mallra e shërbime	Transferta korente	Kapit. të trup.
73/01610	Shpenzime nga buxheti Institucioni	66,000	8,000	16,680	3,320	3,000
	<b>Totali</b>	<b>66,000</b>	<b>8,000</b>	<b>16,680</b>	<b>3,320</b>	<b>3,000</b>

Në total, shpenzimet buxhetore për vitin 2014 janë planifikuar në vlerën **97.000 mijë lekë**. Struktura e shpenzimeve buxhetore të KQZ-së është e detajuar në dy grupe; në grupin 01610 ku përfshihen shpenzimet nga buxheti i shtetit për administratën e KQZ-së dhe shpenzime nga buxheti i shtetit për zhvillimin e zgjedhjeve programohen në grupin 01620.

Në planifikimin e pagave dhe shtesave mbi to është mbajtur parasysh struktura dhe organikat e miratuara dhe niveli i pagave për çdo pozicion, ndërsa në planifikimin e shpenzimeve korrente është mbajtur parasysh tavanit i përcaktuar nga Ministria e Financave.

Në strukturë shpenzimet nga buxheti për aparatit paraqiten si më poshtë:

- Shpenzime për paga e administratës zënë 68 % të totalit të shpenzimeve buxhetore.
- Shpenzime të tjera korrente zënë 17.2 % të shumës së shpenzimeve buxhetore.
- Shpenzime për investime zënë 3.1 % ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore.

Nga auditimi i kritereve në **planifikimin e investimeve** rezultoi se, planifikimi i tyre është bërë duke mbajtur parasysh fillimisht, nevojat e institucionit dhe tavanet e përcaktuara nga Ministria e Financës.

Për vitin 2014, **shpenzimet për investime** janë planifikuar në vlerën prej 3,000 mijë lekë, për blerje pajisje zyrash 3.000.000 lekë.

Ministria e financës me shkresën nr. 19405, datë 13.01.2014 ka dërguar planin përfundimtar të buxhetit, i cili paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Grupi Titulli	Zërat	Paga	Sig Shoq	Mallra e shërbime	Transferta korente	totali
73/01610	Shpenzime nga buxheti Institucioni	60,000	8,000	16,680	3,400	---
	<b>Totali</b>	<b>60,000</b>	<b>8,000</b>	<b>16,680</b>	<b>3,400</b>	<b>88,080</b>

Nga tabela e mësipërme rezulton se Ministria e Financave ka pakësuar fondin e pagave për 6,000 mijë lekë dhe shpenzimet për investime në shumën 3,000 mijë lekë.

Pë vitin 2014 KQZ ka kërkuar miratim për përdorim nga fondi i veçantë me rastin e 8 marsit në shumën prej 65,000 lekë. Ministria e financës me shkresën nr.2975/1, datë 07.03.2014 ka miratuar shtesë fondi për shumën 65,000 lekë duke pakësuar kodin 81 të një institucioni tjetër dhe shtuar artikullin 602 të KQZ për shumën 65,000 lekë.

Me shkresën nr.6150/2, datë 06.05.2014 Ministria e Financave sipas kërkesës së KQZ ka miruar shtesë fondi për investime në vlerën prej 3,000 mijë lekë;

Me shkresën nr. 7766/57 datë 14.07.2014 Ministria e Financave ka miratuar shtesë fondi për artikullin 602, në vlerën prej 2,825 mijë lekë dhe pakësin nga artikulli "Transferta nga buxhetet fsmiljare dhe individët me objekt hapjen dhe djegjen e materialeve zgjedhore të mëparshme me qëllim lirim të kutive të votimit për zgjedhjet e vitit 2015.

Realizimi i buxhetit për vitin 2014 paraqitet në tabelën e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Në mijë lekë

Nr.	Zërat e buxhetit	Plani fillestar	Paksime Transferime	Plani përfundimtar	Realizimi	Deviac. + -	Në. %
600	Shpenzime për paga	60,000		60,000	48,419	-11,581	80
601	Shp. Sig. Shoq.	8,000		8,000	7,390	-610	92
602	Shpen. operative	16,680	+2,890	19,570	18,503	-1,067	94.5
605	Transferime korrente	3,400	-2,825	575	405	-170	70
231	Shp. Për invest.	-	+3,000	3,000	448	-2,552	15
	<b>SHUMA</b>	<b>88,080</b>	<b>3,065</b>	<b>91,145</b>	<b>75,165</b>	<b>-15,980</b>	<b>82.5</b>

Nga tabela e mësipërme rezulton se shpenzimet në total janë realizuar në masën 82,5 %, ose shpenzimet janë realizuar më pak për shumën 15,980 mijë lekë, respektivisht:

- Fondi i pagës është realizuar 80 % ose më pak për shumën 11,581 mijë lekë, si rrjedhojë e vendeve vakant respektivisht 3 anëtarë të komisionit zgjedhor dhe 4 punonjës të tjerë, të cilët nuk janë zëvendësuar pasi janë çështje në gjykim për largim nga puna;
- Shpenzimet operative janë realizuar në masën 94.5 % ose 1,067 mijë lekë më pak se programimi;
- Transferata të ndryshme janë realizuar në masën 70%
- Investimet me objekt blerje pajisje janë realizuar në masën 15 %.

**b. Projektbuxheti afatmesëm për vitet 2015-2017** është hartuar në bazë të udhëzimit plotësues nr. 7/2, datë 07.07.2014 të Ministrisë së Financave i vitit 2015, dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr. 2650/10, datë 07.07.2014 "Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm dhe tavanet e shpenzimeve buxhetore. Projekt buxheti është dorëzuar brenda afatit në Ministrinë e Financave, kjo e fundit me shkresën nr.103/1, datë 29.04.2010. Në mënyrë analitike shpenzimet për vitin 2015 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Grupi Titulli	Zërat	Paga	Sig Shoq	Mallra e shërbime	Transferta korente	Investime	Totali
73/01610	Shpenzime nga buxheti Institucioni	60,000	8,000	16,360	640	8,000	92,800
	<b>Totali</b>	<b>60,000</b>	<b>8,000</b>	<b>16,680</b>	<b>3,400</b>	<b>88,080</b>	<b>92,800</b>

Nga tabela e mësipërme, rezulton se, kuotat e shpenzimeve ndonëse viti 2015 është vit zgjedhor janë programuar sipas taveve të miratuara nga Ministria e Financave, në nivelin e vitit të kaluar, pa parashikuar shpenzimet që nevojiten për zhvillimin e zgjedhjeve por shtesat janë bërë në vitin në vazhdim. Zëri shpenzime për investime është parashikuar në vlerën prej 8,000 mijë lekë, i detajuar si më poshtë:

- Ndërtim i dhomës së serverave në vlerën prej 1,070 mijë lekë;
- Pajisje kompjuterike dhe orendi zyre 4,953 mijë lekë;
- Ndërtim rrjeti kompjuterik në vlerën prej 1,977 mijë lekë.

Ministria e Financave me shkresën nr. 11092/2, datë 11.08.2014 ka përcaktuar tavanet e shpenzimeve për vitin 2015 sipas tabelës së mëposhtme:

Grupi Titulli	Zërat	Paga	Sig Shoq	Mallra e shërbime	Transferta korente	Investime	Totali
73/01610	Shpenzime nga buxheti Institucioni	60,000	8,000	617,000	-	3,000	688,000
	<b>Totali</b>	<b>60,000</b>	<b>8,000</b>	<b>617,000</b>	<b>-</b>	<b>3,000</b>	<b>688,000</b>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Ministria e Financave me shkresën nr.18282, datë 24.1.2014 ka dërguar detajimin e shpenzimeve operative për vitin 2015, duke shtuar shpenzimet korrente si vit zgjedhor në shumën 684,800 mijë lekë, të ndarë respektivisht në shpenzime menaxhimi dhe administrimi në shumën 64,800 mijë lekë, shpenzime për zgjedhjet lokale në shumën 600,000 mijë lekë dhe shpenzim, e për investime në vlerën prej 8,000 mijë lekë  
Gjatë vitit 2015 sipas kërkesave të KQZ janë bërë ndryshime në zërat e shpenzimeve si më poshtë;

Këshilli i Ministrave me vendimin nr.501, datë 30.07.2014 ka transferuar një godinë pronë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me sipërfaqe objekti 673 m<sup>2</sup>, me destinacion "Ndërtim i Godinës së re të KQZ-së". Për financimin e objektit të ri Ministria e Financave me shkresën nr.2135/1, datë 16.02.2015 ka akorduar nga fondi i rezervë i KM në vlerën prej 57,937,000 lekë me tvsh për ndërtimin e objektit zyrate e reja të KQZ-së.

Në total, shpenzimet buxhetore të planifikuara për vitin 2015, si vit zgjedhor, janë programuar në vlerën prej 745.000 mijë lekë. Struktura e shpenzimeve buxhetore të KQZ-së është detajuar në dy grupe; në grupin 73/01610 përfshihen shpenzimet e çelura nga buxheti i shtetit për administratën e KQZ-së dhe grupi 73/01620 shpenzime të çelura nga buxheti i shtetit për zhvillimin e zgjedhjeve.

Në planifikimin e pagave dhe shtesave mbi to, është mbajtur parasysh struktura dhe organika e miratuar dhe niveli i pagave për çdo pozicion, ndërsa në planifikimin e shpenzimeve korrente është mbajtur parasysh taveni i përcaktuar nga Ministria e Financave. Sipas strukturës, shpenzimet nga buxheti për aparatën paraqiten si më poshtë:

- Shpenzime për pagat e administratës, zënë 69.72 % të totalit të shpenzimeve buxhetore;
- Shpenzime të tjera korrente, zënë 27.52 % të totalit të shpenzimeve buxhetore;
- Shpenzimet për investime zënë, 2.76 % të totalit të shpenzimeve buxhetore.

Nga auditimi i kriterëve në planifikimin e investimeve rezultoi se, planifikimi i tyre këtë vit, është bërë duke mbajtur fillimisht parasysh nevojat e institucionit dhe tavanet e përcaktuara nga Ministria e Financës.

Realizimi i buxhetit për vitin 2015 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Zërat e buxhetit	Plani fillestar	Paksime Transferime	Plani përfundimtar	Realizimi	Deviac. +-	Në. %
600	Shpenzime për paga	60,000	-1,496	58,504	57,247	-1,257	98
601	Shp. Sig. Shoq.	8,000	-	8,000	8,000	-	100
600	Paga zgjedhjet		64,879	64,879	53,724	-11,155	82.8
601	Sig.Shoq zgjedhjet		8,000	8,000	6,861	-1,139	85.7
602	Shpenz korrente	16,360	+384	16,744	12,803	-3,941	76.4
605	Transferta korrente	640	-200	440	440	-	100
602	Shpenzime për zgjedhjet	-	445,740	445,740	395,961	-49,779	88.7
231	Shpenzime për investime	8,000	57,937	65,937	58,021	-7,916	88
	<b>SHUMA</b>	<b>92,800</b>	<b>575,444</b>	<b>668,244</b>	<b>593,057</b>	<b>-75,187</b>	<b>88.7</b>

Nga tabela e mësipërme rezulton se shpenzimet në total janë realizuar në masën 88,7 %, ose shpenzimet janë realizuar më pak për shumën 75,187 mijë lekë, respektivisht:

1. Fondi i pagës është realizuar 98 % ose më pak për shumën 1,257 mijë lekë, si rrjedhojë e vendeve vakant të cilët nuk janë zëvendësuar pasi janë çështje në gjykim për largim nga puna;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

2. Shpenzimet operative për KQZ janë realizuar në masën 76.4 % ose 3,941 mijë lekë më pak se programimi;
3. Shpenzimet operative për zgjedhjet vendore janë realizuar në masën 88.7 % ose 49,779 mijë lekë më pak se programimi;  
Transferta të ndryshme janë realizuar në masën 100%
4. Investimet me objekt blerje pajisje janë realizuar në masën 88 %, ose më pak për 7,916 mijë lekë.

Nga auditimi mbi programimin dhe realizimin e shpenzimeve operative për realizimin e zgjedhjeve vendore 2015, konstatohet se për këtë vitit në treguesit e projekt buxhetit janë programuar dhe realizuar shpenzime për blerjen e 1,000 copë kuti votimi në vlerën prej 5,274,829 lekë së bashku shpenzimet për zhdoganimin e tyre. Sipas të dhënave të kontabilitetit konstatohet se në magazinë ka gjendje 19,188 copë kuti votimi me vlerë 80,835 ose mbi dy herë më tepër nga sa nevojiten për të përballuar nevojat për zgjedhjet e pushtetit vendor. Nga të dhënat e kontabilitetit janë rreth 13,000 copë kuti që nuk mund të përdoren pasi nuk pranohen nga partitë politike të cilat i kërkojnë me kode apo vula sigurie janë me ngjyra të bardha apo të kuti votimi më kode, duke sjellë si pasojë ngurtësimin e fondeve publike në mallra stoke në magazinë.

***c.Mbi auditimin për zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit, detajimin e planit fillestar, transferimi i fondeve buxhetore gjatë vitit dhe plani përfundimtar.***

Për periudhë objekt auditimi, auditimi u krye në mbështetje të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009, i ndryshuar "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të institucioneve publike", udhëzimit plotësues nr. 7/2, datë 07.07.2014 të Ministrisë së Financave dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr. 2650/10, datë 07.07.2014 "Për përgatitjen e shpenzimeve buxhetore".

- Fondet e buxhetit janë detajuar në bazë mujore për çdo titull, kapitull dhe artikull brenda afateve kohore të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit.

- Kuotat e planifikuara në fillim të vitit janë të njëjta me kuotat e përcaktuara në projekt buxhet, si për shpenzimet operative dhe investimet.

Nga auditimi u konstatua se, çdo ndryshim ndaj planit fillestar është kryer sipas kërkesave të paraqitura nga KQZ, si për shtesa, ashtu edhe pakësim të fondeve nga një zë në tjetrin, të cilat janë të miratuara nga Ministria e Financave.

Në ligjin për buxhetin e vitit 2015, për zhvillimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore, KQZ-së i janë akorduar 445.740 mijë lekë, të cilat janë realizuar në masën 395,961 mijë lekë ose 88.7 %.

***d.Respektimi i dispozitave ligjore për ndarjen e fondeve financiare për kryerjen e veprimtarisë zgjedhore të Partive Politike. Kthimi i detyrimeve financiare që Partitë Politike, që nuk kanë kaluar pragun minimal.***

Nga auditimi u konstatua:

Raportet e auditimit të ekspertëve kontabël të kontraktuar për auditimin e fondeve publike të përfituara nga subjektet zgjedhore të regjistruara për zgjedhjet vendore 2015, sipas nenit 87 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015 datë 02.04.2015, kanë analizuar dy burime financimi, respektivisht për:

1. Subjektet zgjedhore (Partitë Politike) të regjistruara, që kanë përfituar fonde publike për zgjedhjet vendore 2015;



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

2. Individë të regjistruar në KQZ, në cilësinë e subjekteve zgjedhore për të kandiduar në zonat si të pavarur.

Nga verifikimi i kryer në dokumentacionin që disponon KQZ, konstatohet se: Në zgjedhjet vendore të muajit qershor 2015 janë regjistruar gjithsej 63 Parti Politike, nga këto; kanë përfituar fonde nga buxheti i shtetit 61 subjekte, ndërsa 2 prej tyre nuk plotësojnë kushtet për të përfituar financim.

Fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për subjektet zgjedhore pjesëmarrëse është caktuar në vlerën totale prej 65,000,000 lekë. Shpërndarja e këtij fondi është bërë në bazë të nenit 87/2 të nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015 datë 02.04.2015, shkronja ‘a’, ku është përcaktuar se, 95 % e fondit u shpërndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, të cilat kanë përfituar jo më pak se 0.5 % të votave të vlefshme në zgjedhjet para ardhëse dhe 5 % u ndahet partive politike që janë regjistruar si subjekte zgjedhore sipas shkronjës “b”.

Subjektet politike të regjistruara kanë përfituar fonde publike sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela nr.1**

	Partitë politike	Shuma totale e përfituar nga buxheti	Përqindja e fituar në zgjedhje	Rillogaritja sipas votave të fituara	Diferenca + ose -
1	PS	18,120,554	25.78	18,185,705	65,121
2	PD	13,855,542	20.33	14,343,219	487,677
3	LSI	4,927,927	16.64	11,738,210	6,810,293
4	PR	3,089,960	3.44	2,428,801	-661,159
5	PDIU	2,655,391	3.82	2,696,003	40,612
6	PDS	2,227,395	1.29	906,059	-1,321,336
7	P.Demokristiane Shqipërisë	2,006,636	1.30	915,406	-1,091,229
8	P.Socialdemokrate e Shqip	1,834,902	1.44	1,007,936	-826,966
9	PBDNJ	1,704,364	0.95	667,035	-1,037,328
10	PLL	1,583,873	0.88	623,728	-960,145
11	PAD	1,375,465	0.73	514,445	-861,020
12	Partia Agrare Ambientaliste	1,290,560	0.86	605,123	-685,437
13	P.Bashkimi Liberal Demok.	1,123,180	0.83	584,756	-538,424
14	PSV 91	988,749	1.12	788,692	-200,057
15	PLZHK	889,736	1.26	887,092	-2,643
16	P.Balli Kombëtar	875,920	0.90	638,405	-237,515
17	P.Lidhja Demokristiane	844,771	0.55	386,511	-458,261
18	P.Balli Kombëtar Demokrat	650,220	0.90	637,456	-12,764
19	P G 99	639,084	0.61	428,553	-210,531
20	Aleanca Arbnore Kombëtare	386,297	0.81	571,119	184,821
21	Partia e Gjellbër	353,684	0.65	461,564	107,881
22	PLD	325,801	0.55	391,524	65,723
23	P.Pop.Kristiandem.Shqipërisë	83,333	-	-	-83,333
24	Aleanca popullore	83,333	-	-	-83,333
25	P.Mendim Djathtë Liberal	83,333	-	-	-83,333
26	PPSH	83,333	-	-	-83,333
27	P.Unitetit Kombëtar	83,333	0.64	455,107	371,773
28	P.Shqiptare Atdheu	83,333	-	-	-83,333
29	Partia Pajtimit Kombëtar	83,333	-	-	-83,333
30	PKSH	83,333	-	-	-83,333
31	P.Rruga e Lirisë	83,333	-	-	-83,333
32	P.Kristiandemokrate	83,333	0.60	425,573	342,240



**KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

33	Alenaca Barazi Drejtësi	83,333	-	-	-83,333
34	Partia Çështjeve Shqiptare	83,333	-	-	-83,333
35	Partia Reformave Demokratike	83,333	-	-	-83,333
36	PKSH 8 Nentori	83,333	-	-	-83,333
37	Partia Mbrojtjes së Emigrantëve	83,333	-	-	-83,333
38	PL për Drejtësi Shqiptarëve	83,333	-	-	-83,333
39	P.Personat Aftesi Kufizuar	83,333	-	-	-83,333
40	P.Alenaca Demokristiane Shqip	83,333	0.51	359,145	275,812
41	Partia Ardhmeria Shqiptare	83,333	-	-	-83,333
42	PS Moderuar	83,333	0.98	693,408	610,074
43	PLD për Ndryshim	83,333	-	-	-83,333
44	Alenca për Demokraci e Solidar.	83,333	0.58	406,787	323,454
45	Parta Demokracia e Re Europ.	83,333	-	-	-83,333
46	Minoriteti Grek Etnik	83,333	-	-	-83,333
47	Partia e të drejtave të Mohuara	83,333	-	-	-83,333
48	Partia Ora e Shqipërisë	83,333	0.69	485,227	401,894
49	Parta e drejtave mohuara e Re	83,333	-	-	-83,333
50	P.Konservatore e Shqipërisë	83,333	-	-	-83,333
51	Aleanca Maqedonase Integrim	83,333	-	-	-83,333
52	FRD	83,333	1.92	1,354,030	1,270,697
53	P.Mb.Drejtave Puntoreve	83,333	-	-	-83,333
54	Aleanca Europiane Ekologjike	83,333	-	-	-83,333
55	P.Bashkimi Demokrat	83,333	0.59	413,380	330,047
56	P.B.Mysliman Shqiptar	83,333	-	-	-83,333
57	P.Europianizim dhe Entegrim	83,333	-	-	-83,333
58	Partia Forca Rinia	83,333	-	-	-83,333
59	LD Vlera, Mirëqënie Progres	83,333	-	-	-83,333
60	Parta Fronti i Majtë	83,333	-	-	-83,333
61	Partia Social Punëtore	83,333	-	-	-83,333
	<b>Shuma në lekë</b>	<b>65,000,000</b>		<b>65,000,000</b>	<b>-----</b>

Pas përfundimit të votimeve për zgjedhjet e pushtetit vendor, KQZ me vendimin nr. 967, datë 10.08.2015 ka kryer rillogaritjet në bazë të përqindjes së fituar në votime, me qëllim korrigjimin e financimit paradhënie për ato subjekte që nuk kanë kaluar pragun 0.5 %, si dhe rillogaritjen dhe ndaljen e diferencave të financuara më tepër në përpjestim me numrin e votave të grumbulluara.

Sipas të dhënave të KQZ-së, janë gjithsej 46 subjekte që duhet të kthejnë vlerën prej 11,688,138 lekë si diferencë midis paradhënies së përfitur dhe vlerës që ka dalë nga rillogaritja e rezultatit, në bazë të votave të grumbulluara në fakt në këto zgjedhje.

Kështu, sipas tabelës së rezultateve 31 subjekte politike, që nuk kanë kaluar pragun 0.5 %, sipas Kodit Zgjedhor do kthejnë vlerën prej 2,583,323 lekë respektivisht nga 83,333 lekë secila. Po kështu, edhe 15 subjekte të tjera sipas votave të grumbulluara pas korrigjimit të rezultatit duhet të kthejnë vlerën prej 9,104,825 lekë, gjithsej shuma 11,958,148 lekë.

Për diferencën e fondeve të përfituara më tepër KQZ ka hartuar dy pasqyra ku janë evidentuar partitë politike që kanë rikthyer diferencën midis paradhënies së përfitur me rezultatit nga rillogaritja përfundimtare sipas votave të grumbulluara.

Nga të dhënat që disponon KQZ, konstatohet se 6 subjekte kanë rikthyer vlerën 4,292,266 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Tabela nr.2

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vlera e arketuar	Data e arkëtimit
1	Partia Demokratike	1,091,229	22.09.2015
2	PBDNJ	1,037,328	22.09.2015
3	PSD	826,966	18.09.2015
4	Partia Balli Kombëtar Demokrat	12,764	18.09.2015
5	PDS	1,321,336	28.09.2015
6	PLZHK	2,643	09.09.2015
	<b>Shuma në lekë</b>	<b>4,292,266</b>	

Nga tabela e mësipërme rezulton se pas rillogaritjes së kryer me vendimin nr. 967, datë 10.08.2015 për subjektet zgjedhore të regjistruara në votimet e pushtetit vendor 2015 në lidhje me votat e grumbulluara për çdo subjekt të regjistruar, nuk kanë rikthyer në KQZ diferencën e financimit 6 parti politike vlerën prej 3,540,941 lekë, e cila është në kundërshtim me “Kodin Zgjedhor”i ndryshuar, Kreu i II-të “Financimi i subjekteve zgjedhore”, neni 87, “Fondet nga buxheti i shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje”, pika 6, ku është përcaktuar se:

“Në rast se shuma e përfituar sipas pikës 5 të këtij neni, është më e vogël se shuma e dhënë paradhënie për financimin e fushatës zgjedhore, sipas nenit 87/2, partia është e detyruar të kthejë diferencën e përfituar. Partitë që nuk kalojnë pragun zgjedhor të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni nuk përfitojnë fonde publike sipas pikës 5.

Partitë që nuk kanë rikthyer diferencën ndonëse kanë kaluar pragun zgjedhor paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3

Nr.	Subjekti zgjedhor	Shuma totale e përfituar nga buxheti	Përqindja e fituar në zgjedhje	Rillogaritja sipas votave të fituara	Diferenca
1	Partia Republikane	3,089,960	3.44	2,428,801	-661,159
2	Partia Lëvizja Legalitetit	1,583,873	0.88	623,728	-960,145
3	Partia Agrare Ambientaliste	1,290,560	0.86	605,123	-685,437
4	P.Bashkimi Liberal Demokratik	1,123,180	0.83	584,756	-538,424
5	Partia Balli Kombëtar	875,920	0.90	638,405	-237,515
6	Partia Lidhja Demokratike Shqip.	844,771	0.55	386,511	-458,261
	<b>Shuma në lekë</b>				<b>3,540,941</b>

**Sipas pikës 8, të nenit 87 përcaktohet: Partia, e cila nuk kthen fondet përkatëse, sipas pikës 6, brenda 90 ditëve, humbet të drejtën e financimeve të tjera nga fondet publike për një periudhë jo më pak se 5 vjet, si dhe nuk regjistrohet si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e rradhës, pavarësisht llojit të tyre, as vetëm dhe as si pjesëtare e ndonjë koalicioni.**

Nga llogaritjet përfundimtare të kryera sipas Kodit Zgjedhor, konstatohen se, 34 subjekte zgjedhore që kanë përfituar fonde publike, dhe pas llogaritjeve kanë rezultuar se kanë përfituar paradhënie më tepër se rezultati i votave të grumbulluara, duhet të kthejnë paradhënien e përfituar.

Sipas të dhënave të KQZ, këto parti nuk kanë marrë asnjë masë për t'i rikthyer në KQZ, paradhënien e përfituar, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:



**KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

**Tabela nr. 4**

	Partitë politike	Shuma totale e përfituar nga buxheti	Përqindja e fituar në zgjedhje	Rillogaritja sipas votave të fituara	Diferenca + ose -
1	PAD	1,375,465	0.73	514,445	-861,020
2	PSV 91	988,749	1.12	788,692	-200,057
3	P G 99	639,084	0.61	428,553	-210,531
4	P.Pop.Kristiandem.Shqipërisë	83,333	-	-	-83,333
5	Aleanca popullore	83,333	-	-	-83,333
6	P.Mendim Djathtë Liberal	83,333	-	-	-83,333
7	PPSH	83,333	-	-	-83,333
8	P.Shqiptare Atdheu	83,333	-	-	-83,333
9	Partia Pajtimit Kombetar	83,333	-	-	-83,333
10	PKSH	83,333	-	-	-83,333
11	P.Rruga e Lirisë	83,333	-	-	-83,333
12	Aleanca Barazi Drejtësi	83,333	-	-	-83,333
13	Partia Çështjeve Shqiptare	83,333	-	-	-83,333
14	PartiaReformave Demokratike	83,333	-	-	-83,333
15	PKSH 8 Nentori	83,333	-	-	-83,333
16	Partia Mbrojtjes së Emigrantëve	83,333	-	-	-83,333
17	PL për Drejtësi Shqiptarëve	83,333	-	-	-83,333
18	P.Personat Aftesi Kufizuar	83,333	-	-	-83,333
19	Partia Ardhmeria Shqiptare	83,333	-	-	-83,333
20	PLD për Ndryshim	83,333	-	-	-83,333
21	Partia Demokracia e Re Europ.	83,333	-	-	-83,333
22	Minoriteti Grek Etnik	83,333	-	-	-83,333
23	Partia e të drejtave të Mohuara	83,333	-	-	-83,333
24	Partia e drejtave mohuara e Re	83,333	-	-	-83,333
25	P.Konservatore e Shqipnisë	83,333	-	-	-83,333
26	Aleanca Maqedonase Integrim	83,333	-	-	-83,333
27	P.Mb.Drejtave Puntoreve	83,333	-	-	-83,333
28	Aleanca Europiane Ekologjike	83,333	-	-	-83,333
29	P.B.Mysliman Shqiptar	83,333	-	-	-83,333
30	P.Europianizim Entegrim	83,333	-	-	-83,333
31	Partia Forca Rinia	83,333	-	-	-83,333
32	LD Vlera,mirëqënie Progres	83,333	-	-	-83,333
33	Partia Fronti i Majtë	83,333	-	-	-83,333
34	Partia Sicial Puntore	83,333	-	-	-83,333
	<b>Shuma në lekë</b>				<b>3,854,931</b>

Subjektet e paraqitura në tabelën e mësipërme ndonëse kanë kaluar 90 ditë nga dita e rillogaritjes, nuk kanë marrë masa për rikthimin e fondeve të përfituara padrejtësisht më tepër në kundërshtim me nenin 87 të nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015 datë 02.04.2015.

Sipas “Kodit Zgjedhor” i ndryshuar, partitë që nuk kanë kaluar pragun zgjedhor do kthejnë vlerën e përfituar paradhënie, e cila do t’u shpërndahet partive që kanë grumbulluar më shumë vota se paradhënia e përfituar. Nga të dhënat që disponon KQZ, konstatohet se, subjektet zgjedhore (partitë politike) fituese që u ka lindur e drejta të përfitojnë më shumë se paradhënia, nuk kanë kërkuar të bëhen veprimet e rillogaritjes për partitë pjesëmarrëse në koalicionin e tyre që nuk kanë kaluar pragun zgjedhor, me qëllim që këto parti të mos kthejnë paradhënien.





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Si rrjedhojë e mos respektimit të Kodit Zgjedhor dhe penalizimin e partive që nuk kalojnë pragun zgjedhor dhe ndihma artificiale e përdorur për moskthimin e fondeve publike të përfutuar padrejtësisht, sjell si pasojë që këto parti jo vetëm të mos penalizohen apo eleminohen, por edhe të ndikojnë në mënyrë indirekte në rritjen e kostos së zgjedhjeve pasardhëse, si dhe të shpenzimeve të tjera që lidhen me hartimin dhe printimin e fletëve të votimit.

Konstatohet se në zgjedhjet vendore të muajit qershor 2015, fondi i vënë në dispozicion, i ka kaluar 5 Partive Politike të renditura të parat (rreth 40 milionë lekë), ndërsa për 40 subjekte politike niveli i përfutimit ka qënë vetëm 83,333 lekë secili. Konstatuam se 31 subjekte zgjedhore (parti politike), ndonëse kanë përfutuar fonde publike, nuk kanë deklaruar pranë KQZ asnjë financim apo donacion tjetër, po kështu edhe 19 kandidatë të pavarur nuk kanë përfutuar fonde publike dhe nuk kanë deklaruar asnjë të ardhur apo donacion tjetër.

Në zbatim të "Kodit Zgjedhor në RSH" i ndryshuar me Ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe me Ligjin nr. 31/2015 datë 02.04.2015, neni 91 "Auditimi i fondeve dhe i shpenzimeve të fushatës zgjedhore" pika 1, "Jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, KQZ-ja emëron me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar, të përzgjedhur sipas nenit 92 të këtij Kodi, për të kryer auditimin e fondeve të përfuturara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore...". 2. Subjektet zgjedhore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni duhet të vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, sipas këtij Kodi. Ndërsa neni 92 pika 4 parashikon "...Buxheti për zgjedhjet duhet të parashikojë edhe fondin e nevojshëm për auditimin e subjekteve zgjedhore".

Eksperti kontabël i licensuar është një profesion i rregulluar dhe vepron brenda një kuadri të mirëpërcaktuar. Me Vendimin nr. 109, datë 20.12.2014 të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve (IEKA), miratuar edhe me Vendimin nr.1, datë 09.03.2015 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, niveli referues i orëve të punës për totalin e të ardhurave deri në 70 milion është 30 ore, dhe duke ditur se tarifa normale orare e miratuar po nga Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve (IEKA) është 3000 lekë/ora atëherë fondi që duhej të programohej për këtë fushatë duhet të ishte shumë më i ulët se shpenzimi aktual. Nisur nga fakti që nga KQZ janë kontraktuar ekspertë kontabël për të cilët janë shpenzuar 4,239,000 lekë, nënkuptohet që Institucioni nuk ka patur një vlerësim të drejtë të fondit të përdorur për auditimin e fondeve të alokuara për zgjedhjet vendore 2015. Të dhënat tregojnë se për auditimin e subjekteve zgjedhore të cilat janë financuar me 83,333 lekë (40 subjekte politike) është paguar vlera 2,976,000 lekë që i korespondon 992 orë auditimi të faturuar nga ekspertët e kontraktuar, pra për vlerën e financimit prej 3,333,320 lekë është paguar 2,976,000 lekë si shpenzim auditimi. Gjithashtu për auditimin e 18 kandidatëve të pavarur të cilët nuk kanë deklaruar të ardhura por as dhe shpenzime për këto zgjedhje, është paguar vlera prej 1,293,000 lekësh (441 orë auditimi).

Nga vlerësimi i bërë Raporteve të Auditimit për disa subjekte zgjedhore përfutues të financimeve publike nga KQZ, konstatohet se nga ekspertët kontabël nuk rezulton të jenë bërë verifikime për të dhënat financiare të deklaruara. Në disa raste deklarohet pamundësi të auditimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të shumë subjekte zgjedhore, pasi nuk kishin deklaruar në KQZ adresë të selisë, apo numër kontakti. Konstatuam 3 raste, ku raportet e auditimit janë hartuar vetëm në bazë të deklaratave të subjekteve zgjedhore, 1 rast ku raporti është hartuar ditën e deklarimit të subjektit zgjedhor dhe në dy raste është hartuar 1 ditë më vonë se deklarata e subjektit, fakt që tregon se ka formalitet në shërbimin e kryer.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportet e Auditimit të subjekteve zgjedhore që kanë përfituar financime publike nga KQZ, u konstatua se:

1. Në raportet e auditimit Ekspertët Kontabël ndonëse kanë evidentuar se, shpenzimet janë kryer konform dispozitave ligjore dhe janë pasqyruar në tabela të veçanta. Në shumë raste të tjera nuk janë hartuar tabela përmbledhëse analitike ku të evidentohen shpenzimet sipas natyrës dhe destinacionit për fondet e përfituara nga buxheti i shtetit për zgjedhjet vendore, e konkretisht, shpenzimet për blerje "pajisje të ndryshme kompjuterike", për të cilat ekspertët kontabël nuk kanë evidentuar në se janë dokumentuar dhe kontabilizuar në aktiv të bilancit kontabël të subjektit juridik zgjedhor. Kështu përmendim; auditimin e kryer nga znj. [ ] në subjektin zgjedhor "Partia Demokristiane Shqiptare" për blerje pajisje kompjuterike në shumën 247,920 lekë, apo shpërblime të ndryshme në shumën 292,000 lekë për të cilat nuk është evidentuar në se është bërë veprimi kontabël në aktivet e subjektit apo mënyra e pagesës për shpërblime, tatimi i ndalur në burim dhe i xhiruar në degën e tatim Taksave?
2. Nga verifikimi i kryer në raportet e auditimit konstatohet se, për auditimin e partive që kanë përfituar financim të barabartë të fondeve nga KQZ dhe nuk kanë burim tjetër nëpërmjet sponsorizimeve apo donacione, dhe që nuk kanë kryer asnjë shpenzim, nga ekspertët kontabël nuk rezultojnë të jenë bërë verifikime për të dhënat financiare të këtyre subjekteve. Këto subjekte ndonëse janë në kushte të barabarta, kontratat për auditimin e tyre janë lidhur me orë dhe vlera të ndryshme, duke filluar nga 5 orë deri në 30 orë. Gjithashtu, duhet theksuar se, në mungesë të të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera, pagesat ndaj ekspertëve janë kryer të diferencuara, ndërkohë që duhej të kishin në një minimum të pranueshëm, me qëllim kufizimin e shpenzimeve dhe uljen e kostos së auditimit.
3. Në disa raporte auditimi pasqyrat e shpenzimeve nuk janë konfirmuar nga financierët e subjekteve juridikë zgjedhorë, por janë nënshkruar vetëm nga eksperti kontabël, kështu përmendim raportet e auditimit të disa subjekteve si, "Partia e Ballit Kombëtar", "Partia Demokratike e re Europiane" dhe "Partia Socialiste e Vërtetë 91", duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me standardet e auditimit, për të justifikuar kryerjen e auditimit në prani të subjektit zgjedhor.
4. Në disa raste, ekspertët kontabël për auditimin e shpenzimeve nuk kanë hartuar tabela analitike për natyrën dhe llojin e shpenzimeve por kanë evidentuar vlerën totale të tyre, ndër të cilat përmendim raporin e auditimit të ekspertit kontabël [ ] për auditimin e "Partisë Socialiste të Vërtetë 91", ku është evidentuar se kjo parti ka përfituar fonde publike në vlerën prej 788,692 lekë dhe shpenzimet janë kryer sipas dispozitave ligjore, pa i analizuar sipas natyrës dhe llojit të tyre së bashku me dokumentacionin justifikues.
5. Sipas raportit të auditimit të hartuar nga ekspertja kontabël [ ] konstatohet se, Partia Balli Kombëtar ka përfituar fonde nga buxheti i shtetit në shumën 875,920 lekë, të cilat janë depozituar në llogarinë bankare. Sipas të dhënave të raportit të auditimit, janë përdorur vetëm 250 lekë "shpenzime për komision bankar". Sipas këtyre të dhënave nuk rezultojnë të jenë kryer shpenzime për zgjedhje. Në raportin e auditimit nuk ka të dhëna në se janë verifikuar burime të tjera të të ardhurave, pasi audituesja shprehet se, "kjo parti nuk ka përdorur shpenzime në fushatën zgjedhore". Nga rillogaritjet e kryera në përfundim të zgjedhjeve, Partia "Balli Kombëtar", duhet të rikthejë shumën prej 237,515 lekë, të cilat nuk i ka rikthyer me kalimin e afatit 90 ditor të përcaktuar në kodin zgjedhor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

6. Në raportin e paraqitur nga eksperti kontabël [i] osha për auditimin e "Partisë për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë" konstatohet se, ky subjekt nuk ka përfituar fonde publike, sponsorizime apo donacione nga individë apo subjekte të ndryshme. Me ekspertin kontabël është lidhur kontrata nr. 7760, datë 07.10.2015, për 25 orë auditim në vlerën prej 75,000 lekë.

Me urdhër shpenzimit nr. 588, datë 21.12.2015, janë likuiduar shpenzimet e kryera nga eksperti kontabël për auditimin e 4 subjekteve të ndryshme zgjedhore për 100 orë auditim në vlerën totale prej 300,000 lekë. Sipas aneksit bashkëlidhur raportit për "Auditimin e Partisë për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë", rezulton se janë shpenzuar 10 orë pune për auditimin e kësaj partie dhe jo 25 orë që janë parashikuar në kontratën e lidhur me Ekspertin Kontabël.

Këto të dhëna tregojnë se, ka munguar rakordimi midis të dhënave të kontratës dhe dokumentacionit të paraqitur nga eksperti kontabël protokolluar me nr. 7910/1, datë 11.11.2015, për faktin se midis këtyre dy programeve ka diferencë të pajustificuar për 15 ore në vlerën **45,000 lekë**.

7. Nga të dhënat e raporteve të auditimit konstatohet se, edhe në ato raste që subjektet politike zgjedhore kanë përfituar paradhënie në vlerën prej 83,333 lekë dhe nuk kanë kryer asnjë shpenzim, vlera e përfituar paradhënie është gjendje në llogarinë rrjedhëse bankare të subjektit. Në këto raste eksperti kontabël nuk ka rekomanduar pranë KQZ, për të marrë masa të menjëherëshme për bllokimin e llogarive të tyre pranë bankës ku janë depozituar; kështu përmendim auditimin e kryer tek "Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë" dhe "Partia Ardhmëria Shqiptare" të cilat kanë përfituar respektivisht nga buxheti 83,333 lekë dhe në përfundim kjo vlerë nuk është përdorur por është gjendje në llogarinë bankare të subjektit zgjedhor dhe nuk është rikthyer vlera e përfituar paradhënie prej 83,333 lekë brenda 90 ditëve në KQZ.

Në lidhje me detyrimet e pa arkëtuara KQZ, shpjegon se, "subjektet zgjedhore (partitë politike) fituese që pas rillogaritjes së votave të grumbulluara, u ka lindur e drejta të përfitojnë më shumë se paradhënia, nuk kanë kërkuar të bëhen veprimet e rillogaritjes, pasi partitë kryesore, duke i kosideruar partitë e vogla si pjesmarrëse në koalicion pranojnë të mos përfitojnë këtë vlerë, mjafton që partitë e koalicionit të tyre, të mos rikthejnë diferencën e përfituar më tepër".

**Kjo mënyrë tregon se, kjo skemë do funksionojë edhe në zgjedhjet e tjera të rradhës duke rritur në mënyrë artificiale shpenzimet e zgjedhjeve, si rrjedhojë e mos respektimit të dispozitave të "Kodit Zgjedhor në RSH", pasi partitë e mëdha bëhen mbrojtëse artificiale të partive të vogla që nuk kalojnë pragun zgjedhor.**

8. Në disa raste nuk është bërë e mundur auditimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi shumë subjekte zgjedhore nuk kanë deklaruar në KQZ adresën e selisë së partisë, si dhe "nuk u mundësua asnjë numër kontakti me telefon" shprehje kjo e përdorur nga ekspertët kontabël. Në këto raste, ndonëse ekspertët kontabël janë ndodhur para kushteve të njëjta janë paguar me orë të ndryshme kështu:

- Për auditimin e subjektit zgjedhor "Partia e Reformave Demokratike" eksperti kontabël është paguar me 35 orë auditim në vlerën 105,000 lekë (3,000 lekë/orë);
- Për auditimin e subjektit zgjedhor "Partia Fronti i Majtë", ekspertja është paguar me 7 orë në shumën 21,000 lekë;
- Audituesja është paguar 105 orë në vlerën 315,000 lekë ndërkohë që është shprehur se nuk ka audituar asnjë prej 4 subjekteve zgjedhore të regjistruar për mungesë adresash apo numër kontakti telefoni, të subjekteve zgjedhore "Partia Ora e Shqipërisë", dhe 3 kandidatë të pavarur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDOR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

9. Në disa raste nuk është bërë e mundur auditimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi shumë subjekte zgjedhore nuk kanë deklaruar në KQZ adresën e selisë së partisë, si dhe nuk u mundësua asnjë numër kontakti me telefon (shprehje e përdorur nga ekspertët kontabël). Në këto raste, ndonëse akseptet kontabël janë ndodhur para kushteve të njëjta janë paguar me orë të ndryshme kështu:

- Për auditimin e subjektit zgjedhor "Partia e Reformave Demokratike" audituesi është paguar me 35 orë auditim në vlerën 105,000 lekë (3,000 lekë/orë);
- Për auditimin e subjektit zgjedhor "Partia Fronti i Majtë", audituesja është paguar me 7 orë në shumën 21,000 lekë;
- Audituesja është paguar 105 orë në vlerën 315,000 lekë ndërkohë që është shprehur se nuk ka audituar asnjë prej 4 subjekteve zgjedhore të regjistruar për mungesë adresash apo numër kontakti telefoni, të subjekteve zgjedhore "Partia Ora e Shqipërisë", dhe 3 kandidatë të pavarur.

Pë sa më lart (për pikën 8 dhe 9) diferencimi në pagesën e ekspertëve kontabël të cilët ndonëse nuk kanë kryer asnjë orë pune janë shpërblyer me orë të ndryshme, ndërsa për subjektin zgjedhor që nuk i është nënshtruar auditimit, KQZ nuk ka marrë asnjë masë konkrete për penalizimin e tyre sipas dispozitave ligjore, që parashikohet në nenin 91, pika 5 të "Kodit Zgjedhor" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *"Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në këtë Kre, nga subjektet zgjedhore, në rast se nuk përbën veprë penale është kundrvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas parashikimeve të pjesës XIV të këtij Kodi"*. Në fakt ky është orientim i gabuar pasi sanksionet janë parashikuar në Pjesën XIII "Përgjegjësitë dhe Sanksionet" dhe jo XIV të Kodit dhe konkretisht sipas, nenit 173 "Sanksionet në lidhje me financimin e fushatës" në pikën 2, parashikohet: *"Mosbashkëpunimi me auditin e KQZ-së nga ana e subjektit zgjedhor dënohet me gjobë nga 1,000,000 lekë deri në 2,000,000 lekë"* dhe në pikën 3 të po këtij neni parashikohet se: *"Refuzimi për të bërë transparent burimet e financimit të fushatës, apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e auditit, dënohet me gjobë nga 2,000,000 lekë deri në pezullimin për 5 vjet të financimit publik për partinë politike"*.

10. Në 3 raste konstatohet se, raportet e auditimit janë hartuar vetëm në bazë të deklaratave të subjekteve zgjedhore, në të cilat përfaqësuesi apo finansiari i subjektit deklaroi se nuk ka përfituar as fonde publike, sponsorizime dhe as ka kryer shpenzime, në 1 rast raportet janë hartuar ditën e deklarimit të subjektit zgjedhor dhe në dy raste janë hartuar 1 ditë më vonë se deklarata e subjektit, fakt që tregon se, është shpenzuar një kohë tepër e kufizuar dhe megjithatë pagesat janë kryer për 25 orë auditimi, ndonëse janë hartuar deri 1.5 faqe format A4 dhe nuk paraqesin asnjë informacion për të ardhurat dhe shpenzimet, kështu përmendim subjektet zgjedhore të mëposhtme:

-Kandidati i pavarur për Bashkinë Tepelenë, në datën 23.10.2015 deklaroi se nuk ka përfituar asnjë financim apo sponsorizim, dhe po në datën 23.10.2015 ekspertja kontabël hartoi raportin e auditimit për të cilën paguhet me 25 ore në vlerën 75,000 lekë.

-Subjekti zgjedhor "Partia Demokratike për Ndryshim", drejtuesi i partisë deklaroi se, nuk ka marrë fonde publike dhe nuk disponon asnjë dokument që ka bërë shpenzime. Raporti i auditimit hartohet në datën 11.11.2015, ndërsa deklarata e drejtuesit të partisë mban datën 10.11.2015. Në këtë raport nuk ka asnjë të dhënë nëse audituesit kanë bërë verifikime konform "Kodit Zgjedhor në RSH" neni 91 pika 3, ku përcaktohet se: "Subjekti zgjedhor që auditohet duhet të vërë në dispozicion çdo informacion që disponojnë bankat, apo të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

autorizojë audituesin për tërheqjen e informacionit nga persona të tretë”, për të justifikuar në këtë mënyrë pagesën për 25 orë në vlerën rreth 75,000 lekë;

-Subjekti zgjedhor kandidati i pavarur \_\_\_\_\_, ka deklaruar në datën 12.11.2015 se nuk ka përfutur fonde publike dhe as nuk ka kryer shpenzime, raporti hartohet nga Shkëlzen Margjeka 1 ditë më pas në datën 13.11.2015, pa kryer asnjë verifikim tjetër, për të justifikuar pagesën për 25 orë në shumën 75,000 lekë.

Për mangësitë e trajtuara më lart mbajnë përgjegjësi ekspertët kontabël, respektivisht:

\_\_\_\_\_, të cilët nuk kanë rrespektuar parimet standarde të kontabilitetit në auditimin e pasqyrave financiare dhe nenin 91, të “Kodit Zgjedhor në RSH” i ndryshuar, në kryerjen e auditimit të subjekteve zgjedhore.

Nga ana e Ekspertëve kontabël \_\_\_\_\_ janë paraqitur observacione në lidhje me Projektraportin e Auditimit bashkëlidhur observimeve të bëra nga KQZ me shkresën nr. 226/12 datë 17.05.2016.

*Në lidhje me observacionet e paraqitura nga këto tre ekspertë kontabël, të cilët, ndonëse duhet të jenë të ndërgjegjshëm që kanë përfutur të ardhura edhe në rastet që nuk kanë bërë asnjë orë punë auditimi. Konstatohen dhe raporte auditimit të mbajtura në mënyrë të njëanshme pa praninë e përfaqësuesve ligjorë të partive duke i konsideruar normale!. Janë evidentuar shpenzimet pa bërë analiza sipas zërave, ndonëse konstatohen raste për blerje pajisje kompjuterike me fonde publike nga KQZ-ja, nuk pasqyrojnë veprimin në se këto janë kontabilizuar në asetet e partive, apo edhe shpërblime të ndryshme, për të cilat nuk ka të dhëna për ndalesat e tatimit në burim. Në vend të reflektimit në punën e tyre por dhe të KQZ shprehen në mënyrë emocionale në observacione duke i konsideruar konstatimet e auditimit si tendencioze nga ana e KLSH-së. Kjo tregon më së miri gjendjen me proceset audituese të organizuara nga KQZ për fondet publike të përfuturara nga partitë politike.*

### **III. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave**

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në drejtim të pikës 3 të Programit të Auditimit nr. 1131/1, datë 11.12.2015, i ndryshuar, “Zbatimi i dispozitave ligjore për pagat dhe shpërblimet” ka rezultuar si më poshtë:

Struktura organike e KQZ-së është miratuar me vendimin nr. 110, datë 12.09.2002 “Për miratimin e strukturës, organikën dhe numrin e punonjësve të administratës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”. Me vendimin nr. 5, datë 04.05.2010, struktura e administratës, nga 61 punonjës është shkurtuar në 55 punonjës, përfshirë edhe anëtarët e KQZ-së, ky pakësim ka ardhur si rrjedhojë e pakësimit të numrit të shoferëve për anëtarët e KQZ. Me anë të vendimit nr. 16, datë 27.11.2012 Për një ndryshim në vendimin nr. 110, datë 12.09.2002, “Për Miratimin e strukturës, organikës dhe numrit të punonjësve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, i ndryshuar, u ndryshua emërtesa e pozicionit të punës, Ndihmës i Kryetarit të KQZ-së në Këshilltar i Kryetarit të KQZ-së, u bënë dy shtesa për pozicionin e punës, (Sekretar i Kryetarit të KQZ-së dhe punonjës mirëmbajtje), si dhe u bë suprimimi për dy pozicione pune (operator në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shofer në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Logjistikës Zgjedhore). Mbështetur në nenin 21, pika 21 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, KQZ-ja ka kompetencë, “Miratimin e strukturës, organikës dhe strukturën e pagave të administratës së KQZ-së me kohë të plotë pune dhe asaj me kohë jo të plotë”,

Nga auditimi rezultoi se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka një strukturë dhe organikë të miratuar që përbëhet nga 7 anëtarë dhe 48 nëpunës/punonjës, gjithsej 55 punonjës, sipas ligjit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 110, datë 12.09.2002, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe numrit të punonjësve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", i ndryshuar.

Për vitin 2014, organika nga 55 punonjës të programuar, nuk është respektuar, në fakt rezulton që organika nuk është plotësuar dhe ka pasur luhatje nga 46 punonjës deri në 51 punonjës me një mesatare prej 48 punonjësish, edhe për vitin 2015 nga 55 punonjës të programuar, në fakt rezulton që organika nuk është plotësuar dhe ka pasur luhatje nga 48 punonjës deri në 54 punonjës me një mesatare prej 52 punonjësish.

Sipas ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 110, datë 12.09.2002, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe numrit të punonjësve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", i ndryshuar, dhe sipas lidhjes 2 të Vendimit nr. 16, datë 27.11.2012 Për një ndryshim në vendimin nr. 110, datë 12.09.2002, "Për Miratimin e strukturës, organikës dhe numrit të punonjësve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", i ndryshuar Organika e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve renditet si më poshtë:

- I. Kryetari i KQZ-së
  - II. Zëvendëskryetar i KQZ-së
  - III. Anëtarët e KQZ-së
  - IV. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së
  - V. Drejtorja e Burimeve Njerëzore ka 6 punonjës dhe është e përbërë nga një drejtor, 4 specialist dhe një jurist i prokurimeve.
  - VI. Drejtorja Juridike ka 3 punonjës dhe është e përbërë nga një drejtor dhe dy jurist.
  - VII. Drejtorja e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve ka 9 punonjës dhe është e përbërë nga një drejtor, 4 inspektor dhe është e ndarë në dy sektorë: *Spektori i Trajnimit të Komisioneve Zgjedhore* është i përbërë nga një përgjegjës sektori dhe një specialist.  
*Spektori i Edukimit të Zgjedhësve* është i përbërë nga një përgjegjës sektori dhe një specialist, redaktor.
  - VIII. Drejtorja e Shërbimeve dhe Logjistikës ka 3 punonjës dhe është e përbërë nga një drejtor, një specialist dhe ka një sektor (*Spektori i Shërbimeve*, i përbërë nga një përgjegjës sektori).
  - IX. Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit ka 3 punonjës dhe është e përbërë nga një drejtor dhe dy specialist IT.
  - X. Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë ka 2 punonjës dhe është e përbërë nga një drejtor dhe një specialist
  - XI. Drejtorja e Financës ka 3 punonjës dhe është e përbërë nga një drejtor dhe ka një sektor (*Spektori i Financës*, i përbërë nga një përgjegjës sektori dhe një specialist).
- Zëdhënës i KQZ-së (1 punonjës)  
Këshilltar i Kryetarit të KQZ-së (1 punonjës)  
Sekretar i Kryetarit të KQZ-së (1 punonjës)  
Sekretar i Anëtarëve të KQZ-së (2 punonjës)  
Punonjës Mbështetës të KQZ-së ka 13 punonjës dhe është e përbërë nga një përgjegjës ofiçine, transporti e shofer, një teknik i mesëm, një arkivist protokollist, dy operator, një magazinier, katër shoferë, një fotokopjues (postier), një punëtor mirëmbajtës, një pastrues.
- Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitet 2014 dhe 2015, ka funksionuar në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimet e KQZ-së. Struktura e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është ndryshuar një herë me vendimin nr. 16, datë 27.11.2012 Për një ndryshim në vendimin nr. 110, datë 12.09.2002, "Për Miratimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

strukturës, organikës dhe numrit të punonjësve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", dhe deri më tani nuk ka pasur ndryshime të tjera.

Struktura organike, numri i përgjithshëm i punonjësve për vitet 2014 dhe 2015 të miratuar sipas strukturave organike me faktin, nuk është plotësuar, dhe paraqitet:

Nr. i punonjësve për vitet 2014 dhe 2015					
Plan/Organika ka 55 punonjës	Fakt		Vende pa plotësuar		
	2014	2015	2014	2015	
Janar	55	51	48	4	7
Shkurt	55	50	51	5	4
Mars	55	49	51	6	4
Prill	55	49	52	6	3
Maj	55	48	52	7	3
Qershor	55	48	52	7	3
Korrik	55	47	52	8	3
Gusht	55	47	52	8	3
Shtator	55	47	52	8	3
Tetor	55	46	54	9	1
Nëntor	55	47	53	8	2
Dhjetor	55	48	52	7	3
Mesatarja		48.08	51.75		

Nga auditimi u vërejt se, trajtimi me pagë i punonjësve bëhet sipas akteve ligjore që rregullohen me Statusin e Nëpunësit Civil dhe të gjithë punonjësit janë pjesë e strukturës të Administratës së KQZ-së dhe se është respektuar struktura dhe nivelet e pagave sipas klasifikimit të funksioneve, duke përfshirë pagën bazë mujore, pagën e grupit, tatimin mbi të ardhurat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, dhe shtesën për vjetërsi, etj.

**Nga auditimi i respektimit të dispozitave ligjore për caktimin e pagave të punonjësve të institucionit të KQZ-së rezultoi se:**

Pagat e punonjësve janë vendosur sipas funksionit dhe kategorisë konform ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, Vendimit nr. 589, datë 17.07.2013 për disa ndryshime në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të këshillit të ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, gjykatën e lartë, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", të ndryshuar; Vendimit nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të këshillit të ministrave/kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit"; Vendimit nr. 1231, datë 02.07.2008 "Për pagat e punonjësve



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

mbështetës, në institucionet buxhetore, dhe të nëpunësve, në disa institucione buxhetore”, Vendimit nr. 474, datë 16.06.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”; Vendimit nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore" i ndryshuar; Ligjit nr. 9584 datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", i ndryshuar, me Ligjin nr. 9845, datë 17.12.2007, Ligjit nr. 185/2013 "Për buxhetin e vitit 2014", dhe Ligjit nr. 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015" Ndërsa pagat e punonjësve mbështetës janë përcaktuar në VKM nr. 551, datë 11.08.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”.

Nga auditimi që iu bë listëpagesave, listëprezencave dhe ballafaqimit me pagesat e borderove me borderotë e analizës bankare të vitet 2014 dhe 2015, duke i krahasuar me strukturën analitike të përditësuar dhe sipas organikës së miratuar sipas lidhjes 2 të Vendimit nr. 16, datë 27.11.2012 Për një ndryshim në vendimin nr. 110, datë 12.09.2002, "Për Miratimin e strukturës, organikës dhe numrit të punonjësve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", i ndryshuar, rezultoi se punonjësit e paguar janë pjesë e strukturës së subjektit dhe janë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi të përcaktuara më sipër.

**Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Aparatin e KQZ-së, për vitin 2014 paraqitet në tabelën si më poshtë:**

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2014		
		Plan	Fakt	%
1	Pagat (600)	60,000,000	48,419,477	81%
2	Sig. Shoq. (601)	8,000,000	7,390,666	92%
3	Fondi i veçantë	-	-	-

Nga treguesit e mësipërm rezultojnë se, për vitin 2014, fondi i pagave është realizuar në masën 81%. Është vërejtur se në llogaritjet e pagave, pagave të grupit, sigurimin shoqëror dhe tatimin mbi pagat janë bërë në bazë të dispozitave ligjore për marrëdhëniet në punë dhe respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Listëpagesat e dorëzuara në thesar janë të nënshkruara nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe nga Drejtori i Financës por nuk janë të nënshkruara nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore duke mos plotësuar pikën 69, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

**Nga auditimi i llogaritjes së raporteve mjekësore për vitet 2014 dhe 2015, rezultoi se, nuk është mbajtur tatimi për raportet mjekësore.** Vlera e përlllogaritur e raporteve mjekësore shtohet në fund, pasi pagës i ish-in mbajtur tatimi mbi pagën, sigurimet shoqërore/shëndetësore e suplementare për ditët që punonjësi kishte qenë në punë. Pra në rast se punonjësi ka marrë raport nën 14 ditë, pagesë e cila përballohet nga fondi i pagave të KQZ-së, nuk është bashkuar me pagën e përfituar nga puna, në mënyrë që tatimi të llogaritet për të dy këto të ardhura. Kjo mënyrë llogaritje është në kundërshtim me nenin 8 "E ardhura e tatueshme" pika "a" të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, dhe pika 2. "Tatimi mbi të ardhurat personale", pika 2.3 "Të ardhurat e





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

tatueshme", pika 2.3.1 të Udhëzimit nr. 5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Nga përlllogaritja e kryera rezultoi se, për periudhën objekt auditimi (2014 dhe 2015), u konstatua se, nuk janë llogaritur dhe ndalur tatimi mbi pagën dhe sigurimet shoqërore/shëndetësore të paguara në shumën prej **272,128 lekë**. Sektori i financës të marri masa që për të ardhmen të zbatohen dispozitat ligjore të përmenduar më lart në lidhje me mbajtjen e tatimeve për raportet mjekësore, sipas përcaktimeve.

**Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Aparatin e KQZ-së, për vitin 2015 paraqitet në tabelën si më poshtë:**

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2015		
		Plan	Fakt	%
1	Pagat (600)	58,504,000	57,247,037	97.85%
2	Sig. Shoq. (601)	8,000,000	8,000,000	100%
3	Fondi i veçantë	-	-	-

Nga treguesit e mësipërm rezultoi se, për vitin 2015, fondi i pagave është realizuar në masën 97.85%. Është vërejtur se edhe për vitin 2015, llogaritjet e pagave, pagave të grupit, sigurimin shoqëror dhe tatimin mbi pagat janë bërë në bazë të dispozitave ligjore për marrëdhëniet në punë dhe respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Edhe për vitin 2015 Listëpagesat e dorëzuara në thesar janë të nënshkruara nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe nga Drejtori i Financës por nuk janë të nënshkruara nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore duke mos plotësuar pikën 69, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2015, në administratën e KQZ-së janë paguar orë jashtë kohës normale të punës (*orarit zyrtar*) për punonjësit e administratës së institucionit, në funksion të përgatitjes së procesit zgjedhor, për zgjedhjen e Organeve të Qeverisjes Vendore të datës 21 Qershor 2015. Punonjësve të Administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, u është kërkuar të punojnë jashtë orarit zyrtar të punës. Me urdhrin e brendshëm nr. 21, datë 09.03.2015 "Për kryerjen e orëve jashtë orarit zyrtar të punës të punonjësve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve" nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, në pikat nr. 1 dhe 2 të këtij urdhri është përcaktuar se: *Për periudhën 9 mars 2015 deri më datë 31 gusht 2015, orari ditor i punës për punonjësit e Administratës së KQZ-së të jetë:*

❖ *Ditët nga e hëna deri të premten 08:00 – 18:00, ora 12:30 deri 13:30 pushim*

❖ *Ditët e shtuna 09:00 - 14:00*

Në zbatim të këtij urdhri janë përgatitur listëprezencat për kohën e punës së administratës së KQZ-së sipas drejtorive, dhe për çdo muaj është nxjerrë urdhër nga titullari i KQZ-së për pagesat e orëve shtesë.

➤ *Urdhri nr. 16, datë 28.02.2015 pagesë për muajin shkurt 2015. Pagesë për 28 punonjës, 1021 orë pune me vlerë 612.107 lekë, sipas kohëshënuesit në fakt janë paguar 28 punonjës.*

➤ *Urdhri nr. 29, datë 31.03.2015 pagesë për muajin mars 2015. Pagesë për 43 punonjës, 1685 orë pune me vlerë 941.050 lekë, sipas kohëshënuesit në fakt janë paguar 43 punonjës.*

➤ *Urdhri nr. 48, datë 30.04.2015 pagesë për muajin prill 2015. Pagesë për 43 punonjës, 1720 orë pune me vlerë 943.197 lekë, sipas kohëshënuesit në fakt janë paguar 43 punonjës.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

- Urdhri nr. 78, datë 29.05.2015 pagesë për muajin maj 2015. Pagesë për 43 punonjës, 1720 orë pune me vlerë 943.196 lekë, sipas kohëshënuesit në fakt janë paguar 43 punonjës.
- Për muajin qershor 2015 nuk ka urdhër për pagimin e orëve shtesë dhe nuk ka as listëprezenca për orët shtesë, por është bërë pagesë për 43 punonjës me nga 1720 orë pune me vlerë 943.196 lekë.
- Urdhri nr. 125, datë 31.07.2015 pagesë për muajin korrik 2015. Pagesë për 43 punonjës, 1720 orë pune me vlerë 943.197 lekë, sipas kohëshënuesit në fakt janë paguar 43 punonjës.
- Për muajin Gusht 2015 nuk ka urdhër për pagesë punonjësish jashtë orarit zyrtar të punës, pra nuk janë kryer orë jashtë orarit zyrtar.

Nga auditimi i dokumentacionit për këtë periudhë rezultoi se, pagesat për orët shtesë të administratës së KQZ-së është konsideruar si veprimtari operacionale, kjo problematikë bie në kundërshtim me VKM 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar, Kreu I "Kohëzgjatja e punës" pika 5 "Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari administrative, orët shtesë në punë i kompensohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00-6:00.

Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari operacionale, orët shtesë në punë, si rregull, i kompensohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00-6:00. Titullari i institucionit detyrohet t'ia japë kërkuarit këtë pushim, brenda 2 (dy) muajve nga kryerja e orëve shtesë".

Për këto arsye, Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, me shkresën nr. 607, datë 21.01.2015 drejtuar Ministrit të Financave i ka kërkuar, miratimin e kompensimit financiar për orët shtesë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si veprimtari operacionale. Ministria e Financave me shkresën nr. 902/1 datë 27.01.2015 ka miratuar këtë kërkesë, por në rastin konkret ndonëse e ka specifikuar si rast të veçantë duhet të kërkonte pranë Këshillit të Ministrave ndryshime në Kreun e I-rë të vendimit të mësipërm për rastin specifik që ka KQZ-ja në zgjedhjet vendore apo parlamentare, me qëllim përdorimin efektiv të fondit të pagave.

Gjithashtu në funksion të zgjedhjeve vendore të vitit 2015 KQZ-ja ka miratuar strukturën e personelit mbështetës dhe saktësisht me vendimin nr. 8, datë 21.01.2015 "Për miratimin e strukturës së personelit mbështetës të KQZ-së, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015" dhe lidhjes 1 të këtij vendimi, "për strukturën e pagave të personelit mbështetës" bazuar në nenin 21, pika 21 dhe nenin 23, pika 1, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe VKM-të për pagat. Sipas këtij vendimi ishin parashikuar të merreshin 335 punonjës të përkohshëm në pozicione të ndryshme me kohëzgjatje nga 1 deri në 6 muaj, duke përcaktuar edhe nevojat konkrete sipas detyrave përkatëse. Sipas këtij vendimi të KQZ-së, në vendim thuhet se arsyeja e rekrutimit të personelit mbështetës është se:

"Referuar eksperiencave të mëparshme, duke marrë në konsideratë punën voluminoze që kryhet, nga administrata për përgatitjen, mirëorganizimin dhe mirëmenaxhimin e procesit zgjedhor që nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës deri në daljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, është parë e arsyeshme rekrutimi i personelit mbështetës me kohë jo të plotë pune. Në këtë kuadër të detyrimeve ligjore që ka KQZ-ja, lidhur me organizimin, administrimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

vendore, që do të zhvillohen më datë 21 Qershor 2015, paraqitet e nevojshme që të miratohet një shtesë në organikën e KQZ-së, e cila përmbledh punonjës të kategorive të ndryshme, të cilët do të rekrutohen dhe do të punojnë për përgatitjen e zgjedhjeve, në të gjitha strukturat e Administratës së KQZ-së...".

Për çdo rekrutim, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka marrë vendim përkatës me objekt "emërim personeli të përkohshëm", në të cilin është përcaktuar afati i fillimit dhe i mbarimit të punës. Këto vendime janë nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së.

Struktura organike, numri i përgjithshëm i personelit mbështetës për zgjedhjet vendore të vitit 2015 paraqitet si më poshtë :

Nr.	Emërtimi	Numri	Koha e punësimit
1	Sekretar për Anëtarët e KQZ-së	7	6 muaj, deri në shpalljen e rezultatiit përfundimtar të zgjedhjeve
2	Sekretar për Sek. e Përgj. të KQZ-së	1	
<b>II</b>			
1	Specialist	5	5 muaj
2	Specialist, teknologji informacioni	1	4 muaj
3	Specialist, Inspektor për Zyrat Rajonale Zgjedhore	24	5 muaj
4	Specialist për trajnimet	3	5 muaj
5	Specialist, grafist	1	4 muaj
6	Specialist për edukimin e zgjedhësve	1	5 muaj
		1	4 muaj
7	Specialist, redaktor	1	6 muaj
		1	5 muaj
8	Operator	24	1 muaj
9	Punëtor për përgatitjen e bazës materiale për trajnimet	1	2 muaj
<b>III</b>			
1	Specialist Logjistike	2	5 muaj
		14	4 muaj
		2	3 muaj
2	Specialist Shërbimesh	2	4 muaj
3	Specialist Teknik Sälle	2	4 muaj
4	Nëpunës informacioni/centralist	2	4 muaj
5	Fonist	2	6 muaj
6	Elektriciçist	2	3 muaj
7	Punëtor	60	4 muaj
8	Punëtor	30	2 muaj
9	Punëtor magazine	5	5 muaj
10	Ndihmës magazinier	1	5 muaj
11	Punëtor pastrimi	3	5 muaj
<b>IV</b>	<b>Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit</b>		



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

1	Specialist IT	6	6 muaj
2	Specialist , për kontrollin e të dhënave elektronike	3	2 muaj
3	Specialist, për faqosje buletini	3	2 muaj
4	Specialist, për hartat	1	4 muaj
5	Operator për qendrën e informimit	6	3 muaj
6	Operator për hedhjen e të dhënave për procesin zgjedhor	26	1.5 muaj
7	Operator për kontrollin elektronik të tabelave të rezultateve	40	1 muaj
8	Operator për kontrollin manual të tabelave të rezultateve	5	1 muaj
<b>V</b>			
1	Specialist, për marrëdhëniet e punës	2	4 muaj
2	Specialist, jurist për prokurimet	2	4 muaj
3	Specialist, Arkivi	2	6 muaj
4	Specialist, Protokolli	4	6 muaj
5	Specialist, Sekretaria Teknike	4	6 muaj
6	Specialist, Sekretaria Teknike	6	4 muaj
7	Operator Arkivi	1	5 muaj
8	Operator Protokolli	2	5 muaj
9	Fotokopjues	4	4 muaj
10	Postier	3	4 muaj
<b>VI</b>			
1	Specialist, Jurist	3	6 muaj
2	Specialist, Jurist	3	4 muaj
3	Specialist, Jurist	3	3 muaj
<b>VII</b>			
1	Specialist	1	5 muaj
2	Specialist, përkthyes	2	5 muaj
<b>VIII</b>			
1	Specialist	3	6 muaj
<b>IX</b>			
1	Specialist	2	3 muaj
<b>Gjithsej</b>		<b>335</b>	

**Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore për personelin mbështetës të KQZ-së, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015 , paraqitet në tabelën si më poshtë:**

*Në lekë*

Nr.	Personeli mbështetës	Viti 2015 (personeli mbështetës)		
		Plan	Fakt	%
1	Pagat (600)	64,879,285	53,724,833	82.81%
2	Sig. Shoq. (601)	8,000,000	6,861,620	85.77%



KONTROLLI I LARTË SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Nga treguesit e mësipërm rezulton se, fondi i pagave për personelin mbështetës është realizuar në masën 82.81%. Llogaritjet e pagave, sigurimin shoqëror/shëndetësor dhe tatimin mbi pagat janë bërë në bazë të dispozitave ligjore për marrëdhëniet në punë dhe respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Listëpagesat e dorëzuara në thesar janë të nënshkruara nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe nga Drejtori i Financës por nuk janë të nënshkruara nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore duke mos plotësuar pikën 69, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore etj.**

Nga auditimi i kryer, u konstatua se në KQZ për vitet 2014 dhe 2015, nuk ka patur raste të përdorimit të fondit të veçantë që krijohet në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, ndryshuar me VKM nr. 493, datë 06.07.2011, fondi i veçantë, i cili krijohet në Ministrinë e Financave.

**Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.**

Për periudhën objekt auditimit kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale të punonjësve, janë llogaritur e mbajtur nga paga e punonjësve, në respektim të akteve ligjore si ligji nr. 104/2014 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 184/2013 për disa ndryshime dhe shtesa, ligjit nr. 87/2014 për disa ndryshime në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas planit për vitin 2014, fondi i sigurimeve shoqërore ka qenë 8,000,000 lekë dhe është realizuar 7,390,666 lekë ose 92 %. Për sa i përket vitit 2015 fondi i sigurimeve shoqërore është 8,000,000 lekë dhe është realizuar 8,000,000 lekë ose 100 %.

Në bazë të ndryshimeve që u bënë paralelisht në ligjin për sigurimet shoqërore dhe në atë të mbledhjes së kontributeve. Sipas ndryshimeve të kryera në korrik të vitit 2014, në ligjin “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, ndryshon mënyra e përlllogaritjes së kontributeve nga punëmarrësi. Paga maksimale mbi të cilën paguheshin kontributet deri në gusht të vitit 2014 ishte 95130 lekë. Paga maksimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore, nga data 1 gusht 2014 e në vazhdim, është 97 030 lekë.

Në bazë të Ligjit nr. 177/2013 për disa ndryshime në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar mënyra e llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale bëhet sipas tabelës së mëposhtme.

**Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi**

E Ardhura E Tatuueshme		Përqindje (%)
Nga	Deri në	
0	30 000	0 %
30 001	130 000	+ 13 % të shumës mbi 30 000 lekë
130 001	Më tepër	13 000 lekë + 23 % të shumës mbi 130 000 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

**Administrimi i dosjeve të personelit:**

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 5.3.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit". Kreu I, Pika 3, përcaktohet: "Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, si dhe të dhëna të tjera, sipas lidhjeve 1 e 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse të tij".

Ku në lidhjen 1 të VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", dhe lidhjen 2 përcaktohet dokumentacioni që duhet të përfshihet në dosjen teknike, si dhe të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të Nëpunësit.

Nga auditimi rastësor dhe me zgjedhje që u bë në Sektorin e Burimeve Njerëzore për plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të nëpunësve civilë të institucionit, nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e dokumenteve personale.

- Në dosjet e audituara janë të vendosura: Kualifikimet universitare dhe pasuniversitare, fletë inventari i dosjes së nëpunësit, shkresa e emërimit në detyrë, përshkrimet e punës.

- Në dosjet e personelit janë gjithashtu CV personale, fotokopje kartës së identitetit, certifikatë familjare ose personale, dëshmi e gjendjes gjyqësore, vërtetim nga prokuroria, raporti mjeko - ligjor, të cilat u konstatuan se mbaheshin të gjitha.

Disa punonjës të institucionit të KQZ-së kishin filluar të trajnohen nga DAP-i (*Departamenti i Administratës Publike*) për të realizuar procesin dixhitalizimit dhe hedhjes në mënyrë elektronike të dokumentacionit të dosjeve të punonjësve të administratës së KQZ-së.

*Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Aktverifikimi nr. 2, datë 15.03.2016 për të cilën nga personat me të cilën është mbajtur janë paraqitur vërejtje me shkresën me nr. 226/8 prot. datë 25.03.2016. Këto observacione nuk merren parasysh pasi të ardhurat nga raportet mjekësore deri në 14 ditë konsiderohen si të ardhura nga paga e që paguhen nga institucioni dhe jo nga skema e sigurimeve shendetësore e shoqërore sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, pika 2.4 nënpika 1.*

*Gjithashtu nuk qëndron dhe observimi në lidhje me faktin e konstatuar nga auditimi që listëpagesat duhet të nënshkruhen dhe nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore, sipas udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 69 "Listëpagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listeprezenca e firmosur nga menaxheri i struktures perkatëse) për shërbimin e kryer. **Ato kontrollohen dhe nënshkruhen** nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.*

*Të njëjtat observime, në përmbajtje, janë paraqitur dhe me shkresën nr.226/12 prot. datë 17.05.2016 të KQZ, në lidhje me Projektraportin e Auditimit të cilat gjithashtu nuk merren parasysh me arsyetimet e mësipërme. Ndërsa në takimin përmbjllës të zhvilluar më datë 01.06.2016 në ambientet e KLSH me përfaqësuesit e KQZ u pretendua (përmbledhtas)se një nënshkrim i tyre bëhej nga KQZ. Kjo nënkupton se rekomandimi ynë në këtë rast është i pranuar nga KQZ.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

**IV. Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.**

***-Ligjshmëria dhe saktësia e pagesave të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe në valutë, për periudhën objekt auditimi.***

Auditimi i dokumentacionit të arkës në lekë dhe valutë, u krye i plotë sipas përcaktimeve të bëra në programin e kontrollit, në përfundim u konstatua se, veprimet janë kryer dhe regjistruar në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar dhe të VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore, si dhe njësisve që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, i ndryshuar. "Për blerjet më vlera të vogla" për vitin 2014 dhe 2015 është vepruar konform ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 të Agjencisë të Prokurimit Publik.

***Mbi veprimtarinë e bankës.***

Nga auditimi i kryer u konstatua se, veprimet nëpërmjet bankës janë kryer konform planit unik kontabël, regjistrimet e veprimeve janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike, gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraket e bankës në fund të çdo muaji. Blerjet me vlera të vogla nëpërmjet veprimeve të bankës janë kryer konform ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" me ndryshimet dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" me ndryshimet.

Auditimi për pagesat nëpërmjet veprimeve të bankës u krye me zgjedhje sipas përcaktimeve në programin e punës. Kontabilizimi i vlerave materiale të blera me këto procedura, është kryer konform ligjit për kontabilitetin dhe planit kontabël.

Nga auditimi i veprimeve dhe pagesave të kryera nëpërmjet bankës u konstatua:

-Në mbështetje të memorandumit të bashkëpunimit midis KQZ dhe USAID nr. 518, datë 15.04.2014 është nënshkruar marrëveshja midis palëve për të financuar projektin për përshatjen e zgjedhjeve vendore me modulet e zgjedhjeve parlamentare të realizuara nga kompania " ". Objekti i këtij bashkëpunimi është: "Të përshkruajë rolet, rezultatet dhe përgjegjësitë që lidhen me zbatimin e softëareve-it në programin AlbERT, përditësimin të administrimit të zgjedhjeve lokale për KQZ të planifikuara gjatë periudhës Prill-Shtator 2014".

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit nr. AID-A-12-00001, USAID, ka përcaktuar këto përgjegjësi:

1. Marrjen në punë shoqërisë " ", me objekt:

- a. Ndërtimin në gjuhën angleze të një softwari lokal për administrimin e zgjedhjeve sipas kërkesave teknike të KQZ-së;
- b. Të punojnë me KQZ për të integruar dhe testuar modulën duke përfshirë edhe realizimin e një testi provë;
- c. Të hartojë dokumentacionin teknik dhe materialet bazë të trajnimit në modul duke përfshirë një kurs on-line të cilin KQZ mund t'a përdorë për të trajnuar të tjerët;
- d. Të sigurojë një raport përfundimtar i cili do të përfshijë një përshkrim të hollësishëm të sistemit, integrimin me sistemin e ngritur dhe atë ekzistues, arkitekturën, veprimtarinë, kodet hyrëse dhe detyrat e rekomanduara për t'u zhvilluar nga KQZ-ja në përditësimet e ardhshme.

2. Monitorimin e zbatimit të aktivitetit dhe efektshmëria e software-it.

3. Mundësimin e koordinimit me USAID-in.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Në lidhje me këtë bashkëpunim, shoqëria “ ” paraqet ofertën në datën 26.02.2015 me vlerë 60,000 Euro. Për këtë KQZ ka kërkuar negociim për uljen e vlerës dhe më pas shoqëria “ ” paraqet ofertën e ndryshuar duke theksuar se bordi i kompanisë “ ” duke marrë parasysh marrëdhëniet afatgjata me KQZ, ka bërë uljen përfundimtare në ofertën e datës 27.04.2015 me vlerë 37,514 euro, me zërat e shërbimit të mëposhtëm:

Kompania “ ” do të ofrojë konsulentët që zhvilluan dhe implementuan sistemin ALBERT për zgjedhjet e vitit 2015 dhe suport teknik për të gjithë periudhën zgjedhore për Zgjedhjet Vendore 2015 duke mbuluar veprimtaritë e mëposhtme:

1. Suport teknik 24 orë për një periudhë 3- javore, duke filluar 1- javë përpara zgjedhjeve, përfshirë,

2. Suport për gjenerimin e raporteve shtesë,

3. Suport për zgjidhjen e problemeve që lindin gjatë implementimit të moduleve të reja

Në zbatim të memorandumit me USAID, dhe ofertës së negociuar sekretari i Përgjithshëm z. me urdhrin e prokurimit nr.66, datë 18.05.2015, ka urdhëruar lidhjen e kontratës së shërbimit me shoqërinë “ ” Maqedoni me objekt: Shërbim për mbështetje teknike për procesin e nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve të datës 21.06.2015 me vlerë 37,514 Euro. Nga verifikimi i kryer në aneksin e kontratës nuk u gjenden të dhëna teknike për hartimin e këtij programi sikurse është përcaktuar në memorandumun e bashkëpunimit me USAID nr. AID-A-12-0000,1 për ndërtimin e software-ve lokale për administrimin e zgjedhjeve sipas kërkesave teknike të KQZ-së;

Për shërbimin e kryer shoqëria është likuiduar fillimisht me urdhër shpenzimin nr. **231, datë 10.06.2015** në vlerën prej 11,254 euro konvertuar në shumën prej 1,589,065 lekë, bashkëlidhur fatura e printuar në format model A4 me nr. 15-361-000004 me vlerë 11,254 euro dhe me urdhër shpenzimin nr. **344, datë 21.07.2015** në vlerën prej 26,260 euro konvertuar në shumën 3,671,148 lekë, bashkëlidhur fatura nr. 15-361-000009 me vlerë 26,260 Euro, konvertuar në vlerën totale prej 5,260,213 lekë.

Nga auditimi konstatohet se në dokumentacionin bashkëlidhur urdhër shpenzimeve për likuidimin e vlerës së kontraktuar, Shoqëria ka paraqitur raporte për ecuerinë e projektit sipas fazave të përcaktuara në nenin 6 të kontratës së lidhur midis palëve.

Nga auditimi për kryerjen e këtij projekti u konstatua se; në përfundim të shërbimit për likuidimin përfundimtar, nuk është llogaritur dhe ndalur tatimi në burim në masën 15 % mbi të ardhurat e realizuara në shumën prej **789,031 lekë** si subjekt i pa regjistruar në QKR për kohën që do ushtrojë këtë veprimtari dhe për sa kohë që nga ana e KQZ-së nuk janë plotësuar praktikatat për përfitimin e përjashtimit bazuar në Marrëveshjen e eliminimit të taksimit të dyfishtë midis Shqipërisë dhe Maqedonisë. Faturat e paraqitura nga shoqëria e kontraktuar janë të printuara në format tip A4, pa asnjë të dhënë që të provojë miratimin nga shteti Maqedonas, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 4, germa “h”, ku përcaktohet se: “*të ardhurat e realizuara nga shërbimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një person jorezident*”, dhe neni 33, pika 4, ku përcaktohet se: “*Një tatimpagues jorezident, i cili përfiton të ardhura si ato të përmendura në shkronjat “d”, “dh” ose “e” të paragrafit të parë të këtij neni, mund të tatohen njëllor si në rastin kur këto të ardhura të ishin përfituar në ndjekjen e një veprimtarie të ndërmarrë prej tij nëpërmjet një njësie të përhershme në Republikën e Shqipërisë*” dhe me udhëzimin e ministrit të financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar” me ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014, neni 9, “Tarifat tatimore”, pika 2.4 “Të ardhura të tatueshme” ku është përcaktuar se, të ardhurat e tjera që nuk përfshihen ndryshe në dispozitat të tjera të këtij ligji tatohen në masën 15 %.





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Në lidhje me këtë konstatim nga ana e KQZ në observimet e bëra me shkresën nr. 226/12 datë 17.05.2016 mbi Projektraportin e Auditimit është pranuar duke cituar si më poshtë:

*“Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, do të marrë të gjitha masat për verifikimin e situatës dhe mbledhjen e tatimit kompanisë Maqedonase ‘ ‘ , në masën 15 % mbi të ardhurat e realizuara në shumën prej 789,031 lekë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”.*

-Nga auditimi për shpenzimet e kryera nëpërmjet veprimeve të bankës për periudhën objekt auditimi prej datë 01.01.2014 deri në datën 31.12.2015 2014 dhe 2015, u konstatua se, ka përfituar bonus për shpenzime transporti gjithsej në vlerën prej 495,000 lekë, pagesë e cila nuk është bashkuar me pagën mujore, por është xhiruar në llogarinë bankare pa u llogaritur dhe ndalur tatimi në burim në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, neni 9, “Tarifat tatimore” ku është përcaktuar se:

*“Pagat dhe shpërblimet, në lidhje me marrëdhëniet e punës aktuale, do të taten sipas tarifave të përshkruara në pasqyrën nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji, dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimi mbi të ardhurat personale, përfshin të gjitha llojet e të ardhurave të individëve, të parashikuara në këtë ligj, neni 7 “Shtrirja e detyrimit” Pika 2.2, 2.3. “Të Ardhurat e Tatueshme” dhe në zbatim, nenit 8, për qëllim tatimi mbi të ardhurat personale, janë kategoritë e të ardhurave të mëposhtme: Pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës (të ardhurat nga punësimi). Në këtë kategori të ardhurash përfshihen si pagat, ashtu edhe shpërblime të tjera në vlerë që lidhen me punësimin aktual të individit. Në të ardhura nga pagat përfshihet paga bazë si dhe të gjitha shtesat mbi pagën bazë që kanë karakter të përhershëm si shtesat për vjetërsi, vështirësi, largësi vendbanimi, natyrë të veçantë pune apo shërbimi, si dhe shtesa të tjera page e shpërblimi të bëra me akte të tjera ligjore e nënligjore. Termi “shpërblime të tjera” përfshin të gjitha të ardhurat apo shpërblimet që përfitohen nga rezultatet e punës në vendin e punësimit aktual të individit, apo pagesa të ndryshme të kësaj natyre.*

Si rrjedhojë e mos respektimit të dispozitave ligjore për tatimin mbi të ardhurat bonusi për karburant nuk është bashkuar me pagën mujore e për rrjedhojë nuk është llogaritur dhe ndalur tatimi në burim në masën 23% mbi këto të ardhura, duke sjellë si pasojë mos llogaritjen e tatimit në vlerën prej **109,150 lekë**.

*Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit është mbajtur Procesverbali nr. 1, datë 15.03.2016 për të cilën në lidhje me mos mbajtjen e tatimit në burim mbi të ardhurat nga bonusi janë paraqitur objeksione me shkresën nr. 226/8 prot. datë 25.03.2016. Ky objeksion nuk merret parasysh pasi nuk është i mbështetur ligjërisht.*

*Gjithashtu objeksione janë paraqitur dhe në lidhje me Projektraportin e Auditimit sipas shkresës së KQZ nr.226/12 datë 17.05.2016 si më poshtë:*

*“Bonusi, përfitimi financiar, që përfiton në zbatim të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civil”, i ndryshuar, nuk duhet konsideruar si një e ardhur që buron nga puna e funksionarit, por si një kompensim për shpenzimet e transportit të kryer nga funksionari, e parë kjo edhe në mungesën e shprehur të ndonjë ligji specifik apo akti nënligjor i nxjerrë në zbatim të ligjit.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Mbështetur në pikën 2, të ligjit të sipërcituar, por referuar frymës dhe përmbajtjes së plotë të ligjit, ky përfitim financiar jepet për çdo funksion të parashikuar në këtë ligj për të mbuluar shpenzimet e transportit që aktualisht nuk i mbulon institucioni.

Në këtë kuptim, ky përfitim financiar mund të jetë në çdo rast më i madh ose më i vogël se shpenzimi i kryer nga funksionari, por në asnjë rast ky përfitim nuk përfaqëson një të ardhur për një punë të kryer, sikurse parashikon ligji nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Lind pyetja, nëse bonusi do të jepej karburant dhe aktualisht për këtë zë jepet si do të tatohej? Njëherazi mendojmë se, rasti konkret duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë siç trajtohen pagesa për udhëtime dhe dieta kur punonjësi dërgohet me shërbim jashtë vendit të punës.

Sa më sipër, ky përfitim financiar, nuk ka natyrën e shpërblimit apo të pagës së funksionarit, por është një kompensim i shpenzimeve të kryera nga funksionari në funksion të përmbushjes së detyrës.

Projektraporti ka gabim klasifikimin e parimit për transportin. Materiali e klasifikon si të "ardhur" një shumë që është "shpenzim".

Më tej, duke konsideruar që ky format **Ligjor** (i referimit të kësaj kategorie shpenzimesh për një listë të gjatë funksionesh), është e pamundur të jetë ndeshur për herë të parë nga KLSH-ja, në rastin e Kryetares së KQZ-së, për të qenë e qartë kërkojmë vënien në dispozicion të trajtimit të bërë për këtë çështje dhe në rastet e tjera të auditimeve nga KLSH-ja.

**Këtyre pretendimeve u qëndroj dhe grupi përfaqësuesve të KOZ në takimin përmblylës të organizuar në ambientet e KLSH**

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga z. [ ] sqarojmë se: Krahasimi që bëhet midis bonusit në vlerë të përfutur në cilësinë e Kryetares së KQZ-s dhe furnizimit me karburant nga institucioni, i konsiderojm dy variante të ndryshme. Dallimi midis tyre është se, në kushtet që do zgjidhej furnizimi me karburant nga institucioni, lëvizjet e mjetit duhet të justifikohen me fletë udhëtimi nga përdoruesi për çdo lëvizje zyrtare. Përderisa në mënyrë të përfaqësuesve të ardhura nga ushtrimi i funksionit zyrtar dhe në këto kushte do i nënshtrohet detyrimeve tatimore (tatimit në burim).

Gjithashtu në lidhje me observimin e KQZ, sipas këtij paragrafi të cituar: "Mirëpres që, të vihem në dijeni për përlogaritjet e dëmit edhe në raste të tjera, përpara se ta klasifikoj abuziv, tendencioz dhe ekstremisht joprofesional grupin e kontrollit, për trajtimin e çështjes në fjalë".

Sqarojmë: Nuk arrimë të kuptojmë gjuhën e përdorur në këtë paragraf. Megjithatë raste të ngjashme të qëndrimit të KLSH mund të gjenden në faqen zyrtare të KLSH.

Në zbatim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimeve të KQZ, janë përcaktuar objektivat me qëllim sensibilizimin, ndërgjegjësimin dhe njohuritë për procesin zgjedhor dhe për një pjesëmarrje sa me të gjerë të votuesve në procesin zgjedhor, duke nënshkruar kontrata me mediat e shkruara, elektronike dhe audio.

Nga auditimi u konstatua se, lidhja e kontratave, për qëllimin e mësipërm, me subjektet e RTV, është bërë konform me VKM nr. 1195, datë 05.08.2008 "Për blerjen zhvillimin, prodhimin bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohën e transmetimit, nga organet e administratës shtetërore".



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Nga auditimi i kryer për zbatimin e procedurave ligjore për marrjen e masave për sensibilizimin e popullsisë si zgjedhës në votimet e pushtetit vendor 2015, u kosntata se, KQZ ka lidhur një kontratë me shoqërinë " " për prodhimin e 4 spote televizivë dhe 2 spote radiofonikë" në vlerën prej 1,280,000 lekë pa tvsh.

Për realizimin e kësaj kontrate shoqëria sipërmarrëse është likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 339, datë 23.07.2015, në vlerën prej 1,280,000 lekë pa tvsh.

Nga verifikimi i kryer në ditarin e bankës u konstatua se veprimi kontabël është kryer në llogarinë 602 "shpenzime të ushtrimit", pa u bërë hyrje në magazinë, me qëllim evidentimin e tyre në llogarinë aktive të KQZ dhe pjesë e historikut të zgjedhjeve në Shqipëri.

Për transmetimin e spoteve publike me qëllim sensibilizimin e opinonit publik, janë lidhur 6 kontrata me televizionet publike dhe private me tarifat respektive në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi i subjektit	Vlera e kontraktuar	Spote të transmetuara		Sekonda për një spot	
			Nr.	Çmimi/spot	Nr.	Çmimi/sek
1	TV ABC NEWS	700,000	40	17,500	2,536	276
2	TV TOP Channel	1,100,000	27	40,740	1,761	624.6
3	TV RTSH	1,000,000	162	6,173	3,589	278
4	TV Klan	700,000	20	35,000	1,035	676.3
5	MEDIA VIZION	500,000	25	20,000	1,619	308.8
6	TV BALLKAN	700,000	119	5,882	3,570	196
	Totali	4,700,000				

Nga tabela e mësipërme, konstatohet se tarifat për njësinë e kohës me Televizionet kombëtare janë të ndryshme duke filluar me RTSH me tarifën 6,173 lekë/spoti, dhe me televizionet private me TV Klan 35,000 lekë/spoti dhe TV Top Channel 40,740 lekë/spoti. Likuidimi i spoteve të trasmetuara nga televizionet me tarifa të diferencuara, midis televizioneve kombëtarë dhe jo kombëtarë tregon, tregon se KQZ, para lidhjes së kontratave nuk ka marrë informacione nga AMA, me qëllim që tarifat për transmetimin e tyre të diferencohen në bazë të % të shikueshmërisë që kanë këto televizione.

***Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave.***

Inventarët e aktiveve për vitin 2014 janë kryer me urdhrin e titullarit nr. 4, datë 14.01.2015, me Kryetare , dhe dy anëtarët . Inventarë janë kryer për aktivet e trupëzuara dhe të patrupëzuara, respektivisht, aktivet në ngarkim të çdo punonjësi, aktivet gjendje në magazinë si për objektet e inventarit ashtu edhe për materialet e konsumit

Komisioni i inventarizimit krahas evidentimit të vlerave fizike në inventar ka pasqyruar edhe materialet që janë në gjendje pune dhe ato që kanë humbur vetitë fizike dhe janë jashtë përdorimit. Nga verifikimi i kryer në veprimet e magazinës u konstatua se regjistrimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve është bërë konform planit kontabël dhe në llogaritë përkatëse të tyre. Llogaritë sintetike sipas bilancit kontabël janë të rakorduara me llogaritë analitike të ditarit dhe partitarit të magazinës. Nga verifikimi i kryer në inventarin përfundimtar të magazinës u konstatua se gjendja fizike e të gjithë aktiveve dhe e materialeve është e barabartë me gjendjen kontabile, pra nuk janë konstatuar diferenca.

Nga verifikimi i kryer në inventarin fizik për gjendjen fizike të aktiveve dhe të objekteve inventar konstatohet se, në magazinë gjenden sasira të konsiderueshme të mallra, materiale dhe objekte inventari të destinuara vetëm për veprimtaritë zgjedhore (parlamentare dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

vendore) që kanë si origjinë blerjet dhe furnizimet e kryera ndër vite, të cilat kanë jo vetëm kosto të lartë por dhe vlerë përdorimi. Sipas të dhënave që disponon KQZ, këto objekte inventari dhe materiale zgjedhore nuk gjejnë përdorim pasi partitë për çdo zgjedhje vendore apo parlamentare bëjnë ndryshime të shpeshta të kodit zgjedhor duke nxjerrë jashtë funksioni infrastrukturën zgjedhore me pasojë rritjen e gjendjes stok në magazinë.

Sipas inventarit fizik të kryer në magazinë në muajin janar 2015, KQZ disponon materiale dhe objekte zgjedhore në sasira të konsiderueshme të cilat sipas kontabilitetit llogariten në vlerën prej 208,529,995 lekë, respektivisht; 36,640 copë kuti votimi të dimensioneve, formave dhe ngjyrave të ndryshme në vlerën prej 166,576,691 lekë dhe 188,692 copë kode dhe vula sigurie në vlerën prej 41,953,304 lekë

Sipas të dhënave që disponon KQZ për zgjedhjet e përgjithshme të Kuvendit nevojiten mesatarisht 8,000 kuti votimi pra rreth 25 % e gjendjes së tyre, ndërsa për zgjedhjet e pushtetit vendor nevojiten mesatarisht rreth 12,000 copë kuti votimi ose rreth 30 % e kutive që janë gjendje në magazinën e KQZ-së.

Rritja e gjendjes stok të materialeve dhe objekteve zgjedhore ka ardhur duke u rritur nga një zgjedhje në zgjedhjen tjetër pasardhëse për faktin se, kërkesat e partive dhe ndryshimet e shpeshta të kodit zgjedhor, si dhe specifikimet teknike që shtohen në çdo zgjedhje vendore apo parlamentare, kanë sjellë si pasojë rritjen e stokut në magazinë dhe përdorimin pa efektivitet të fondeve publike.

Kështu nga verifikimet e kryera në fletët e inventarit të kryer me urdhrin e titullarit nr. 4, datë 14.01.2015 konstatohen sasira të konsiderueshme materialesh zgjedhore të krijuara qysh nga viti 2001, të cilat ndonëse kanë vlerë përdorimi janë stok, mids tyre përmendim 30,744 copë kuti votimi në vlerën prej 141,298 mijë lekë. Nga këto janë në përdorim vetëm 10,290 copë në vlerën 39,287 mijë lekë.

Po kështu sipas të dhënave të inventarit fizik u konstatuan se edhe disa materiale zgjedhore të tjera si vula dhe kodet zgjedhore që shërbejnë për kutitë e votimit janë gjendje në magazinë në një sasi teper të lartë.

Kështu prej vitesh janë krijuar gjendje tepër e lartë e kodeve të sigurisë në sasinë prej 178,147 copë në vlerën prej 28,651 mijë lekë, vula të KQV-së në sasinë prej 10,545 copë në vlerën 12,653 mijë lekë dhe llampa verifikimi për zgjedhësit 5,850 copë në vlerën prej 2,646 mijë lekë.

Në fund të viti 2015 është bërë inventari kontabël i të gjitha aktiveve dhe rezulton i barabartë me aktivin e bilancit kontabël për vlerat inventariale dhe materialet e konsumit në shumën totale prej 34,192,235 lekë

#### **V. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit**

**Nga auditimi i kryer mbi mbajtjen e kontabilitetit rezultoi se:** është mbajtur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006, ndryshuar me ligjin nr. 10110, datë 02.04.2009, VKM nr.248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore dhe qendrore si dhe njërive që varen prej tyre", i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr .248, datë 10.04.1998".

Dokumentat justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, ishin plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Veprimet kontabile në këtë institucion janë kontabilizuar në ditarët e "Arkës në lekë", në ditarin e "Veprimeve me bankën", në ditarët e "Hyrjeve dhe daljeve të magazinës", ditarin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

“Pagave”, në ditarin e shpenzimeve dhe në ditarin e “Veprimeve të ndryshme”. Të gjitha sistemimet dhe mbylljet e llogarive të rregjistruara, ishin kryer konform dispozitave ligjore në fuqi.

Për vitin 2014, bilanci i KQZ-së është përpiluar dhe është dërguar në Degën e thesarrit dhe Ministrinë e Financave me shkresën nr. 814, datë 24.02.2015. Bilanci është shoqëruar me relacionin përkatës, me pyetësonin dhe situacionin përfundimtar të shpenzimeve dhe të ardhurave dhe me analiza të debi kredive.

Për periudhën objekt kontrolli, Sektori i Financës ka bërë ndjekjen, sistemimin dhe kuadrimin e llogarive debitore e kreditore duke çelur partitarët përkatës dhe kartelat personale për gjithë debitorët e kreditorët e institucionit. Nga verifikimi i llogarive debitore nuk kishte pozicione apo kontabilizime të parregullta.

Nga auditimi i llogarive debitore dhe kreditore rezultoi se, evidentimi dhe dokumentimi i tyre janë të rregullta. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike. Në fund të periudhës ushtrimore të vitit 2014, kreditorët janë evidentuar dhe rakorduar në partitarin analitik të kreditorëve me llogaritë sintetike të bilancit kontabël dhe pas verifikimit rezultuan të kuadruara me partitarët përkatës.

Mbyllja e llogarivë në fund të vitit 2014 është kryer konform udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 18.12.2014 “Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit të vitit 2014”

**Nga auditimi i kryer për gjendjen dhe dinamikën e debitorëve u konstatua se:** në fund të vitit 2014, krahasuar me periudhat e mëparshme e konkretisht me vitin 2013, **gjendja e debitorëve**, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Llogaria	Emertimi i llogarisë	Viti 2013	Viti 2014	Ndryshimi
423-429	Personeli-paradhenie, deficite e gjoba	24,593,305	24,271,863	- 321,442

Nga auditimi rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është bërë konform planit kontabël dhe dispozitave ligjore. Debitorët janë evidentuar në partitar dhe llogaria sintetike e bilancit kontabël paraqitet e rekorduar me ato analitike për të gjithë periudhën objekt kontrolli, si dhe nuk u konstatuan pozicione apo kontabilizime të parregullta.

Duhet theksuar se, llogaritë debitore paraqiten tepër të larta, për faktin se në fund të vitit 2014 llogaritë debitore janë në vlerën 24,271,863 lekë, e cila përbëhet nga detyrime të mbartura nga vitet e mëparshme kryesisht pagesa të përfituara tepër dhe shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në procedurat e prokurimit të konstatuara dhe rekomanduar nga KLSH të cilat paraqiten pa shpresë arkëtimi.

Duke analizuar totalin e kësaj llogarie konstatohet se: pjesën më të madhe e zënë detyrimet që rrjedhin nga rekomandimet e KLSH, ndaj 90 personave, nga këto 49 % e tyre përbehen nga detyrime për pagë të llogaritur gabim në shumën prej 2.296.846 lekë, dhe të paarkëtuara deri në datën 31.12.2013. Ndërsa vlera prej 213.592 lekë, përfaqëson llogaritje të gabuara të tatimit mbi pagën, e cila është krijuar prej vitit 2001 e në vazhdim.

Këto detyrime paraqiten pa shpresë arkëtimi, pasi u përkasin punonjësve të përkohshëm të viteve të mëparshme, ndërsa shuma prej 953.850 lekë përfaqëson rekomandime të KLSH nga viti 2001, e në vazhdim. Shuma prej 144.213 lekë, përfaqëson paradhënie të pakthyera të viteve të mëparshme, si edhe vlera prej 275.626 lekë, përbëhet nga 6 persona debitorë për



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

shpenzime telefonike mbi limitin e përcaktuar në dispozita ligjore. Pra edhe këto detyrime paraqiten pa shpresë arkëtimi, pasi aktualisht këta punonjës janë të larguar.

**Llogaria 429 "Deficite dhe gjoba"**, më datën 31.12.2014 sipas tabelës bashkëlidhur, paraqet detyrimet për 19 persona në vlerën prej 20.616.651 lekë, të cilat kanë burim krijimi rekomandimet të KLSH për dëme ekonomike të konstatuara në vitin 2006, nga këto, 17 persona në vlerën prej 20.460.195 lekë përfaqësojnë 99 % të vlerës totale të detyrimit. Kjo vlerë nuk ka ndryshim as për vitin 2014. KQZ, për këta persona ka bërë njoftime për arkëtim detyrimi me shkresën nr.1623, datë 04.12.2006, por deri më sot nuk është arkëtuar asnjë prej këtyre detyrimeve.

Nga ana e KQZ u paraqit pranë KLSH më datë 01.06.2016, Ankimi drejtuar Gjykatës së Apekit Tiranë në lidhje me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të dhënë në favor të të paditurit (KQZ si paditës)z. ( i cili është një nga rastet e debitorëve me vlerë prej rreth 3.5 milion lekë). Kjo tregon përveç faktit të interesimit të KQZ për mundësinë e arkëtimit të këtyre detyrimeve por njëkohësisht tregon se ndodhemi përpara rasteve pa shpresë arkëtimi duke pasur gjithmonë parasysh dhe kohën e gjatë të kaluar.

**Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"**, në datën 31.12.2014 sipas tabelës bashkëlidhur, rezulton në vlerën prej 9.340.367 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për 15 subjekte private dhe 8 punonjës. Kjo vlerë krahasuar me fundin e vitit 2009 është rritur për më tepër prej 398.427 lekë, pasi në Raportin Përfundimtar pararendës nga KLSH, janë konstatuar dhe rekomanduar për zhdëmtim 4 subjekte private të cilat janë kontabilizuar në llogarinë "debitorë të tjerë".

Nga auditimi i llogarive kreditore rezultoi se, evidentimi dhe dokumentimi i tyre është bërë në rregull. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike. Në fund të periudhave ushtrimore kreditorët janë evidentuar dhe rakorduar në partitarin analitik të kreditorëve me llogarinë sintetike të bilancit kontabël dhe pas verifikimit rezultuan të kuadruara me partitarët përkatës.

Nga auditimi i ushtruar në përlllogaritjen dhe shpërndarjen e fondeve për subjektet politike të regjistruar në fushata të ndryshme zgjedhore dhe rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë për periudhat e mëparshme dhe ato zgjedhore të vitin 2009, u konstatua se janë debitorë, 8 subjekte zgjedhore, nga të cilat, në llogarinë debitorë të tjerë të KQZ janë pasqyruar partitë Politike që figurojnë debitorë në zgjedhjet e vitit 2003 në shumën prej 1,621,920 lekë dhe vlera prej 12,728,006 lekë përfaqësojnë detyrimet në zgjedhjet e vitit 2009 pranë Ministrisë së Financave, 5 parti politike, sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Partitë Politike	Viti i krijimit	Detyrime për t'u kthyer nga subjektet që nuk kanë kaluar pragun sipas kodit zgjedhor
1	Partia Socialiste	2003	305.855
2	Partia Demokratike	2003	1.143.450
3	Partia Social Demokrate	2003	172.615
4	Partia Social Demokrate	2009	5.136.667
5	Partia Agrare Ambientaliste	2009	2.644.556
6	Partia Aleanca Demokratike	2009	1.920.479
7	Partia Demokracia Sociale	2009	1.711.151
8	Partia Demokristiane	2009	1.315.153
	<b>Totali</b>		<b>14. 349.926</b>



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

Nga tabela e misipërme rezulton se 8 subjekte politike ndonëse figurojnë debitorë në periudhat e maprashme, nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e tyre sipas "Kodit Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**VI. Auditimi mbi zbatimin e procedurave të prokurimit:**

**VI.1. Auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës viti 2014 dhe 2015.**

**Nga auditimi rezultoi se nga Autoriteti Kontraktor Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë Zhvilluar procedura prokurimi si më poshtë:**

**Për llogari të vitit 2014** nga Autoriteti Kontraktor Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Tiranë është zhvilluar një procedurë prokurimi e formës: "Tender i Hapur" me objekt: "Shërbimi për ruajtjen e magazinave Lundër me roje private" me fond limit në total prej rreth: 1,578 mijë lekë. Kjo procedurë është filluar me Urdhërin e Prokurimit nr. 7 datë 20.01.2014. Kjo procedurë prokurimi është zhvilluar për dy vend roje. Data e hapjes së tenderit është 30.01.2014 ku ka rezultuar që kanë paraqitur ofertë 17 kompani nga të cilat dy kompani (ofertues) nuk kanë hedhur dokumentacion në sistem e për këtë arsye janë skualifikuar. Në vend të parë është kualifikuar ofertuesi me ofertën më të ulët të paraqitur " " sh.a me ofertën prej 1,287,115 lekë pa tvsh. Në lidhje me këtë procedur janë paraqitur ankime nga tre ofertues të cilat pas shqyrtimit të komisionit të ngritur për këtë qëllim nuk janë marrë parasysh, kjo me Vendimin nr.213 prot datë 17.02.2014. Nga ofertuesit ka vazhduar procedura me ankim të mëtejshëm në KPP e cila me Vendimin nr. 41/2014 ka vendosur mos pranimin e ankesës. Ka vazhduar ankimimi në gjykatën Administrative e cila ka lënë në fuqi vendimin e KPP. Në këto kushte është lidhur kontrata me ofertuesin e klasifikuar në vendin e parë " " sh.a me nr. 76/5 datë 11.03.2014 me vlerë prej 1,287,115 lekë pa tvsh për periudhën 11.03.2014 deri më 11.03.2015 me të cilin është lidhur dhe një kontratë shtesë me nr. 1443/1 datë 12.02.2015 me vlerë 107,259 lekë pa tvsh për një periudhë një mujore.

**Për llogari të vitit 2015** nga Autoriteti Kontraktor Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Tiranë janë zhvilluar procedura prokurimi me buxhetin e institucionit për veprimatrinë e tij administrative si dhe procedura prokurimi nga buxheti i shtetit për llogari të zgjedhjeve vendore.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (KQZ) me shkresën nr. 1600 prot datë 16.02.2015 të nëpunësit autorizues z. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i KQZ është dërguar në APP Regjistri i Parashikimit të prokurimeve të vitit 2015 ku është parashikuar që për vitin 2015 të realizoheshin me buxhetin e KQZ për nevojat e saj tre prokurime të formës kërkesë për Propozim. Nga të cilat ka rezultuar se një prokurim e konkretisht ai i "Ndërtimit të rrjetit kompjuterik dhe qendrës së të dhënave me fond limit të parashikuar prej 1, 977,000 lekë nuk është realizuar.

Gjithashtu me shkresën nr. 1798 prot. Datë 23.02.2015 është dërguar në APP regjistri i parashikimeve të prokurimeve me Buxhetin e Zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Me shkresën nr. 205 prot datë 24.02.2016 është dërguar në APP Regjistri i realizimit të prokurimeve të realizuara nga autoriteti kontraktor për vitin 2015 nga ku rezulton se janë realizuar 4 prokurime të formës tender i hapur; 9 prokurime të formës Kërkesë për Propozim; 4 të formës Negocim pa shpallje paraprake; 3 shtesa kontrate; 1 Procedurë e formës konsulencë dhe 1 sipas VKM për realizimin e Spoteve. Nga këto fondi limit i parashikuar rezulton në rreth: 350,158 mije lekë pa tvsh. Nga procedurat e prokurimit kanë rezultuar me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

lidhjen e kontratave fondi në total prej rreth: 344,599 mijë lekë pa tvsh. Me një kursim prej rreth: 5,560 mijë lekë pa tvsh. Ose rreth 11.5 % më pak se fondi limit i parashikuar. Nga këto prokurime peshën e zënë prokurimi për "Rikonstruksionin dhe shtesë kati në ndërtesën e re të KQZ" me vlerë prej rreth 46,300 mijë lekë pa tvsh ku përfshihet dhe vlera e kontratës shtesë. Prokurimi për blerje vulash sigurie me vlerë kontrate prej rreth 22,802 mijë lekë pa tvsh. Procedura e prokurimit për shtypjen e fletëve të votimit me vlerë kontrate prej rreth 78,000 mijë lekë. Prokurimi për bojë timbruese me vlerë kontrate prej rreth: 12,400 mijë lekë. Prokurimi për Tabelat e rezultateve dhe manuale trajnimi me vlerë rreth 16,600 mijë lekë. Prokurimi për shërbimin e implementimin dhe menaxhimin e sistemit për regjistrimin, transmetimin online të procesit të numërimit të votave nga 89 "VNV" (Vend Numërimi Votash) me vlerë prej rreth 101,372 mijë lekë pa tvsh etj.

**Nga auditimi u konstatua se:** Në lidhje me aktivitetin e shtuar në drejtim të prokurimeve publike të realizuara nga ana e KQZ për llogari të vitit zgjedhor vihet re se: Mallrat dhe shërbimet e kërkuara në drejtim të specifikimeve teknike të tyre janë objekt i vendimarrjes politike të KQZ duke përfshirë këtu dhe eksperiencën e mëparshme për të njëjtat blerje mallrash, shërbime apo materiale zgjedhore. Në këto kushte është e natyrshme që në këto procedura të zhvilluara do të paraqiten gjithmonë e më pak konkures, minimalisht dy ose dhe vetëm një ofertues të cilët përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktor. Gjithashtu ajo që konstatohet është dhe fakti që megjithëse ka gjendje në magazinë kërkohen të blihen materiale shtesë për zgjedhjet si përshebull vulat e sigurisë. Këto vula kërkohen nga përfaqësuesit e partive politike thjesht me ngjyrë tjetër nga ato të përdorurat në zgjedhjet e mëparshme dhe një gjë e tillë vendoset me vendim të anëtarëve të KQZ. Një gjë e tillë nuk ka asnjë efekt rritës në sigurinë e integritetit të zgjedhjeve në drejtim të sigurimit të kutive të votimit por vetëm efekt psikologjik në kërkesat e partive të cilat shoqërohen me efekte ekonomike për taksapaguesit shqiptar. Kështu gjatë vitit 2015 është zhvilluar procedura e prokurimit për blerje "Kode sigurie" me të dhënat e mëposhtme:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumentave të tenderit
A	B	C
1. Urdhër Prokurimi nr 15 ,date 12.02.15	1. Kryetar	1. Jurist
2. Fondi limit 23,035,571 lekë	2. Anëtar	2. Specialist
3. Pr.Prok. T/Hapur	3. Anëtar	3. Specialist
4. Data e zhvillimit tenderit 07.03.15		
5. Firma fituese " Arbana "		
6. Data e lidhjes kontratës 23.03.15		
7. Vlera e kontratës 22,795,387 lekë.		
<b>8. Likuidimi 22,795,387 lekë pa tvsh.</b>		
9. Diferenca nga fondi limit 240,184 lekë		

Në lidhje me këtë prokurim është marrë Vendimi i KQZ nr.14, datë 27.01.2015 në të cilën megjithëse pranohet se ka gjendje në magazinë të KQZ Kode Sigurie (KS) dhe Kode Sigurie Rezervë ( KSR) theksohet se: *Megenëse partitë propozuan më datë 21.01.2015 këto kode të blihen në sasinë prej 175.000 copë dhe të jenë me ngjyrë të zezë ku përfshihen dhe ngjyrë qielli e hapur per kode sigurie rezervë në sasinë prej 16.500 copë.* Në datën e zhvillimit të këtij tenderi ka paraqitur ofertë vetëm një ofertues që është ai i një here më parë e konkretisht " (Hong Kong) me ofertën prej 183,750 \$ me kurs ditor 1\$=123,73 lekë pra





KONTROLLI I LARTË I SHQITIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

vlera ofertës me të cilën është lidhur në përfundim të procedurave të prokurimit dhe kontrata me nr. 1407/6 prot. datë 23.03.2015 është në vlerën prej 22,795,387 lekë pa tvsh.

Në lidhje me të gjithë këtë prokurim rezulton se janë bërë shpenzime të cilat sjellin efekte ekonomike negative në Buxhetin e Shtetit pikërisht për faktin se një sasi e këtyre kodeve por me ngjyrë tjetër gjenden në magazinat e KQZ. Kode këto të përdorura që nga viti 2009. Në magazinat e KQZ ndollen dhe Kode Sigurie të përdorura para vitit 2005 që janë të një prodhuesi tjetër ku konstatohet se kosto e tyre me ndryshimet nga plastikë në çelik ka ardhur duke u rritur me disa herë. Kështu një Kod Sigurie plastik që ndollet në magazinat e KQZ është e regjistruar me një vlerë të përafërt prej **10.6 lekë copa** ndërsa kodet e fundit prej çeliku kanë një vlerë prej **122.8 lekë copa**.

Kosto e shtuar me blerje të herë pas hershme përbën dhe blerja e "Dhomave të fshehta" dhe kutive të kartonit për materialet zgjedhore të cilat specifikohen nga KQZ me Vendim edhe në këtë procedurë prokurimi të zhvilluar më datë 27.02.2015 me fond limit prej: 7,512,167 lekë pa tvsh e formës Kërkesë për Propozim është paraqitur një ofertues " " sht. me ofertën prej 7,440,090 lekë pa tvsh i cili ka përmbushur specifikimet e këtyre materialeve të cilat janë miratuar me Vendimin e KQZ nr.19 datë 02.02.2015. Këto materiale do të duhej të ishin të përdorshme në disa votime dhe jo të konsumueshme vetëm për një palë zgjedhje.

Gjithashtu konstatohet se nga administrata e KQZ pothuaj të gjitha procedurat e prokurimeve të zhvilluara në lidhje me procesin e votimeve të vitit 2015 kanë për bazë të specifikimeve teknike të materialeve dhe shërbimeve të kërkuara miratimin e tyre me Vendim të KQZ. Kështu dhe specifikimet e fletëve të votimit janë miratuar sipas lidhjes nr.1 bashkalidhur Vedimit të KQZ nr.104 datë 09.04.2015 (i ndryshuar me Vendimin nr. 459 datë 19.05.2015) ku për ilustrim kërkohen që letra e votimit të ketë një sërë elementësh si: **të jetë me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, e ratifikuar në fazën përfundimtare, i certifikuar me certifikatë origjine, i vazhdueshëm me skicë speciale, me mikroprintime, element në printim që shikohet me rreze ultraviolet. Apo parashikohet dhe barkode.** Të gjitha këto element nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se rrisin në mënyrë të dukshme vlerën e tyre si dhe bëjnë që të mos ketë konkurim në këto procedura duke bërë që kjo sasi leku e taksapaguesve shqiptar të perfundojnë jashtë vendi. **Vendimi i KQZ nga ana tjetër është i bazuar në nenin 98 pika 1 e Kodit Zgjedhor** që parashikon që: *"Fletët e votimit për zgjedhje përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre me trashësi ose element konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesë të pasme të saj, si dhe të përmbajnë element sigurie, sipas përcaktimeve me akt normative të KQZ-së. Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimi si dhe element të tjerë që nuk lexohen me sy të lire....."*

Kjo procedurë prokurimi paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumentave të tenderit
A	B	C
1. Urdhër Prokurimi nr 56 ,date 20.04.15	1. Kryetar	1. Jurist
2. Fondi limit 75,549,989 lekë	2. Anëtar	2. Specialist
3. Pr.Prok. "Pr me negocim pa njoftim paraprak të kontratës"	3. Anëtar	3. Specialist
4. Data e zhvillimit tenderit 07.03.15		
5. Firma fituese " Cetus d.d (Slloveni) "		
6. Data e lidhjes kontratës 04.05.2015		
7. Vlera e kontratës 75,065,007 lekë pa		



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

tvsh . 8.Diferenca nga fondi limit 484,982 lekë 9 Shtesë kontrate: per ndryshim te specifikimeve te disa modeleve me nr. 2941/15 datë 22.05.2015 10.Vlera e shtesë kontratës: 4,865,854 lekë pa TVSH. 11. realizimi; plotësisht.		
--	--	--

**Procedura prokuruese me objekt: “Prodhim tabela të rezultateve me letër kimike, manual trainimi, libra protokollit dhe shtypshkrime të tjera për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2015”**

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumentave të tenderit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi nr.47, datë 27.03.2015 2. Fondi limit 23,925,000 lekë 3.Pr.Prok. “Procedurë e hapur, elektronik” Anulluar me Vendim të KPP nr.255/2015, është urdhëruar anulimi i kësaj procedure dhe modifikimi i dokumentave të tenderit <b>Rifilluar:</b> 1.Urdhër prokurimi: nr. 62, datë 03.05.2015 2.Fondi limit: 15,891,250 lekë 3.Pr. Prokuruese: “procedure me negociim pa njoftim te kontr. Fitues Argjiro Sh.p.k 15,657,500 leke pa tvsh 4.Lidhur kontratë me nr.3523/10 prot., datë 15.05.2015 5.Vlera e kontratës: 15,657,500 lekë pa TVSH 6. realizimi; plotësisht.	1. Kryetar 2. Anëtare 3. Anëtar	1. Jurist 2. Specialist 3. Specialist

Modelet e tabelave të rezultateve, janë miratuar me vendimin e KQZ-së, nr.82 datë 07.04.2015. Në këtë vendim janë miratuar edhe specifikimet përkatëse të llojit të letrës që do të përdoret për prodhimin e tabelave të rezultateve. Kjo bazuar në nenin 99 pika 2 shkronja “ç” të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet: *Detyrimi i KQZ-së për të dërguar në KZAZ, jo më vonë se tre ditë nga data e zgjedhjeve, kopje të mjaftueshme të Kodit Zgjedhor dhe të manualeve zgjedhore. Gjithashtu po në nenin 99 pika 4, parashikon se: KQZ-ja i dërgon KZAZ-së Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, Tabelat për Rezultatet e QV-ve nga Grupet e Numërimit, Tabelat për Rezultatet e Zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor, vulën e KZAZ-së, si dhe materiale të tjera të nevojshme për të, për administrimin e zgjedhjeve.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Nga auditimi konstatohet se nga ana e administratës së KQZ Njesisë së prokurimit dhe KVO nuk i ngelet shumë për të bërë në drejtim të realizimit të procedurave të prokurimit duke pasur parasysh këtu dhe afatin e shkurtër për realizimin e tyre dhe specifikimeve të para caktuara dhe miratuara me Vendim të KQZ. Si në rastin e këtij prokurimi ku vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik ka bërë që nga KQZ të përzgjidhet formë tjetër prokurimi për vetë afatin e shkurtër në dispozicion nga realizimi i zgjedhjeve të qershorit 2015.

*Në lidhje me këtë pikë u mbajt Aktverifikimi nr. 5 datë 24.03.2016 për të cilën u paraqitën objeksione nga z. [Emri i personit] në shkresën e datës 25.03.2016 të cilës i janë bashkalidhur dhe procesverbalet e mbledhjeve si për caktimin e ngjyrës së Kodeve të kutive të votimit apo dhomave të fshehta. Në këtë observim shtrohet fakti se KQZ si administratë ndodhet para faktit të vendimeve të KQZ sipas kërkesave të partive politike. Në këto kushte ky observacion në të vërtetë thotë të njëjtën gjë si dhe ajo e parashtruar në Aktverifikim. Po i njëjti qëndrim mbahet dhe në Observacionet e bëra në lidhje me Projektraportin e Auditimit sipas shkresës nr.226/12 datë 17.05.2016 të KOZ.*

**VI.2. Nga auditimi i dy Projekteve ( SEV dhe SEN) rezultoi:**

Me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 1131/3 datë 29.02.2016 “ Për një ndryshim në programin e auditimit nr.1131/1 datë 11.12.2015 në pikën 6 “Auditimi mbi prokurimin e fondeve publike” u shtua dhe auditimi për procedurat e prokurimit për projektet që i përkasin periudhës së vitit 2013 si më poshtë: “Sistemi elektronik për verifikimin dhe regjistrimin e zgjedhësve ( SEV)” dhe projekti “Sistemi elektronik i numërimit ( SEN)”

Në lidhje me konstatimet për këtë pikë auditimi nga grupi i auditimit u mbajt Procesverbali nr. 2 datë 25.03.2016 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me Kryetaren e KQZ-s znj. Lefterije Luzi, me Drejtuesin e Projektit [Emri i personit] detyrë ish Drejtor i projektit (SEV dhe SEN); znj. [Emri i personit] në cilësinë specialiste e Ministrisë së Brendshme në Projektin SEV dhe z. [Emri i personit] në cilësinë e nënshkruesit të kontratës SEV (me autorizim).

Nga ana e znj. [Emri i personit] dhe [Emri i personit] me shkresën nr. 226/10 datë 31.03.2016 u paraqitën observacione për të cilat nga ana e grupit të auditimit janë bërë dhe komentet në lidhje me ato pjesë në Projektraportin e Auditimit.

Projektraporti i Auditimit u dërgua në KQZ me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.1131/9, datë 18.04.2016.

Në lidhje me Projektraportin e Auditimit nga personat e atakuar u dërguan observime me shkresat nr. 226/12, datë 17.05.2016 (Protokolluar në KLSH me nr. 1131/11, datë 17.05.2016), observime këto të bëra nga: [Emri i personit] KQZ znj. Lefterije Luzi, [Emri i personit] Vriioni, Sekretar i Përgjithshëm i KQZ; znj. [Emri i personit] Drejtorisë së [Emri i personit]

[Emri i personit] ga, [Emri i personit] e Drejtorisë së financës të KQZ, [Emri i personit] Drejtor [Emri i personit] Burimeve Njerëz [Emri i personit] dhe [Emri i personit] [Emri i personit] të KQZ

Gjithashtu l. [Emri i personit] kësaj shkrese janë dhe observimet e bëra nga [Emri i personit] [Emri i personit] znj. F. [Emri i personit] [Emri i personit] ushta.

Observime janë bërë me shkresën e datës 17.05.2016 dhe nga [Emri i personit] [Emri i personit] protokolluar në KLSH me nr. 1131/12 datë 17.05.2016).

Observacione janë dërguar nga znj. [Emri i personit] me detyrë Drejtore e Sistemeve Informatike pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr.1921/3 datë 22.04.2016 ( e protokolluar në KLSH me nr. 1131/10 datë 25.04.2016).



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

Me personat e atakuar në Projektraportin e Auditimit u organizua një takim përmbyllës e ballafaques. Ky takim u zhvillua në datë 01.06.2016 ora 11.00 në ambientet e KLSH ku merrnin pjesë: z. [ ] Sekretar i Përgjithshëm i KQZ; z. [ ] Drejtor i Drejtorisë Juridike të KQZ; z. [ ] Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të KQZ; z. [ ] Jurist i Prokurimeve të KQZ, si dhe [ ] me detyrë ish supervisor i kontratave SEV dhe SEN. Në këtë takim për KLSH merrnin pjesë: Grupi i auditimit ( z. [ ] në mungesë), Drejtorja e Departamentit që ka ushtruar auditimin si dhe përfaqësuesja e Departamentit Juridik të KLSH.

Nisur nga pretendimet e titullares së KQZ znj. [ ] (si në objeksionet e bëra prej saj ndaj procesverbalit ashtu dhe të Projektraportit të Auditimit) se nuk është thirrur më parë për tu takuar nga grupi i auditimit por dhe nga pretendimet e ringritura për këtë çështje nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ (në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016, të organizuar në ambientet e KQZ) nga ana e KLSH nëpërmjet shkresës së Sekretares së Përgjithshme të KLSH me nr.1131/12 datë 03.06.2016 ju kërkua dhe ju shpreh gadishmëria znj. [ ] për takim, nëse ajo dëshironte, në KLSH deri në datën 08.06.2016. Kjo kërkesë me shkrim u bë pavarësisht se në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ u konsiderua e tepërt pasi ai merrte përsipër që këtë kërkesë dhe gadishmëri për takim të KLSH tia përcillte titullares së institucionit të KQZ.

**Deri më datë 08.06.2016 znj. Lëfterije Luzi nuk u paraqit në takim.**

Pas takimit përmbyllës nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ me shkresën nr. 226/13, datë 02.06.2016 (nr.1131/13, datë 03.06.2016 në KLSH) u dërguan dokumentacion shtesë për të mbështetur pretendimet e tyre.

**Këto materiale dokumentare kryesisht janë:**

**Vendimi i KQZ nr.589 datë 18.06.2013** "Për zbatimin e procedurave të identifikimit dhe regjistrimit të pjesmarrësve në zgjedhjet e datës 23.06.2013 në mënyrë manuale dhe mos aplikimin e teknologjisë elektronike për këtë qëllim SEV, në Qarkun e Tiranës".

**Vendimi i KQZ nr. 22, datë 28.12.2012** "Për emërimin e dy auditëve teknicienë", z. [ ] , propozuar nga Kryetarja e KQZ si dhe z. [ ] , propozuar nga zëvendëskryetari i KQZ.

**Vendimin e KQZ nr. 166, datë 22.02.2013** "Për caktimin e masës së shpërblimit për audituesit teknicienë".

**Udhëzimin e KQZ nr.2, datë 28.12.2012** "Për miratimin e rregullave për kryerjen e auditimit për verifikimin e të dhënave të regjistrit kombëtar të gjendjes civile ( RKGJC) dhe në (SEV).

**U paraqitën gjithashtu:**

**Raporti i Audituesit teknicien të KQZ z. [ ]** "Mbi testin e zhvilluar më datë 08.06.2013 për SEV Qarku Tiranës", drejtuar ky Raport KQZ, i protokolluar në KQZ me nr. 5412, datë 16.06.2013, **Kur në fakt vetë Raporti mban datën 17.06.2016!?!.**

**Shkresë Kthim përgjigje drejtuar KQZ nga audituesi teknicien** protokolluar në KQZ me nr. 544, datë 18.06.2013.

**Koment i KLSH mbi këto materiale të dërguara:**

**Nga ana e përfaqësuesve të KQZ në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016 të zhvilluar në ambientet e KLSH u pretendua se disponoheshin Raporte të audituesve teknicien të emërtuar nga KQZ. Ky pretendim kishte të bënte me konkluzionet e KLSH përsa i përket sistemit SEN të Qarkut Fier dhe në fakt dërgojnë ato të Sistemit SEV të Qarkut Tiranë. Gjë që ngarkon këto persona me përgjegjësi pasi konstatohet se një gjë e tillë bëhet me qëllim krijimin e tymnajave në punën audituese të KLSH. Kjo përforcohet duke parë**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

*frymën e observacioneve të dërguara në frymën e lojrave të fjalëve. Gjithashtu theksojmë se KLSH as nuk është shprehur dhe as nuk e sheh të nevojshme për tu shprehur në lidhje me këto dy "Raporte" pasi ato janë bërë mbi bazën e dokumentacioneve shkresore dhe jo nga auditimi në terren i provave të zhvilluara. Megjithatë nuk mund të kalojë pa u evidentuar fakti se një Raport i audituesit teknikën i propozuar nga Kryetarja e KQZ përgatitet më datë 17.06.2013 dhe protokollohet në KQZ me datë 16.06.2013!?. Po ashtu njafton të lexosh dhe "Raportin" e audituesit tjetër teknikën dhe konstatohet lehtësisht se në mënyrë të përmbledhur është në të njëjtën linjë me ato që ka konstatuar dhe Auditimi i KLSH në lidhje me Sistemin SEV të Qarkit Tiranë.*

**Janë dërguar nga KQZ dhe pesë CD me pamje filmike dhe fotografike nga provat e SEV dhe SEN.**

**Koment i KLSH mbi këto materjale të dërguara:**

*Në lidhje me këto materjale mund të konstatohet se ato mund të shërbejnë për dokumentim vetëm të faktit se janë zhvilluar provat por nuk sjellin asnjë fakt teknik për zhvillimin e tyre. KLSH në auditimin e tij si dhe në këtë Raport Përfundimtar Auditimi nuk ka pretenduar që nuk janë zhvilluar provat e këtyre dy Projekteve ( SEN dhe SEV) por ka pretenduar dhe vazhdon të pretendoj se ana e auditimit teknik të tyre nga KQZ ka qenë jashtë kontrollit. Gjë që vihet re dhe në këto materjale. Në këto CD për Projektin SEV të Qarkut Tiranë nuk tregohet në asnjë vend leximi i Chipave ( me dhe pa kontakt). Shihet në një rast leximi i MRZ.*

**Në të tilla kushte këto objeksione (si dokumentare dhe CD) nuk shërbejnë për të hedhur poshtë pretendimet e ngritura nga Grupi i Auditimit të KLSH por në të kundërt.**

Duke pasur parasysh faktin se observacionet e paraqitura kanë pasur nevojë për një trajtim më të veçantë me qëllim që çështjet e trajtuara të ishin sa më të qarta dhe ti shërbejnë më mirë hartimit të një Projektraporti Auditimi sa më të kuptueshëm kjo pikë e Auditimit u strukturua duke u renditur ( duke u cituar) tekstet e Procesverbalit, të observacioneve të bëra nga personat si dhe arsyetimin e grupit të auditimit në lidhje me observacionet.

Duke qenë nga ana e personave të atakuar në Projektraportin e Auditimit ( në lidhje me këtë pikë) kanë vazhduar të bëhen observacione të cilat kryesisht janë komente të komenteve të grupit të auditimit si dhe duke pasur parasysh pretendimin e Sekretarit të përgjithshëm të KQZ në takimin përmblyës të datës 01.06.2016 se observacionet e tyre janë ato që janë trajtuar në lidhje me procesverbalin dhe Projektraportin e Auditimit nga ana e KLSH u vlerësua që dhe Struktura e trajtimit të këtij auditimi të mos ndryshoj dhe në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. Në vazhdim do të ipet pjesa e trajtuar sipas Projektraportit të Auditimit dhe në pjesë të veçanta për ato pjesë të observacioneve që janë bërë për të dhe që nuk janë përsëritje apo komente mbi komentet e auditimit. Këto për lehtësi studimi janë trajtuar brenda kuadrateve dhe të nënvizuara.

**Pjesa sipas Projektraportit të Auditimit.**

**Nga auditimi rezultoi se:**

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 i ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012 ka përcaktuar përdorimin e teknologjive të informacionit në zgjedhje që kanë të bëjnë me dy projekte ai i SEV për Qarkun Tiranë dhe SEN për qarkun Fier të përcaktuara nga nenet 179 dhe 179/1 si dhe Shtojcat II dhe III të Kodit Zgjedhor.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

Këto projekte janë për herë të parë si aplikim nga shteti shqiptar dhe do të shërbenin për shtrirjen e tij në të gjithë vendin në të ardhmen.

**Për këtë qëllim sipas pikës 6 të nenit 179/1, dispozitë kjo e shtuar me ligjin nr.74/2012 datë 19.07.2012 dhe që i referohet vetëm zgjedhjeve të vitit 2013 me titullin (Masat për realizimin e teknologjisë së re informative në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013)**

**Përcaktohet: Procedurat e prokurimit, si rregull, duhet të përfundojnë jo më vonë se 6 muaj përpara zgjedhjeve të vitit 2013 (Qershor).** Në fakt konstatohet se këto procedura kanë përfunduar me lidhjen e kontratës më datë 25.Mars 2013 e nënshkruar nga

sipas autorizimit të titullares së Autoritetit Kontraktor me nr. 25/28 prot. datë 25.03.2013 kjo përsa i përket Projektit SEV. Ndërsa për Projektin SEN të Qarkut Fier kontrata mban në krye të saj datën "Tiranë 11.03.2013" dhe mban nr. (Prot.KQZ.) 26/22 datë 16.03.2013 kjo kontratë është nënshkruar nga titullarja e Autoritetit Kontraktor znj. Këto kontrata janë të lidhura ndërmjet KQZ dhe kompanisë fituese "Indra Sistemas" S.A (Kompani ndërkombëtare Spanjolle)

Zbatimi i këtyre detyrimeve ligjore për realizimin e këtyre dy projekteve ka filluar me dërgimin nga ana e Kryetares së KQZ shkresë me nr. 749 prot. datë 30.10.2012 z. Flamur Noka ish Minister i Brendshëm të cilit i kërkohet bashkepunimi në zbatim të nenit 179/1 pika 1 e ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 " Kodi Zgjedhor i RSH" i ndryshuar.

Nga ana e Ministrit të Brendshëm i është kthyer përgjigje KQZ me shkresën nr. 7536/1 datë 09.11.2012 (749.1 datë 13.11.2012 prot.KQZ) ku përcaktohet se për konsulencë të specializuar për ngritjen e sistemit SEV dhe SEN si përfaqësuese e Ministrisë së Brendshme është caktuar znj. me detyrë Drejtore e Dokumenteve të Identifikimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

**KQZ me Vendimin nr. 23 datë 28.12.2012** ka vendosur miratimin e procedurës prokuruese që do të përdoret për zgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet SEV dhe SEN në zgjedhjet e vitit 2013. Me këtë vendim të arsyetuar nga ana e KQZ është përzgjedhur forma e prokurimit që është ajo e "Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës", pa fond limit për të dy projektet. Kjo procedure është përzgjedhur me qëllim që të përfundoj lidhja e kontratave përgjatë muajit Janar të vitit 2013. Pasi vonesa në procedurat e tjera do të bënin që procedura të dështoj. Në fakt kontratat e lidhura nga KQZ janë në Mars 2013. Në këto kushte konstatohet se vetë KQZ që në Vendimin e saj nr.23 datë 28.12.2013 në pjesën arsyetuese ka qenë e ndërgjegjshme se lidhja e kontratave përtej muajit Janar 2013 do të sillte dështimin e këtyre projekteve të cilat sigurisht kërkojnë kohën e nevojshme për të realizuar provat dhe implementimin e tyre për ditën e zgjedhjeve. Kështu nga auditimi konstatohet se nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk janë marrë masat për ndërprerjen e këtyre procedurave duke i arsyetuar ato për të mos i firmosur këto kontrata, gjë që ngarkon me përgjegjësi titullaren e Autoritetit Kontraktor si nënshkruese e kontratës SEN por dhe si autorizuese për nënshkrimin e kontratës SEV. (Për këtë konkluzion janë bërë observacione të cilat trajtohen më poshtë)

Nga auditimi në lidhje me këto kontrata, konstatohet se: megjithëse kontrata për Projektin SEN mban datë 11.03.2013 sipas shkresës nr. 2643 prot. datë 12.03.2013 të Kryetares së KQZ i është dërguar Avokates së Përgjithshme të Shtetit znj. për këshillim kontrata e SEN për të cilën nga ana e Avokates së Përgjithshme të Shtetit i është kthyer përgjigje me shkresën 384/1 datë 13.03.2013 e protokolluar në KQZ me nr.2643/1 datë 13.03.2013. Në këtë shkresë i janë bërë një sërë vërejtjesh kontratës sidomos në pjesën që parashikon rastet e zgjidhjes së saj.

Gjithashtu sipas një shkrese me nr. 2643/2 datë 15.03.2013 të kryetares së KQZ i është dërguar për këshillim (Avokaturës së Shtetit) kontrata e Projektit SEV (theksojmë se nga interpretimi kronologjik i shkresave kemi të bëjmë me një gabim pasi duhet të jetë përsëri për



KONTROLLI I LARTË I SHETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

kontratën e projektit SEN) dhe në këtë shkresë interesimi është për dispozitën 10/c të kontratës. Nga ana e Kryetares së KQZ me shkresën nr.3076 datë 25.03.2013 i është dërguar Avokates së Përgjithshme të Shtetit znj. [ ] për këshillim kontrata e SEV për të cilën nga ana e Avokates së Përgjithshme të Shtetit i është kthyer përgjigje me shkresën 384/5 datë 26.03.2013 e protokolluar në KQZ me nr.3076/1 datë 26.03.2013. Në këtë shkresë i janë bërë një sërë vërejtjesh kontratës duke e konsideruar të njëjtë pothuaj me të parën (Kontratën e Projektit SEN) duke i quajtur të vlefshme dhe ridërguar komentet e bëra në lidhje me atë kontratë. Në shkresë citohet se: *“pavarësisht rekomandimeve tona, shkaqet dhe procedura e zgjidhjes së kontratës janë ruajtur njëlloj si në draftin fillestar. Duke qenë se kemi të bëjmë me një kontratë administrative që ka për objekt ofrimin e një shërbimi publik, zgjidhja e kontratës nga ana e Kontraktorit nuk duhet të jetë aq liberale sa parashikohet në draftin e sjellë për këshillim. Rekomandimet tona në këtë drejtim jua kemi dhënë në opinionin e mëparshëm”*.

Nuk kuptohet se si është e mundur që Kontrata e Projektit SEV është dërguar për këshillim më datë 25.03.2013 në një kohë që kjo kontratë është lidhur pikërisht në këtë datë nga KQZ. Po ashtu dhe për Kontratën e SEN e cila mban datën 11.03.2013 dhe datën e protokollit të KQZ 16.03.2013.

Konstatohet nga auditimi se jo të gjitha këshillimet e Avokaturës së Shtetit janë marrë në konsideratë. Këto kontrata ngelen me dispozita të favorshme për kontraktorin në rast zgjidhje të tyre për arsye që nuk varen prej tij por prej Autoritetit Kontraktor në një kohë kur vetë KQZ po lidhte këto kontrata në vonesë me një risk të shtuar për dështimin e këtyre Projekteve. Përveç kësaj konstatohet se në këto kontrata që janë pothuajse të ngjashme është parashikuar dhe mënyra e pagesës për sejcilin Projekt. Në këto pagesa (grafik) nga ana e KQZ nuk është pasur parasysh fakti se ndodhemi përpara një kontrate shërbimi e cila në vetvete do të kërkonte që minimalisht të kryhen pagesa vetëm pasi të ketë kaluar me sukses prova në lidhje me të dy Projektet veç e veç. Në të kundërt kjo dispozitë e kontratës parashikon pagesa edhe për pajisjet e marra me qira (në kontratë shprehet fjala blerje) nga kontraktori të cilat kanë të bëjnë për të gjitha qendrat e votimit për SEV dhe të Numërimit për SEN kur nuk dihej nëse prova për këto do të ishte e sukseshme apo jo. Këto pajisje do të ishin të nevojshme vetëm pas provës së sukseshme. Në lidhje me sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti kontraktor. Në lidhje me këto kontrata është paguar nga Autoriteti Kontraktor pagesat sipas tabelave të mëposhtme:

Për kontratën e Projektit SEN për Qarkun Fier

% e likuidimit të kontratës sipas etapave	Kohët e shpendarjes	Data	Kontrata pa TVSH në Euro	Likuiduar EURO
10%	Me dorëzimin e dokumentit të dizenjës së sistemit dhe atij të përkufizimit të provës paraprake	Një ditë pune pas firmosjes së kontratës	138,107.5	138,107.5
30%	Me realizimin e urdhrave të blerjes së pajisjeve hardware nga Indra, furnizuesve të saj, e justifikuar me një dokument të kërkesës së mallit nga ana e furnizuesit	Përpara datës 31.03.2013	414,322.5	414,322.5
30%	Me realizimin e provës së brendshme të aprovimit të sistemit përpara demonstrimit publik	10 Prill, do të mbahet kjo faturë faturimi dhe nëse prova shtyhet për çështje që nuk i përkasin	414,322.5	414,322.5



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

		"Indrës"		
20%	Implementimi i provës së përgjithshme	9.06.2013	276,215	
10%	Implementimi i ditës së votimit	Me dorëzimin e hardisqeve që përmbajnë imazhet e skanuara në sistem (24.06.2013)	138,107.5	
	<b>Totali i kontratës</b>		<b>1,381,075</b>	<b>966,752.5</b>
				<b>70 %</b>

Për Kontratën e Projektit SEV për Qarkun Tiranë.

% e likuidimit të kontratës sipas etapave	Kohët e shperndarjes	Data	Kontrata pa TVSH në Euro	Likuidimi EURO
10%	Me dorëzimin e dokumentit të dizenjës së sistemit dhe atij të përkufizimit të provës paraprake	Një ditë pune pas firmosjes së kontratës	266,099.5	266,099.5
50%	Me realizimin e urdhrave të blerjes së pajisjeve hardware nga Indra, furnizuesve të saj, e justifikuar me një dokument të kërkesës së mallit nga ana e furnizuesit	Përpara datës 31.03.2013	1,330,497.5	1,330,497.5
30%	Me realizimin e provës së software-it	23 Prill, do të mbahet kjo faturë faturimi dhe nëse prova shtyhet për çështje që nuk i përkasin "Indrës"	798,297.5	
10%	Implementimi i ditës së votimit	Me dorëzimin e e raporteve përfundimtare	266,099.5	
	<b>Totali i kontratës</b>		<b>2,660,995</b>	<b>1,596,597</b>
				<b>60 %</b>

Likuidimi i dy kontratave Sistemi SEN-SEV Tiranë dhe Fier, është bërë sipas urdhër shpenzimeve të mëposhtme:

Nr	Urdhërshpenzimi		Vlera në Euro	Konvertuar në lekë	Vlera euro e kontraktuar sipas etapave	Qëllimi i shpenzimit
	Nr	Datë				
1	177	10.05.2013	138,107.5	19,364,052	266,099.5	Dorëzimin e dokumentacionit "Dizenjim i sistemit dhe përcaktimi i provës paraprake Programi ALFIER (SEV)
	177	10.05.2013	414,322.5	58,150,162	414,322.5	Blerjes pajisje hardware nga ana e Indras, prej furnizuesve të saj programi ALFIER (SEN)
2	201	22.05.2013	414,322.5	58,833,795	414,322.5	Realizimin e provës së brendshme të aprovimit të sistemit përpara demonstrimit publik





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

						programi ALFIER (SEV)
3	179	13.05.2013	266,099.5	37,732,909	266,099.5	Dizenjim i sistemit dhe përcaktimi i provës paraprake. Programi ALTIR (SEV)
4	189	16.05.2013	1,330,497.5	188,930,645	1,330,497.5	Realizimi i sistemit elektronik të verifikimit të kartave të identitetit programi ALTIR (SEV)
					276,215	Implementimi i provës së përgjithshme të elektronik të verifikimit të kartave të identitetit, datë 09.06.2013 (SEV)
					798,297.5	Realizimi i provës së software-it
					138,075.5	Dorëzimi i hardisqeve me imazhet e skanuara në sistem 24.06.2013
					266,099.5	Implementimi i ditës së votimit për dorëzimin e raporteve përfundimtare
			2,563,349,5 (likuiduar)		4,042,070 (totali për Likuidim)	

Sa më sipër konstatohet se janë likuiduar për Projektin SEN Qarku Fier vlera (kësti i dytë qira pajisje) prej 30% të vlerës së kontratës në shumën prej: 414,322.5 EURO.

Për Projektin SEV Qarku Tiranë vlera (kësti i dytë qira pajisje) prej 50% të vlerës së kontratës në shumën prej: 1,330,497.5 EURO.

**Shuma e paguar padrejtësisht, nga parashikimi i gabuar në kontratë, për të dy Projektet është në vlerën: 1,744,820 EURO e cila përbën një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit për faktin se këto pajisje as nuk kanë lëvizur nga furnitori ( mungon dokumentacioni i regjimit të përkohëshëm sipas Kodit Doganor). Përgjegjësi kjo e Autoritetit kontraktor. ( Për këtë konkluzion janë bërë observacione të cilat trajtohen më poshtë).**

Me Autorizimin e Kryetares së KQZ nr.25/28 datë 25.03.2013 përveç se është autorizuar z. [ ] në pozicionin e Juristit të njësisë së Prokurimit në KQZ për të lidhur në emër e për llogari të KQZ kontratën me shoqërinë Spanjolle " [ ] " S.A me objekt: "Realizimin e sistemit elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve në Qarkun Tiranë" është autorizuar në pikën 2 të saj (Autorizimit) dhe z. [ ] si supervisor i KQZ për të ndjekur realizimin e detyrimeve kontraktuale të kontratave SEV dhe SEN . Kështu që detyrat e z. [ ] burojnë nga vetë kontratat e lidhura për këtë qëllim.

I thirrur nga ana jonë ( Grupit të Auditimit) më datë 09.03.2016 z. [ ] nuk mbante mend që të ishte caktuar si Drejtues Projekti si dhe pretendonte se defakto është cilësuar në shkresa të ndryshme nga Indra si Drejtues Projekti por nuk kishte ndonjë urdhër apo detyra të shkruara në lidhje me personin e tij.

Në takimin e zhvilluar përsëri më datë 17.03.2016 me z. [ ] duke ju vendosur përpara ky autorizim i KQZ (i sipërcituar) si dhe për pyetje në lidhje me dokumentimin dhe ndjekjen e realizimit të kontratave të këtyre Projekteve e kryesisht për Projektin SEV. Ai nuk ishte në gjendje të shpjegonte përpara grupit të auditimit procedurat e zhvilluara për sejcilën nga provat e realizuara si dhe nuk dispononte dokumentacion tjetër që të mundësonte një gjë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

të tillë. I pyetur në lidhje me provën e realizuar për leximin e Kartave dhe Pasaportave për Chip-et me dhe pa kontakt ai nuk dha shpjegim teknik. Në këto kushte mban përgjegjësi për këtë mosdokumentim teknik në lidhje me përmbajtjen realisht të leximit të chipave me dhe pa kontakt gjatë procesit të kryerjes së provave.

Nga ana e Grupit të Auditimit u kërkua një takim sqarues për këtë çështje dhe me znj. [ ] e cila ka qenë pjesë e Njësisë së Prokurimit të Autoritetit Kontraktor në cilësinë e specialistes të ngarkuar nga institucioni i Ministrisë së Brendshme. Një gjë e tillë nuk u realizua e për këtë arsye nga ana e Grupit të Auditimit ju kërkua dhe u realizua nga strukturat drejtuese të KLSH dërgimi i një shkrese zyrtare për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme për sqarimet e kërkuara në lidhje me Chip-at me kontakt dhe pa kontakt të kartave të identitetit si dhe pasaportave biometrike të lëshuara para vitit 2013. (të cilat kanë qenë objekt i leximit për projektin SEV të Qarkut Tiranë sipas legjislacionit në fuqi, Kodi Zgjedhor, dhe Kontratës së lidhur për këtë qëllim). Deri në datën e mbajtjes së procesverbalit nuk është kthyer përgjigje. *(Përgjigja ka mbërritur në KLSH më datë 31.03.2016 e cila trajtohet në pjesën e mëposhtëme ku trajtohen observacionet)*

Theksojmë se: këto paqartësi nga ana e Grupit të auditimit kanë ardhur nga mosdokumentimi i procesit teknik të zhvillimit të provave si dhe mungesa e shpjegimeve si nga Drejtusi i Projektit ashtu dhe nga përfaqësuesja e Ministrisë së Brendshme që ka qenë në cilësinë e specialistes në këtë prokurim. **Gjë që ngarkon me përgjegjësi këto persona.**

Në datën 19.06.2013 Kryetarja e KQZ njofton shoqërinë " " për zgjidhjen e parakohëshme të kontratës dhe procedurat e identifikimit dhe të regjistrimit të pjesëmarrësve në zgjedhje dhe mosaplikimin e teknologjisë SEV në qarkun Tiranë, dhe identifikimi i zgjedhësve në votimet e datës 23.06.2013 do të bëhen në mënyrë manuale. Kjo bazuar në Vendimin e KQZ me nr.598 datë 18.06.2013 e arsyetuar. Kjo vendimmarrje ka ardhur pas dy provave të realizuara nga kontraktori pa sukses si dhe një prove të tretë të pa monitoruar nga Drejtuesi i Projektit.

**Përsa i përket zbatimit të kontratës për Projektin SEN të Qarkut Fier** nga KQZ është marrë Vendimi nr.576, datë 17.06.2013 Për zbatimin e numërimit me dorë të votave në zonën zgjedhore të Qarkut Fier në zgjedhjet për kuvendin të datës 23.06.2013. Në këtë vendim është arsyetuar fakti se nga KQZ me Vendimin nr.446 datë 20.05.2013 "Për disa ndryshime në Vendimin KQZ nr.23 datë 05.02.2013 ndryshoj disa specifikime të modelit të fletës së votimit për tu përshtatur me numrin e rritur të subjekteve zgjedhore të paparashikuara këto në kontratë. Këtu më kryesorja është zgjatja e fletës së votimit dhe koha e shkurtër për ndryshime në softwerët nga ana e kontraktuesit të cilët megjithë negociatat nuk pranuan pasi nuk e konsideronin të realizueshme një kërkesë të tillë.

Në lidhje me këtë kontratë për Projektin SEN me nr. 26/22, datë 16.03.2013 (e cila mban datën në krye të printuar "Tiranë 11.03.2013") nga auditimi konstatohet se:

Para lidhjes së kontratës me shoqërinë fituese KQZ me vendimin nr. 175, datë 08.03.2013 për zonën zgjedhore qarku Fier ka miratuar dy modele fletësh votimi, respektivisht modeli format i fletës së votimit me 42 subjekte zgjedhore dhe modeli tjetër në formatin "landskrape" e cila mund të përmbante deri në 66 subjekte.

Nga auditimi mbi kronologjinë e vendimeve të KQZ, konstatohet se qysh në vendimin e KQZ-së nr. 175, datë 08.03.2013 për zonën zgjedhore Qarku Fier, ku është miratuar modeli dhe formati portret i fletës së votimit, realizimi i këtij projekti është vënë në pikpyetje, për faktin se KQZ ka miratuar dy alternativa, respektivisht i pari "fletë votimi" me 42 subjekte zgjedhore dhe modeli i dytë me 66 parti *(kjo pjesë është trajtuar në pjesën ku trajtohen observacionet)* sipas numrit të partive të regjistruara në zgjedhjet para ardhëse në formatin "landskrape". Këtu duhet të theksojmë dhe faktin e mënyrës së parashikuar të palosjes së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

fletës së votimit e cila duhej të palosej jo në katërsh në formën klasike që janë edukuar zgjedhësit shqipëtar deri më sot por në një formë të re në palosje që i ngjan palosjes së shkresave zyrtare. Kjo gjë pasi kryqet e shkaktuara nga palosja e fletës së votimit (me dritë hijet e sajë) do të bënte që makineria numëruese, për këtë proces, të gabonte duke e konsideruar si të pa vlefshme. Pretendimi i Autoritetit Kontraktor në lidhje me mënyrën se si do ta realizonte një gjë të tillë që nga zgjedhësit të respektohej kjo lloj palosje është se: *do të bënte informim publik*. Por nuk jep asnjë garanci se si nga informimi publik do të implementohej në proces të votimit nga zgjedhësit të cilët i përkasin niveleve të ndryshme arsimore e kulturore dhe me tradit, të mësuar, me mënyrë tjetër votimi ku fleta e votimit paloset në katërsh. Kjo gjë ka rëndësi se prova në këtë rast duhej që të kishte një gabim jo më të madh se 0,5 % sipas Kodit Zgjedhor Seksioni 5 Shtojca II.

Nga auditimi rezultoi se: për zbatimin e këtij vendimi kompania "Indra", pas lidhjes së kontratës ka kryer një provë më datën 13.04.2013.

Në kontratën e lidhur midis palëve, aneksi 2, sqarime për KQZ ,pika 3 "përgjigje mbi pyetjen 3, rezulton se shoqëria " ", për realizimin e provës do printojë 6,000 vota në letër standarte me dizeno të aprovuar nga CEC që do t'i japë "Indras" përmbajtjen (kandidatët e stimuluar, logon,etj) në format elektronik. Votat do jenë në masë maksimale në format 42 x 29.7 cm, në letër të bardhë 90 gr/m<sup>2</sup>, ngjyrë printimi offset 4/4 duke përfshirë barkode informacioni të ndryshme.

Në përfundim të kësaj prove Drejtori i Projektit " ", ka nënshkruar faturën e kompanisë. Pas kalimit të kësaj prove kompania " " ka paraqitur faturën me nr. 13040859, datë 15.04.2013 me vlerën 414,322.5 Euro me objekt: "Realizimin e urdhrave të blerjes së pajisjeve hardware nga " ", furnizuesve të saj, e justifikuar me një dokument të kërkesës së mallit nga ana e furnizuesit".

Nga verifikimi i kryer në lidhje me dokumentacionin bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr. 201, datë 22.05.2013, për të justifikuar pagesën prej 414,322.5 Euro, me objekt realizimin e provës së brendshme para demonstrimit publik, Grupi i Auditimit të KLSH, nuk gjeti asnjë dokument të mbajtur nga Drejtori i Projektit " ", ku të evidentoheshin pajisjet e përdorura nga kompania, sasia e fletëve të votimit të printuara, numrin e subjekteve të regjistruar të marra si shëmbull për demonstrim dhe rezultati përfundimtar i kësaj prove i dokumentuar në një raport të mbajtur dhe të nënshkruar nga palët pjesëmarrëse të pranishme në këtë provë. Këto të dhëna do të shërbenin si një dokument zyrtar i rëndësishëm për dokumentimin e punës në këtë fazë dhe që do shërbente për vazhdimin e fazës tjetër me objekt "porositjen e pajisjeve hardware që nevojiteshin për numërimin elektronik me ngarkesë maksimale të numërimit të votave në të gjithë Qarkun Fier" për të cilën u likuidua paradhënie në vlerën prej 414,322.5 Euro.

Në lidhje me këtë provë u pyet më datë 17.03.2016 drejtori i projektit " " në se disponon dokumenta, ku të jetë evidentuar ecuria e provës apo raport teknik sipas kushteve të kontratës.

Për këtë, Drejtori i projektit z. " " nuk na paraqiti asnjë dokument ku të jetë evidentuar ecuria e projektit dhe rezultati përfundimtar që çuan në kalimin e kësaj etape, për të cilën është kryer edhe pagesa. (Për këtë konkluzion janë bërë observacione të cilat trajtohen më poshtë).

Grupit të auditimit ju vendos në dispozicion nga KQZ një Raport i detajuar mbi këtë provë të datës 13.04.2013 të bërë nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste të Shqipërisë. Në këtë material konstatohet nga vetë ata se prova nuk ka rezultuar e sukseshme dhe kjo e detajuar me hollësi teknike dhe procedurale. Në përfundim kërkohet që të merren masat për



KONTROLLI I LARTË I SHETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

përmirësimin e këtyre të metave në realizimin e një prove tjetër në të kundërt një proces i tillë do të konsiderohej e pa pranueshme.

Megjithëse në dijëni me këtë material nga Drejtuesi i Projektit nuk është bërë një Raport teknik duke mos përmbushur detyrën e tij funksionale gjë që e ngarkon atë me përgjegjësi. Nga ana tjetër nga vetë KQZ nuk është kërkuar një raport i hollësishëm në lidhje me zbatimin e detyrimeve kontraktuale në lidhje me këtë proces. Duke i ngarkuar ata me përgjegjësi pasi në kushtet e dështimit të kësaj prove është bërë dhe likuidimi i faturës me vlerën prej: 414,322.5 Euro të cilat përbëjnë dëm ekonomik. (Për këtë ka observime të trajtuara më poshtë).

Njëkohësisht duke u quajtur e kaluar me sukses kjo provë zgjidhja e kontratës ka ngelur si faji i KQZ e cila ka penguar realizimin vetëm për shkak të numrit të shtuar të subjekteve zgjedhore ashtu si përshkruhet në Vendimin e KQZ nr. 576, datë 17.06.2013 ku citohet: *Ndryshimet e fletës së votimit ku më kryesorja është gjatësia e fletës së votimit, përbën ndryshimin thelbësor të kushteve të kontratës, dhe në kohën kur jemi vetëm 6 ditë përpara datës së zgjedhjeve shoqëria " " nuk mund të përshtasë në Sistemin Elektronik të Numërimit dhe softet përkatëse me ndryshimin e madhësisë së fletës së votimit. Në këto kushte kontrata me shoqërinë " " me objekt "Realizimin e projektit të sistemit elektronik të numërimit në zonën zgjedhore qarku Fier, në mbështetje të rubrikës 9, pika "d" dhe "e" të saj përfundon në mënyrë të parakohshme. Dhe numërimi i votave në këtë qark do të bëhet me dorë".*

Nga auditimi konstatohet se, koha që shoqëria " " për realizimin e këtij projekti ka qenë e mjaftueshme pasi sipas nenit 64 pika 1 e "Kodit zgjedhor" është përcaktuar se: "Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve", pra afati maksimal është data 13 prill 2014 dhe sipas nenit 65, pika 1, ku është përcaktuar se "Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve", pra afati maksimal i regjistrimit të tyre është data 23 prill 2013.

Sipas nenit 67 "Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive" pika 1 është përcaktuar se; Partia Politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumëmemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.

Në përfundim nga auditimi konstatohet se në lidhje me këto dy Projekte të dështuara janë paguar shuma prej 2,563,349,5 Euro nga kjo vlera prej 2,159,142.5 Euro përbën dëm ekonomik për buxhetin e Shtetit e cila ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Kontraktor si përgjegjës që në hartimin e tyre si dhe ndjekjen e zbatimit të këtyre, kontratave. Po ashtu ngarkohen me përgjegjësi personat e përmendur në këtë procesverbal (këtë pikë) në lidhje me mos dokumentimin e procesit të zbatimit të këtyre projekteve.

**(Në fund të procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim citohet):** *Në këtë procesverbal nuk përshkruhen me detaje procedurat e prokurimit të këtyre dy Projekteve pasi ato mund të gjejnë një trajtim më të detajuar në Projektraportin e Auditimit. Kjo dhe për arsye se këto procedura kanë qenë dhe objekt i hetimit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Nga ana e znj

me shkresën nr. 226/10 datë 31.03.2016

u paraqitën observacione e mëposhtme për të cilat nga ana e grupit të auditimit janë bërë dhe komentet në lidhje me ato pjesë për të cilat grupi i auditimit është shprehur në procesverbal apo për të cilat është konstatuar se kanë qenë shkelje e për të cilat janë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

ngarkuar me përgjegjësi personat. Një pjesë e konsiderueshme e observacionit ka të bëjë me përshkrim të procedurave apo komente të ndryshme për të cilat nga ana jonë janë pasqyruar të plota por që nuk janë objekt për komente nga ana jonë. Ato paraqiten si më poshtë:

**Observacioni:**

Audituesit nuk kanë marrë parasysh të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga KQZ-ja, ose iu janë referuar pjesërisht atij (referim i cili nuk ka kuptim pa u njohur me të gjithë dosjen për shkak të karakterit që ka kjo procedurë).

**Përgjigje e Grupit të Auditimit:**

*Kush është kjo dosje apo dokumentacion? Grupit të auditimit ju vendos në dispozicion të gjithë dokumentacioni i disponuar, që në fillim të auditimit, si dhe nuk u pretendua nga kushdo që të kishte të tjera materiale dokumentare megjithëse këto dokumentacione ishin të pa inventarizuara me pretendimin se ishin ashtu si kishin ardhur nga Prokuroria. Por dhe në observacionet e dërguara nga ana e znj. [ ] dhe z. [ ], apo dhe z. [ ]*

*[ ] nuk janë paraqitur dokumentacion tjetër që Grupi i auditimit nuk e ka pasur disponibël. Nga ana e grupit të auditimit disa herë ju kërkua material tjetër i disponueshëm nga KQZ në lidhje me dokumentimin e provave dhe Raporteve për këto prova të bëra nga z. [ ] kjo kërkesë ju drejtua si Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ ashtu dhe z. [ ] dhe z. [ ] në mënyrë të drejt për drejtë dhe nga ana e tyre pretendoheshin se nuk disponoheshin dokumentacion shtesë.*

**Observacioni në lidhje me Projektraportin e Auditimit si dhe në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016 është bërë po e njëjta observim.**

**Dokumentacioni i paraqitur më datë 03.06.2016 pas takimit përmbyllës nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ është trajtuar në krye të kësaj pike (VI.2).**

**Observacioni:**

Audituesit nuk kanë kërkuar asnjë shpjegim apo pyetur qoftë edhe një herë në lidhje me procedurën të cilin auditorin Kryetaren e KQZ-së, [ ] (emri i së cilës përmendet në të gjithë procesverbalin duke e ngarkuar me përgjegjësi, ku çdo funksion dhe detyrë kryhet nga e gjithë trupa e KQZ-së (Anëtarët) dhe nëpunësit e administratës, duke e konsideruar të gjithë institucionin e KQZ të barabartë vetëm me një punonjës në organik, Kryetaren)

Audituesit, referuar procesverbalit, (faqe 2-paragrafi 1; faqe 3-paragrafi 1; faqe 5 rreshti i fundit; faqe 6 -paragrafi 2; faqe 7, faqe 8, faqe 9) kur citojnë përgjegjësitë e subjekteve, për shkeljet e konstatuara sipas tyre:

**nuk citojnë asnjë dispozitë ligjore të shkelur nga ana e tyre apo asnjë dispozitë ligjore në referencë të së cilës duhet të mbajnë përgjegjësi këta persona.** Ato çfarë shkruajnë audituesit janë vetëm parashikime të tyre, hamendësime, që hera-herës i ngarkohen edhe Kryetares së KQZ-së, e cila nuk ka patur asnjë kontakt me ta.

Nuk është marrë në konsideratë fakti që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka marrë në shqyrtim këtë praktikë nëpërmjet kallëzimit penal të depozituar nga Sekretari për Çështjet Zgjedhore i Partisë Socialiste ndaj shtetasve [ ] dhe [ ] të Komisionit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe

Vlerësimit të Ofertave të Tenderit për projektin SEV-SEN, për veprën penale të parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal "Shpërdorim detyrë", dhe në përfundim të hetimit duke shqyrtuar të gjithë këtë praktikë ka vendosur:

**"Pushimin e hetimeve për procedim penal nr.6764-2013, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" të parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal".**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

**Përgjigje e Grupit të Auditimit:**

*Ky observacion nuk merret parasysh për arsye se pikërisht në fund të procesverbalit (objekt i këtij observacioni) dhe jo pa qëllim është cituar e theksuar paragrafi: "Në këtë procesverbal nuk përshkruhen me detaje procedurat e prokurimit të këtyre dy Projekteve pasi ato mund të gjejnë një trajtim më të detajuar në Projektraportin e Auditimit. Kjo dhe për arsye se këto procedura kanë qenë dhe objekt i hetimit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë".*

*Përsa i përket dispozitave të shkelura nga personat e ngarkuar me përgjegjësi konstatohet se në përfundim të dy procedurave të prokurimit për të dy projektet (SEV dhe SEN) nga KQZ janë lidhur kontratat respektive. Këto kontrata sipas nenit 690 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë citohet se : Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Kështu si të tilla si në hartimin e tyre ashtu dhe në zbatimin e tyre, nga auditimi, janë konstatuar parregullsi dhe një gjë e tillë është konstatuar në fazën e hartimit dhe nga ish Avokatura e Shtetit.*

*Nga ana e grupit të auditimit edhe faza e mbajtjes së procesverbalit konsiderohet si një fazë e auditimit e cila sigurisht që vazhdon dhe se deri në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit parashikohen dhe takime ballafaqese me personat të cilët në përfundim të shqyrtimit të observacioneve jo vetëm mbi procesverbalet por dhe mbi konkluzionet në Projektraportin e Auditimit kanë observime apo vërejtje të ndryshme.*

**Observacioni i bërë dhe në lidhje me Projektraportin e Auditimit si dhe në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016 është bërë po e njëjta observim.**

**Përsa i përket takimeve të munguara: KQZ si dhe çdo personi të atakuar në materialin e auditimit i është dhënë e gjithë mundësia për të paraqitur çdo objeksion. Po ashtu i është dhënë mundësia për çfardo takimi ballafaqes dhe Kryetares së KQZ duke iu kërkuar dhe me shkresë zyrtare ashtu si trajtohet në fillim të kësaj pike auditimi.**

**Përsa i përket Vendimit të Prokurorisë për pushimin e procedimit penal. Sqarohet se nga ana e KLSH është bërë auditimi i këtyre dy projekteve në zbatim të detyrës audituese.**

**Observacioni:**

Audituesit nuk kanë marrë parasysh faktin se për këto dy projekte legjislatori në datën 27.12.2012, vetëm një ditë përpara vendimmarrjes së KQZ-së (Vendimi 23, datë 28.12.2012) ndryshoi Ligjin "Për Prokurimin Publik" dhe konkretisht nenin 4 dhe nenin 6 të tij.

Neni 6 i këtij ligji, i ndryshuar, parashikon se; *Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike në rast se, zbatimi i tyre kërkon masa të veçanta sigurie në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit* (referencë ligjore e përdorur në dy Urdhërat e Prokurimit, të nxjerra për SEN dhe SEV, bashkëlidhur).

Prapësimet tona do të jenë në kuadrin e shpjegimeve për çdo procedurë/veprim të kryer në zbatim të dispozitave konkrete të legjislacionit në fuqi, Ligjit "Për Prokurimin Publik", Kodit Zgjedhor, Ligjit "Për menaxhimin financiar" si dhe të Vendimeve të KQZ-së.

**Çdo veprim në lidhje me zbatimin e kontratave, nr.26/22 prot, datë 16.03.2013, dhe nr.25/29 prot, datë 25.03.2013, janë bërë në zbatim të Kodit Zgjedhor (shtojca II dhe Shtojca III) dhe vendimeve të KQZ-së, referuar neneve 21, 21/1,21/2) vendime për miratimin e të cilave Kodi Zgjedhor, në rastin e projekteve pilote për të dy teknologjitë ka parashikuar edhe votim të cilësuar 5 me 2.**

**Përgjigje e Grupit të Auditimit:**

*Pretendimet nga grupi i auditimit nuk kanë të bëjnë me përzgjedhjen e procedurës së prokurimit në kuptim të përgjegjësisë së KQZ por të faktit të mënyrës së hartimit e miratimit*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

të tyre kontratave me kushte mjaft të favorshme ndaj kompanisë Indra. Konstatim ky që është evidentuar dhe nga vetë Avokatura e Shtetit dhe të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga KQZ. Ne nuk disponojmë ndonjë Vendim të KQZ që të ketë shqyrtuar e miratuar kushtet e këtyre kontratave dhe ti ketë miratuar ato. Gjithashtu nga ana e Grupit të auditimit nuk është ngritur ndonjë pretendim për formën e prokurimit të përzgjedhur nga KQZ por është përshkruar përzgjedhja e saj dhe arsyet që kanë ndikuar në përzgjedhjen e saj që mbi të gjitha dhe më e rëndësishmja ka qenë koha e nevojshme në dispozicion. Për këtë ky observacion nuk merret parasysh nga ana jonë.

**Observacioni:**

Zj. [Emri] referuar ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar", i ndryshuar nuk është titullare e Autoritet Kontraktor (e cilësuar si e tille në faqe 1, paragrafi 3, faqe 2,3, 6 të procesverbalit).

Titullar i Autoritetit Kontraktor i Institucionit të KQZ, në zbatim të Ligjit "Për Prokurimin Publik", Ligjit "Për menaxhimin financiar" është Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit. Kjo është e evidente në çdo dokumentacion tenderues, të cilin j'ua kemi vënë në dispozicion ku në të gjithë Urdhërat e Prokurimit ka nënshkruar zj. [Emri], si Titullare e Autoritet Kontraktor.

Gjithashtu, raportet përmbledhëse të dokumentacionit për këtë procedurë janë hartuar dhe nënshkruar nga zj. [Emri], po me cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor. (bashkëlidhur dokumentacioni tenderues)

Zj. [Emri], në cilësinë e Kryetares së KQZ-së, në rastin konkret të citimit (faqe 2, paragrafi 1, të procesverbalit nr.2) ka përfaqësuar KQZ, duke nënshkruar kontratat me cilësinë "Për dhe në përfaqësim të KQZ" (faqja e fundit e kontratës), apo duke lëshuar autorizimin për nënshkrimin e kontratave, "Për dhe në përfaqësim të KQZ".

Kryetarja e KQZ, në zbatim të nenit 20, të Kodit Zgjedhor kryen funksionet e drejtuesit administrativ të institucionit, përfaqëson KQZ-në, në marrëdhënie me institucionet e tjera dhe **nxjerrë urdhëra në bazë dhe për zbatim të vendimeve të KQZ.**

Kryetarja e KQZ-së, në vendimmarrjen e komisionit është e barabartë mes anëtarëve dhe vendimmarrja e komisionit është kolegjiale, ajo nuk ka asnjë tagër ligjor për moszbatimin e vendimeve të KQZ-së.

***Në referencë të dispozitave të Kodit Zgjedhor, mendoj se auditët nuk e kanë pasur të qartë cilësinë e funksionit të Kryetares së KQZ-së.***

**Përgjigje e Grupit të Auditimit:**

***Ky observacion nuk pranohet pasi zj. [Emri] është titullare e Autoritetit Kontraktor ndërsa Sekretari i Përgjithshëm është person i autorizuar i cili luan rolin e titullarit të autoritetit kontraktor për aq sa është i autorizuar dhe nga grupi i auditimit pretendimet në procesverbal kanë qenë mbi veprimtari të znj. [Emri] dhe jo të Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ. Kjo për arsye se është vetë observuesi nënshkruesi i këtyre kontratave.***

**Observacioni në lidhje me Projektraportin e Auditimit si dhe në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016 është bërë po e njëjta observim. KLSH i qëndron arsyetimit të bërë duke mos pranuar këtë observim, pretendim.**

**Observacioni:**

Kryetarja e KQZ-së, në zbatim të nenit 20, pika 1, gërma b, faqe 11, të Kodit Zgjedhor "Kryetari i KQZ-së, ka të drejtë të nxjerrë Urdhëra të Brendshëm, vetëm në bazë dhe për zbatim të vendimeve të KQZ-së".



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Në këtë mënyrë referuar opinionit të auditëve, detyra e vetme e Kryetares së KQZ-së, bazuar në Vendimin e KQZ nr.23, datë 28.12.2012 “Miratimi i procedurës prokuruese që do të përdoret për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet teknologjike SEN dhe SEV, që do të aplikohen në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 Qershor 2013”, ka qenë lidhja e kontratave, pasi në zbatim të nenit 20, të Kodit Zgjedhor, Kryetarja e KQZ, përfaqëson institucionin në marrëdhënie me institucionet e tjera. Pra, Kryetarja e KQZ nuk ka asnjë të drejtë përtej vendimmarrjes së KQZ, e cila është vendimmarrje kolegjiale, as ta gjykojë këtë vendimmarrje, as të mos e zbatojë atë dhe si rrjedhojë nuk ka asnjë përgjegjësi individuale.

Vendimi i KQZ-së, nr.23, datë 28.12.2012, “Miratimi i procedurës prokuruese që do të përdoret për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet teknologjike SEN dhe SEV, që do të aplikohen në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 Qershor 2013”, në pjesën arsyetuese të tij shpjegon në mënyrë të detajuar afatet proceduriale të përcaktuara nënenet 12, pika 1, pika 2/ë, neni 29, pika 1/c, neni 32, pika 1/b, neni 33, pika 2/c, neni 32 i ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Në reference të të gjitha këtyre neneve, KQZ-ja me vendimmarrje përcaktoi dhe procedurën prokuruese, në mënyrë të tillë që të realizohej implemtimi i dy teknologjive duke patur parasysh që përpara datës së zgjedhjeve në zbatim të pikës 1, Seksionit 3, Shtojca II dhe pika 4, seksioni IV, shtojca III, të zhvillohej testimi paraprak.

Konstatimi i audituesve të KLSH-së, se në pjesën arsyetuese të Vendimit të KQZ-së nr.23, se është pranuar se kontrata duhet të përfundojë në muajin janar pasi vonesa do të bënte që procedura të dështojë, është i pavërtetë pasi në asnjë rresht të këtij vendimi nuk është cituar një gjë e tillë.

Qëllimi, arsyetimi dhe objekti i këtij vendimi ka qenë vetëm ai i caktimit të llojit të procedurës prokuruese dhe nuk është vënë në pikëpyetje në asnjë moment realizimi i procesit.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, nisur nga fakti se këto dy projekte ishin projekte pilote, parashikonte në nenin 21/2 pika 3, shtojcën II, seksioni 3 dhe seksioni IV, pika 4, shtojca 3 në mënyrë të qartë dhe “dështimin” e tyre, në disa faza të ndryshme të implementimit, por në asnjë rast nuk parashikonte dështimin e tyre si pasojë e pamundësisë së procedurave tenderuese. KQZ-ja duhet të përfundonte procedurat tenderuese dhe të lidhte kontratat përkatëse me operatorët fitues.

Natyrisht që nuk mund të parashikohej edhe koha e nevojshme për negociatave me kompaninë fituese, pasi ky projekt ishte unik në llojin e tij dhe po zbatohej për herë të parë në Shqipëri. I gjithë procesi i negociatave për përzgjedhjen e fituesit dhe deri në nënshkrimin e kontratave është dokumentuar në procesverbalet përkatëse të mbajtura nga KVO-të respektive.

#### **Përgjigje e Grupit të Auditimit:**

Përsa i përket Vendimit të KQZ nr. 23 datë 28.12.2012, “Miratimi i procedurës prokuruese që do të përdoret për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet teknologjike SEN dhe SEV nga ana e Grupit të auditimit nuk është ngritur ndonjë pretendim në lidhje me formën e prokurimit të përzgjedhur por për faktin se forma është përzgjedhur për arsye të emergjencës ku ndollej KQZ për efekt kohe për zhvillimin e procedurave dhe kërkesave ligjore për afatet e zbatimit të provave.

Përsa i përket observimit të mësipërm të nënvizuar nga ana jonë konstatojmë se Vendimi 23 shprehet pikërisht me atë interpretim që grupi i auditimit i ka bërë këtij Vendimi që në procesverbal. Në këtë vendim mjafton të lexosh fjalinë e fundit të pjesës arsyetuese ku citohet tekstualisht: *Procedura “negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” sipas*





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

*përcaktimeve të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 " Për rregullat e prokurimit publik" mundëson lidhjen e kontratës brenda datës 26.01.2013.*

*Më sipër citohet se procedura "negocim me botim paraprak të njoftimit të kontratës" duke ndjekur fazat dhe afatet e përcaktuara në VKM nr. 1 datë 10.01.2007 " Për rregullat e prokurimit publik", në çdo rrethanë, kontrata nuk mund të lidhet para datës 26.02.2013.*

**Për këtë arsye nga grupi i auditimit nuk merret parasysh ky observacion pasi kontratat janë parashikuar për tu lidhur në Janar ato faktikisht janë lidhur në Mars 2013.**

**I njëjti qëndrim observues është mbajtur dhe në lidhje me Projektraportin e Auditimit si dhe nga përfaqësuesit e KOZ në takimin Përmbyllës të datës 01.06.2016 të zhvilluar në ambientet e KLSH.**

**Më poshtë do të gjeni dhe një skanim të Vendimit të KOZ nr.23. Kjo për faktin se nuk kuptojmë sesi vazhdojnë të observojnë dhe ta mbrojnë një gjë të tillë dhe në takimin përmbyllës përfaqësuesit e KOZ. Shënim ky i bërë në këtë Raport Përfundimtar nga KLSH.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS PROKURUESE QË DO TË PËRDORET PËR PËRZGJEDHJEN E  
SHOQËRIVE QË DO TË REALIZOJNË PROJEKTET TEKNOLOGJIKE SEN DHE SEV, QË DO TË  
APLIKOHEN NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 23 QERSHOR 2013

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2012, me pjesëmarrjen  
e:

Lefterije	LLËSHI (LUZ)-	Kryetare
Denar	BIBA-	Zv/Kryetar
Albana	SHTYLLIA	Anëtare
Hysen	OSMANAJ-	Anëtar
Ilirjan	MUHO-	Anëtar
Jani	JANI-	Anëtar
Vera	SHTJEFNI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimi i procedurës prokuruese që do të përdoret për përzgjedhjen  
e shoqërive që do të realizojnë projektet teknologjike SEN dhe SEV,  
që do të aplikohen në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës  
23 qershor 2013.



nr 23 i Vendimit Data 28.12.2012 e Vendimit Ora 00.00 e Vendimit

Për përcaktimin e procedurës prokuruese që do të përdoret për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë  
projektet SEN dhe SEV, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDOR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1/a, neni 179/1 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;  
Neni 12, pika 1, pika 2/4, neni 29, pika 1/c, neni 32, pika 1/b, neni 33, pika 2/c, 32 i ligjit nr.9543 datë 20.11.2005 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", Kreu IV, pika 4 dhe 5.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike

**VËREN**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të urdhërimeve të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ka detyrimin të zbatojë përdorimin e teknologjisë së informacionit në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23.06.2013.

Konsideruar se implementimi i këtyre dy teknologjive përbën risi në administrimin e zgjedhjeve, si dhe për vetë specifikat e tyre, u ngrit një Grup Punë i përbërë nga specialistë të administratës së KQZ-së, të asistuar edhe nga përfaqësues të AKSH-it dhe Ministrisë së Brendshme, me qëllim përgatitjen e kërkesave bazë të projektim-zbatimit për të dy projektet, SEN dhe SEV.

Administrata e KQZ-së, në referim edhe të përcaktimeve të legjislativës për prokurimet, kishte planifikuar që specifikimet teknike për të dy projektet të realizoheshin nga një kompani e specializuar, shërbimi i së cilës do të prokurohet.

Në kushtet e pamjaftueshmërisë së kohës në dispozicion, që legjislativi i prokurimit publik kërkon për procedurën e mësipërme, pas diskutimit edhe nga trupa e KQZ-së të kërkesave bazë për të dy projektet, u konkludua që administrata e KQZ-së të përgatisë specifikimet teknike duke synuar hartimin e një projekt-buxheti të bazuar mbi këto specifikime.

Grupi i punës, në përmbushje të kësaj detyre, arriti të definonte termet e referencës (kërkesat bazë, kërkesa kualifikuese) që do të përdoren në procedurat prokuruese për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet SEN dhe SEV.

Në kushtet kur këto projekte do të realizohen për herë të parë në Shqipëri, nuk janë të përdorura gjërat në botë, Grupi i Punës u gjend në kushtet e pamundësisë për të gjetur mënyrën e përlogaritjes së vlerës së fondit limit që do të përdoret në secilin nga këto procedura prokuruese të parashikuara nga VKM nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, në Kreun II, pika 2/.

Në kushtet e mungesës së referimeve të përcaktuara në aktin ligjor sipërcituar, do të duhej të aplikohet procedura prokuruese "shërbim konsulence", për të prokuruar projektin teknik së bashku me projekt-preraportin me buxhetin përkatës. Por kjo procedurë kërkon një afat minimal kohor prej 60 ditësh, që në limit kohor në të cilat në ndodhemi është e paaplikueshme.

Për arsyet si më lart shpjeguar, si dhe në referim të përcaktimeve të legjislativës për prokurimin publik, për përcaktimin e procedurës prokuruese për realizimin e secilit nga



**23 i Vendimit Data 28.12.2012 e Vendimit Ora 00:00 e Vendimit**

Për përcaktimin e procedurës prokuruese që do të përdoret për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet SEN dhe SEV, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

projektet (SEN dhe SEV) jemi në kushtet e parashikuar nga neni 32 pika 1/b i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku shprehimisht përcaktohet se kur "natyra e punëve, mallrave ose shërbimeve, apo rreziku i dëhur me to nuk lejon përcaktimin paraprak të çmimit të plotë" nga autoriteti kontraktor përdoret "Procedurë me negociim, me botim paraprak të njoftimit të kontratës".

Për mundësinë e realizimit e prokurimit të dy projekteve SEN dhe SEV me "Procedurë me negociim, me botim paraprak të njoftimit të kontratës" është kontaktuar dhe janë zhvilluar takime me ekspertë të Agjencisë së Prokurimit Publik, si organi shtetëror i specializuar. **Procedura me negociim, me botim paraprak të njoftimit të kontratës**, duke ndjekur fazat dhe afatet e përcaktuara në VKM nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", në çdo rrethanë, kontrata nuk mund të lidhet para datës 26.02.2013. Ky parashkrim vlen vetëm në rast se nuk do të ketë asnjë ankese gjatë zhvillimit të procedurës, ankësë e cila detyrimisht sjell shtyrje apo pezullim afatesh.

Kodit Zgjedhor, në përcaktimet e bëra në shtojcat II dhe III të tij, përcakton afate kohore për testimin paraprak të sistemeve.

KQZ, e detyruar të realizojë këtë detyrim ligjor në një afat shumë të ngushtë kohor, ndodhet në kushtet e nevojës ekstreme. Kjo situatë, e parashikuar në nenin 33 pika 2/c e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe në Kreun IV, pika 5 të VKM nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, i lejon dhe i mundëson autoritetit kontraktor të gjandur në kushtet e nevojës ekstreme përdorimin e procedurës "procedurë me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës". Por edhe në rast të përzgjedhjes së kësaj procedure, KQZ-ja është në kushtet e pamundësisë së logaritjes së fondit limit.

**Procedura "negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës"** sipas përcaktimeve në VKM nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" mundëson lidhjen e kontratës brenda datës 26.01.2013.

**PËR KËTO ARSYË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në Nenin 23, pika 1/a, nenin 179/1 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Nenin 12, pika 1, pika 2/ë, nenin 29, pika 1/c, nenin 32, pika 1/b, nenin 33, pika 2/c, të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", Kreun IV, pika 4 dhe 5.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e procedurës me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, pa fond limit, që do të që do të përdoret për zgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë:

a. Projektin për numërimin dhe vlerësimin e votave nëpërmjet sistemit elektronik të numërimit (SEN); dhe



Nr 23 i Vendimit      Data 28.12.2012 e Vendimit      Ora 00.00 e Vendimit

Për përcaktimin e procedurës prokuruese që do të përdoret për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet SEN dhe SEV, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23-gershor 2013.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDOR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

7

b. Projektin për përdorimin e teknologjisë së verifikimit dhe regjistrimit të pjesëmarrjes së zgjedhëseve në ditën e votimit

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Lefterije	LLESHI (LUZI)-	Kryetare
Denar	BIBA-	Zv/Kryetar
Albana	SHTYLLA -	Anëtare
Hysen	OSMANAJ-	Anëtar
Ilirjan	MUHO-	Anëtar
Jani	JANI-	Anëtar
Vera	SHTJEFNI-	Anëtare

4



nr 23 i Vendimit    Data 28.12.2012 e Vendimit    Ora 00.00 e Vendimit

Për përcaktimin e procedurës prokuruese që du të përdoret për përzgjedhjen e shqiptarëve që do të realizojnë projektet SEN dhe SEV, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTARI AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

**Observacioni:**

Kodi Zgjedhor i miratuar në vitin 2012, për herë të parë parashikoi implementimin e dy projekteve pilote, numërimin dhe vlerësimin e votave nëpërmjet sistemit elektronik të numërimit (SEN) (shtojca II) dhe përdorimin e teknologjisë së verifikimit dhe regjistrimit të pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e votimit (SEV) (shtojca III).

Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2013, zbatimi i teknologjisë së informacionit fillon nëpërmjet një projekti pilot, si rregull në 20% të zgjedhësve dhe do të shtrihej në të gjithë territorin dy vjet nga fillimi i Planit të Veprimit.

Sipas Kodit Zgjedhor, 20% i territorit korrespondoi me qarkun Fier, ku do të zbatohet SEN dhe qarkun Tiranë ku do të zbatohet SEV.

Kodi Zgjedhor, u miratua më datë 19 korrik 2012 dhe hyri në fuqi më datë 1 shtator 2012.

Dispozitat kalimtare për masat për realizimin e teknologjisë së re informative në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013, përcaktuan afatet për disa procedura për realizimin e këtyre teknologjive. Përcaktimi i afateve në çdo rast kishte si referencë miratimin e ligjit.

Gjithashtu, Kodi Zgjedhor parashikoi riformatimin e KQZ-së, rregullat dhe afatet për emërimin e Anëtarëve dhe Kryetares së KQZ-së. Sipas këtyre dispozitave, KQZ-ja duhet të konstituohej më datë 17 shtator 2012. **Realisht KQZ-ja, sipas vendimeve të Kuvendit u konstitua më datë 21 tetor 2012, pra afërsisht një muaj e gjysëm me vonesë dhe rrjedhimisht filloi nga detyra një muaj e gjysëm me vonesë, që do të thotë shtyrje e afateve procedurale me një muaj e gjysëm.**

Në këtë rast sqarojmë se, një nga arsyet e rëndësishme për mosrespektimin e disa afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor, në shtojcën II dhe III të tij, për zbatimin e teknologjive, është fakti i vonesës në konstituimin e KQZ-së.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, nisur nga fakti se këto dy projekte ishin projekte pilote parashikonte në mënyrë të qartë dhe “dështimin” e tyre në disa faza të ndryshme të implementimit, por në asnjë rast nuk parashikonte dështimin e tyre si pasojë e pamundësisë së procedurave tenderuese. KQZ-ja duhet të përfundonte procedurat tenderuese dhe të lidhte kontratat përkatëse me operatorët fitues.

Nga analiza e raporteve të KQZ-së, të raporteve të Auditëve të KQZ-së, të raporteve të auditëve të jashtëm të partive politike, si dhe nga Vendimi nr.576, datë 17.06.2013 “Për zbatimin e numërimit me dorë të votave në zonën zgjedhore Qarku Fier”, Vendimit nr.589, datë 18.06.2013 “Për zbatimin e procedurave të identifikimit dhe regjistrimit të pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23.06.2013, në mënyrë manuale dhe mosaplikimin e teknologjisë elektronike për këtë qëllim SEV, në qarkun e Tiranës”, **asnjë prej këtyre teknologjive, nuk dështoi për shkak të afateve në procedurat tenderuese dhe zbatuese.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në të dy rastet arriti të kryente testimet e parashikuara në shtojcat e Kodit Zgjedhor për impelentimin e këtyre teknologjive.

Të dyja teknologjitë dështuan për shkaqet ligjore të parashikuara nga legjislatori në Kodin Zgjedhor, neni 21/2, pika 3 të tij, për shkak të cënimit të integritetit të zgjedhjeve. (Kjo çështje është e detajuar në pjesën 6 “Për sa i përket zbatimit të kontratës për projektin SEN” të këtyre prapësimeve).

Referuar konstatimeve Tuaja, në faqen 2, paragrafi 3, që lidhet me datat e nënshkrimit të kontratave, sqarojmë mënyrën e komunikimit me Institucionin e Avokaturës së Shtetit.

Kështu për operativitet, për faktin se koha në dispozicion ishte shumë e shkurtër, dhe për faktin se të dy kontratat SEN dhe SEV ishin të ngjashme, komunikimi me Avokaturën e Shtetit përveç se me shkresa ka qenë edhe në rrugë elektronike për të dyja kontratat.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Kjo metodë ishte efektive pasi në rastet e komenteve të dërguara nga Avokatura e Shtetit, KQZ-ja nuk humbiste kohë, deri në disa ditë nëpërmjet postës, por edhe implementimi i tyre bëhej menjëherë.

Kështu data 11.03.2013, ka mbetur në të gjitha rastet e komunikimit elektronik me Avokaturën e Shtetit në kokën e kontratës (SEN), kthyer elektronikisht nga Avokatura e Shtetit sëbashku me shkresën nr.384/1, datë 13.03.2013 me objekt; "Opinion mbi kontratën midis KQZ-së dhe ...". (bashkëlidhur praktika).

Në paragrafin e dytë të kësaj shkrese, Avokatura e Shtetit sugjeron komunikimin elektronik me metodën "track changes" dhe me komente.

Për kontratën SEV, nëpërmjet komunikimit elektronik e kryer nga Avokatura e Shtetit na u komunikua se ishin të njëjta opinionet duke qenë se kontratat ishin të ngjashme. Në këto kushte, KQZ-ja për të mos humbur kohë operoi menjëherë me lidhjen e kontratës së dytë SEV.

**Përgjigje e Grupit të Auditimit:**

*Afatet e kryerjes së provave janë afate ligjore.*

**Komunikimi me Avokaturën e Shtetit është i dokumentuar. Konstatimi i grupit të auditimit bazohet mbi dokumentacionin e mbajtur por njëkohësisht dhe vetë vërejtjet e Avokaturës së Shtetit nuk janë marrë parasysh nga KQZ . Pikërisht për këtë mendojmë se duhej të jepeshin shpjegime nga observuesit.**

**Observacioni:**

Lidhur me opinionin Tuaj të shprehur në faqen 3, paragrafi 1, sqarojmë se:

Pikërisht, për këto dy projekte legjislatori me ligjin nr.131, datë 27.12.2012, vetëm një ditë përpara vendimmarrjes së KQZ-së, Vendimit nr.23, datë 28.12.2012, ndryshoi Ligjin për "Prokurimin Publik" dhe konkretisht nenin 4 dhe nenin 6 të tij.

Neni 6, i këtij ligji, i ndryshuar, parashikon se; "Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike në rast se zbatimi i tyre kërkon masa të veçanta sigurie në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interes thelbësor të shtetit". (referencë ligjore e përdorur në dy Urdhërat e Prokurimit për SEN dhe SEV, të cilat janë bashkëlidhur)

Në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk ka pasur asnjë risk të shtuar për dështimin e tyre. Kontratat kanë në anekset e tyre të detajuar çdo veprim zbatimi dhe kohën e kryerjes së tyre. Detajimi i veprimeve siguron realizimin e kontratës deri në ditën e zgjedhjeve.

KQZ-ja, nuk mund të parashikonte në datën e lidhjes së kontratës numrin e subjekteve që do të merrnin pjesë në zgjedhje. Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, nenet 67, 68, 69, 71, 72, 73, afati përfundimtar i regjistrimit të partive politike pa përfshirë ankimet përfundonte 40 ditë para datës së zgjedhjeve.

KQZ, në përfundim të afateve të ankimit me Vendimin nr.442, datë 20.05.2013 "Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 Qershor 2013, miratoi përmbajtjen e fletës së votimit për zonën zgjedhore qarku Fier, e cila përmbante 67 subjekte, vetëm 32 ditë para datës së zgjedhjeve.

**Në lidhje me pagesat**

Në lidhje me këtë opinion dhe në çdo opinion tjetër të procesverbalit nr.2, nuk gjejmë nga ana e audituesve referenca ligjore të cilat janë shkelur nga ana e KQZ-së apo nuk janë zbatuar nga kjo e fundit në lidhje me grafikun e pagesave për shërbimet e kërkuara.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

**Në cilën dispozitë të legjislacionit shqiptar është parashikuar ndalimi i pagesave për shërbime vetëm në rastin kur të ketë kaluar prova me sukses dhe jo pagesë me grafik?**  
(parashikuar në kontratat e KQZ)

Kodi Zgjedhor, në nenin 179/1, pika 6, faqe 96, parashikon përfundimin e procedurave për blerjen e shërbimit dhe/ose pajisjeve të SEN dhe SEV, me operatorë të mirënjohur që ofrojnë teknologji të provuara me sukses në fushat respektive. Kodi Zgjedhor, por dhe Ligji "Për Prokurimin Publik", nuk parashikojnë copëzim të fondit dhe prokurim pjesë-pjesë. Vetëm nëse do të prokurohej i copëzuar shërbimi mund të lidheshin dhe kontrata të ndryshme një për realizimin e testimit dhe nëse do të dilte i suksesshëm testimi të prokurohej më vonë shërbimi final i sistemit elektronik të numërimit të votave dhe verifikimit të pjesëmarrjes së zgjedhësve.

KQZ-ja, ka prokuruar shërbimin si një të tërë, realizimi i të cilit ka disa faza. Sistemi në vetvete është shumë kompleks, përbëhet nga programi (soft-i) dhe pajisjet hardëer (scannerat). Referuar Kodit Zgjedhor neni 179/1, pika 6, faqe 96, KQZ mund të zhvillonte si procedurë prokuruese dhe blerjen e pajisjeve dhe në këtë rast do të ishin blerë të gjitha pajisjet dhe përsëri sistemi elektronik nuk do të zbatohet.

Nga testimi i tregut në kohën e diskutimit të llojit të procedurës të tenderimit rezultoi se kostoja e blerjeve të pajisjeve ishte shumë më e lartë se shërbimi dhe nëse projektet nuk do të implementoheshin atëherë pajisjet do të dilnin jashtë përdorimit për shkak të amortizimit si fizik dhe moral, pasi pas 2 vjetëve teknologjia mund të rezultoj dhe më e mirë dhe më e lirë. Çdo fitues i rradhës nuk do të vinte në funksion shërbimin e tij me teknologji të një firme tjetër e të vjetëruar, pra do të ishim para një kostoje shumë herë më të lartë se ajo e aplikuar nga KQZ.

Referuar edhe një herë Ligjit "Për Prokurimin Publik", konkretisht Dokumenteve Standarte të Tenderit të përgatitur nga Agjensia e Prokurimit Publik, që kanë qenë pjesë edhe e dokumenteve standarte të këtyre procedurave prokuruese të zhvilluara nga KQZ-ja parashikohet në "Dokumentet Standarte të Tenderit Shërbime" (procedura e hapur)

#### **Neni 15 Afatet e Pagesës**

15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.

15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. **Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.** (gjë e cila është plotësuar nga KQZ dhe dokumentacioni gjendet ne dosjen e referuar prej Jush)

#### **Neni 25 Ndërprerja për shkak të Interesit Publik**

25.1 **Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.**

25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

25.3 **Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.**





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Të gjithë referencat ligjore të sipërpërmendura provojnë faktin se detyrimet kontraktuale dhe pagesat e lidhura me to, të parashikuar në kontratat SEN dhe SEV, kanë qenë konform parashikimit të legjislacionit shqiptar.

**Në lidhje me opinionin për marrjen me qera nga ana e shoqërisë “Indra” s.a, të pajisjeve që do të përdoren në qendrat e votimit apo gjatë numërimit, në fund të paragrafit Ju konstatojmë “...Këto pajisje do të ishin të nevojshme vetëm pas provës së suksesshme...”**

Ky konstatim Juaj është jo real, alogjik pasi gjykimi duhet bërë mbi momentin e lidhjes së kontratës, kohës së ngelur në dispozicion për gjetjen e tyre, transportin deri në Shqipëri, implementimin dhe përshtatjen me software-in e krijuar për këtë qëllim, pra me një fjalë për të bërë këto pajisje efektive dhe të përdorshme në funksion të realizimit të projekteve, detyrim ligjor të diktuar nga interesa thelbësore të shtetit. (sqaruar në faqen 2, paragrafi 2 dhe 3 të prapësimeve)

Gjithashtu, nuk duhet të harrojmë cilësitë teknike të këtyre pajisjeve (numëruesit elektronik të votave) të cilat nuk janë lehtësisht të gjendshme në treg, por do të prodhoheshin posaçërisht. Po ashtu, edhe laptopët dhe lexuesit e kartave ishin në një numër mjaft të madh (1400 copë) të cilat do të prodhoheshin dhe përshtateshin me programe të caktuara posaçërisht për zgjedhjet në Shqipëri.

Në rast se, këto pajisje do të porositeshin pas realizimit të provave përkatëse, siç konstatojmë Ju, me siguri që koha e mbetur në dispozicion nuk do të mjaftonte për ti sjellë ato apo për ti bërë efektive dhe të përdorshme dhe rrjedhimisht projektet do të dështonin.

Nuk duhet harruar fakti që në momentin e nënshkrimit të kontratave qëllimi dhe përpjekjet tona maksimale ishin në funksion të realizimit të projekteve.

Gjithashtu, referuar Seksionit 5, Shtojca II, faqe 100 e Kodit Zgjedhor, parashikohet dhe një testim tjetër në ditën e zgjedhjeve. Po sipas kësaj dispozite, KQZ mund të vendos zbatimin e numërimit me dorë dhe pas testimit aposteriori të SEN-it në ditën e zgjedhjeve.

Pra, sistemi quhet i suksesshëm pas suksesit të testeve apriori dhe aposteriori. Kështu që në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor, nuk parashikohet zbatimi i kontratës vetëm pas rezultateve pozitive të testimeve.

Nëse do të ndiqnim opinion tuaj që në faqen 3, paragrafi i dytë se ... *Në këto pagesa nga ana e KQZ-së, nuk është pasur parasysh fakti se ndodhemi përpara një kontrate shërbimi e cila në vetvete do të kërkonte që minimalisht të kryhen pagesa vetëm pasi të ketë kaluar me sukses prova në lidhje me të dy projektet veç e veç. Në të kundërt, kjo dispozitë e kontratës parashikon pagesa edhe për pajisjet e marra me qira nga kontraktori të cilat kanë të bëjnë për të gjitha qendrat e votimit për SEV-in dhe SEN-in, kur nuk dihej nëse prova për këto do të ishte e suksesshme apo jo. Këto pajisje ishin të nevojshme vetëm pas provës me sukses.....*, pra KQZ duhet të priste rezultatin me sukses të testimeve.

Nëse do të ecnim me arsyetimin Tuaj, lindin pyetjet:

-Po për testin e ditës së zgjedhjeve si do të procedonim?

-Duhet të prisnim rezultatet pozitive nga testi në ditën e zgjedhjeve, pastaj kontraktori të kryente procedurat për sigurimin e pajisjeve që do të zhvillojnë sistemin elektronik ???

Pikërisht, për të mos u ndodhur përpara ngjarjeve të tilla, në kontratë janë parashikuar afate optimale për sigurimin e tyre referuar kushteve normale të tregut si dhe kërkesave dhe nevojave që kishte shoqëria “Indra” s.a, për ti siguruar ato.

*Në lidhje me opinionin Tuaj në paragrafin e 1, të faqes 6, të procesverbalit nr.2 në të cilin Ju konstatojmë: “Shuma e paguar padrejtësisht, nga parashikimi i gabuar në kontratë, për të dy projektet është në vlerën: 1,744,820 Euro e cila përbënë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit për faktin se këto pajisje as nuk kanë lëvizur nga furnitori (mungon dokumentacioni i regjimit të përkohshëm sipas Kodit Doganor) përgjegjësi kjo e Autoritetit Kontraktor.”*



KONTROLLI I LARTË I SHQETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Ky konstatim Juaji, në rastin më të mirë është joprofesional. Kjo për arsye se Ju, në cilësinë e përfaqësuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit edhe pse i kishit të gjitha mundësitë nuk bëtë as përpjekjen më të vogël për të provuar faktin nëse këto pajisje kanë lëvizur nga furnitori, por u mjaftuat me konstatimin e faktit se mungon dokumentacioni i regjimit të përkohshëm doganor e për rrjedhojë e gjithë shuma e parashikuar në kontratën për furnizimin e pajisjeve (1,744, 820 Euro) sipas Jush përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Ju bëjmë me dije se KQZ nuk kishte asnjë detyrim ligjor, për të administruar dokumentacionin e regjimit doganor.

Megjithatë, pas konstatimit Tuaj KQZ kontaktoi shoqërinë “ ” sh.p.k, si përfaqësues tatimor i “ ” s.a në Shqipëri dhe Agjensinë doganore “Alba Shipping” sh.p.k, me seli në Durrës e cila ka kryer veprimet doganore për regjimin e përkohshëm të pajisjeve të lëvuara nga “ ”, nga ato përsa i përket regjimit të përkohshëm të pajisjeve të sjella nga ‘

Sipas tyre i gjithë ky dokumentacion ekziston pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe mund të verifikohet fare lehte nga Ju, përpara se të shpreheshit për këto opinione. Në një kohë shumë të shkurtër, në rrugë jo zyrtarë si çdo qytetar që mund të marrë informacion publik arritëm të siguronim një pjesë shumë të vogël të dokumentacionit voluminoz që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për këtë çështje. (bashkëlidhur kopje e tyre

Në këto kushte, përsa kemi shpjeguar më lart, rezulton se konstatimi:

“... shuma 1.744.820 euro është paguar padrejtësisht, nga parashikimi i gabuar në kontratë ..... është konstatim i pa bazuar në asnjë dispozitë ligjore as për sa i përket ...paguar padrejtësisht.... As për sa i përket ..parashikim i gabuar në kontratë e për rrjedhojë konstatimi Juaj për ekzistencën e dëmit ekonomik prej 1,744, 820 Euro është i pasaktë dhe nuk qëndron.

#### **Përgjigje e Grupit të Auditimit:**

Në lidhje me këtë pjesë të observimit konstatojmë se, jemi përpara justifikimesh për veprime të bëra për pagesa në zbatim të kontratave. Sigurisht, por nga ana e KLSH ngrihet pretendimi për hartimin e keq të këtyre kontratave. Njëkohësisht në observacion konstatohet se **personat nuk e konsiderojnë një interes publik, as sot , faktin që në një kontratë administrative ku kërkohet shërbimi i caktuar për KQZ duhej të kishte përparësi marrja e sigurimi me sukses i këtij shërbimi dhe jo pagesa e justifikimi i kompanisë.** Njëkohësisht përsa i përket detyrimit të KQZ për të pasur listën e faturat e doganës për mjetet trajtohet në pjesën e observimit të z. si i caktuar si supervisor në këto dy Projekte por që në kontratë gjendet termi përgjegjës projekti si dhe zotëria paraqet materiale ku nënshkruan si Drejtor Projekti.

Si e thonë dhe observuesit kuptohet se materialet pajisjet janë individualsht të përcaktuara dhe jo fatura për materiale rifurxho. E pa pranueshme që faturat dhe inventari i këtyre materialeve që do të përdreshin për zbatimin e projekteve të prokuruar nga KQZ dhe të cilat paguheshin nga KQZ por dhe që pretendoheshin se do të duhej të pastroheshin në përfundim nga të dhënat e shtetasve janë pa asnjë inventar por rifurxho dhe këto fatura ju ngarkokën KLSH për ti gjetur. Kjo është e pa pranueshme.

**Në këto kushte nga ana jonë nuk merret parasysh observacioni përsa i përket hartimit të kontratave, ( konstatim ky dhe i Avokaturës së Shtetit) ashtu dhe të lidhjes në një kohë që ishte parashikuar si e pa mjaftueshme nga vetë KQZ, ashtu dhe përsa i përket supervizimit të tyre në fazën e zbatimit, por dhe të pagesave për shërbime të pa dokumentuara. Në këtë pikë nuk është ngarkuar KQZ me inegritetin e Kartave të**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Identitetit dhe Pasaportave përsa i përket leximit të Chipave me dhe pa kontakt si detyrim ligjor dhe objekt i projektit SEV pasi një gjë e tillë i takon Ministrisë së Brendshme që ka pasur përfaqësuesin e tij në fazën e prokurimit.

**Të njëjtat observime pretendohen dhe në takimin përmbyllës të datës 01.06.2016 pas Projektraportit të Auditimit.**  
**Theksojmë se: KQZ duhej të kishte një kontroll (supervizim) kompetent në lidhje me zbatimin e projektit SEV që gjatë fazës së provave.**  
**Përsa i përket raporteve të audituesve teknicien ato trajtohen në fillim të kësaj pike (VI.2).**

**Observimi: PËR PROJEKTIN SEN**

**Vendimi për miratimin e modelit të fletës së votimit**

**Në lidhje me opinionin Tuaj në faqen 7, për zbatimin e kontratës për projektin SEN, sqarojmë si më poshtë:**

Modeli i fletës së votimit për qarkun Fier, u miratua nga KQZ-ja me vendimin nr.175, datë 08.03.2013 "Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të fletës së votimit për zonën zgjedhore, qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2013". (bashkëlidhur vendimi).

Referuar nenit 2, pika 7; neni 21, pika 1; neni 23, pika 1 të Kodit Zgjedhor, autoriteti i vetëm për kontrollin, menaxhimin dhe drejtimin e zgjedhjeve është KQZ-ja. (Në çdo vendim të KQZ-së, është i përcaktuar referenca ligjore, në rubrikën *Baza Ligjore*).

Mendojme se, konstatimi Juaj se KQZ-ja ka miratuar 2 alternativa të fletës së votimit me 42 dhe 66 subjekte është lapsus, pasi referuar të njëjtit vendim të KQZ-së, nr.175, datë 08.03.2013, KQZ ka vendosur:

- 1. Miratimin e fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin 2013, sipas modelit bashkëlidhur.**
- 2. Miratimin e specifikimeve të fletës së votimit për zonën zgjedhore qarku Fier.**
- 3. Rishikimin e modelit dhe specifikimeve të fletës së votimit për zonën zgjedhore, qarku Fier, nëse do të lindte e nevojshme pas zhvillimit të provës së plotë në lidhje me funksionimin e SEN-it.**

Modeli bashkëlidhur i vendimit është vetëm 1 (një), orientim "portret" dhe me 42 subjekte.

**Përsa më sipër përgjegjësia e personave të përmendur nuk ekziston**

Referuar arsyetimit tuaj në lidhje me përmbajtjen e Vendimit nr. 175, KQZ u bazua:

1- Në praktikën 13 vjeçare të administrimit të zgjedhjeve nga KQZ-ja, numri i subjekteve në fletën e votimit gjatë 13 vjetëve, nuk e kishte kaluar asnjëherë shifrën 36. Trendi rritës i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, nga një zgjedhje në tjetrën, ishte 4-5 subjekte. (viti 2001-28 subjekte, viti 2005-32 subjekte, viti 2009-36 subjekte)

2- Në mendimin, propozimin dhe kërkesën e vendosur të partive politike, sipas tyre orientimi "portret", me ato përmasa dhe elemente, ishte thelbësor pasi siguronte që vullneti i zgjedhësve nuk do të deformatohej. Sipas partive, parimi kryesor në një shtet demokratik, i sanksionuar dhe në Kushtetutë është e drejta e votës, e lirë, e pavarur dhe e barabartë. Zgjedhësve të qarkut Fier duhej t'u sigurohen, kushte sa më të përafërta më të gjithë qytetarët e tjerë të Shqipërisë në procesin zgjedhor dhe tu garantohej se shprehja e vullnetit të tyre nuk do të deformatohej, si pasojë e një flete votimi me një format të ndryshëm nga praktika e deritanishme.



**KONTROLLI I LARTË SHTETËR**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

Në këto kushte, KQZ si institucioni i cili është garanti i parimeve kushtetuese dhe ligjore, organi më i lartë shtetëror i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, miratoi një model flete votimi e cila përmbante formatin A3 me orientim "portret", deri në 42 subjekte. Për qarkun Fier, KQZ miratoi një model flete votimi i cili do të përshtatej zbatimit të teknologjive.

**Konstatimi Juaj në faqen 7 dhe 8, se mënyra e palosjes së fletës së votimit, do të ndikonte në marzhin e gabimit 0,5 % nuk qëndron përta vijon:**

- Modeli i fletës së votimit apo palosja nuk ka asnjë lidhje me gabimin e mundshëm 0.5% të nxjerrë nga testimi aposteriori, referuar seksionit 5, Shtojca II, faqe 100 të Kodit Zgjedhor. Fletët e votimit të palosura gabim, sistemi elektronik nuk mund të numëronte për faktin se kishin më shumë se një shenjë.
- Palosja e gabuar e bënte fletën e votimit të pavlerësuar nga sistemi dhe si e tillë i nënshtrohej vlerësimit nga KZAZ-ja.
- Referuar dispozitës së sipërcituar gabimi me marzh 0.5%, del nga krahasimi i numërimit me dorë dhe me sistemin elektronik të fletëve të votimit të vlerësuar nga sistemi elektronik për 4 qendrat e para të votimit dhe jo sipas arsytimit tuaj I cili nuk qëndron dhe është i pasaktë.

**Realizimi i testimit apriori**

**Opinionet tuaja në faqen 8, paragrafi 2 e në vazhdim të procesverbalit në lidhje me realizimin e testimit apriori janë të pavërteta.** Edhe pse aty pretendohet se nga z [ ] me detyrë ish-Drejtor Projekti, nuk iu dha juve asnjë dokumentacion, KQZ ju ka vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin në lidhje me dy projektet teknologjike, ku pjesë e tij kanë qenë edhe dokumentacioni sa vijon;

1. Vendimi nr.182, datë 02.04.2013 "Për miratimin e procedurave që do të ndiqen për plotësimin e fletëve të votimit (fletë votimi test) që do të përdoren gjatë testimit paraprak të SEN-it.
2. Raporti "Për realizimin e provës të datës 13 Prill, në lidhje me funksionimin e sistemit elektronik të numërimit".
3. Procesverbali i mbledhjes së KQZ-së datë 17.05.2013.
4. Shkresa nr.4544 Prot., datë 20.05.2013 e KQZ-së, me të cilën në zbatim të detyrimeve ligjore ja ka dërguar raportin kompanisë "

**Në lidhje me përgatitjen paraprake të testit,** KQZ me vendimin nr.182, datë 02.04.2013 (pra 11 ditë përpara datës së testimit) ka përcaktuar sasinë ( 6000 copë), fletën e votimit të cilat do të përdoren në testim, dhe metodologjinë e plotësimit të tyre.

I gjithë ky dokumentacion i sipërcituar në vendimin e KQZ-së, provon faktin e përgatitjeve dhe realizimit në mënyrë të detajuar të provës së parë të numërimit përta i përket projektit SEN, të realizuar në seancë publike në shkollën "Hasan Prishtina" më datë 13 prill 2013. Gjithashtu, mjafton të klikosh/kërkosh në faqen e internetit në formë të lirë dhe mund të shikoni lajmet për organizimin dhe realizimin e këtij testi, pasi gjithçka është bërë nën monitorimin e organizatave ndërkombëtare, mediave, përfaqësuesve të shoqërive civile dhe përfaqësuesve të partive politike.

Në përfundim të këtij testimi referuar pikës 1, seksioni 3, Shtojca II, faqja 99 e Kodit Zgjedhor, Administrata e KQZ ka përpiluar raportin në lidhje me "Realizimin e provës së datës 13 Prill, në lidhje me funksionimin e sistemit elektronik të numërimit" dhe këtë raport e ka prezantuar në mbledhjen publike të datës 17 maj 2013, të KQZ-së.

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen publike të datës 17 maj 2013, miratoi raportin dhe vendosi t'ia dërgoj kompanisë "** për tu njohur me të dhe për të riparuar disa mangësi teknike. (bashkëlidhur dokumentacioni; 1-Raporti, 2-procesverbali i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

mbledhjes së KQZ-së datë 17.05.2013, 3- shkresa nr.4544 Prot., datë 20.05.2013 e KQZ-së, me të cilën në zbatim të detyrimeve ligjore ia ka dërguar raportin kompanisë “... ”.

Në raportin e KQZ-së, referuar kushteve të kontratës janë të specifikuara në mënyrë të hollësishme procedurat e ndjekura në testim ku janë evidentuar pajisjet e përdorura nga kompania, sasia e fletëve të votimit, të printuara dhe të përdorura në testim, numri i subjekteve në fletën e votimit, qendrat e votimit të simuluar, rezultati i numërimit të simuluar, numri i punonjësve të kompanisë i angazhuar në testim, planvendosja e dhomës ku u zhvillua testimi etj.

I gjithë ky dokumentacion i sipërcituar provon faktin e përgatitjeve dhe realizimit në mënyrë të detajuar të provës së parë të numërimit përsa i përket projektit SEN, të realizuar në seancë publike në shkollën “Hasan Prishtina”, më datë 13 prill 2013.

Ky testim ishte proces transparent dhe u realizua nën monitorimin e organizatave ndërkombëtare, medias, shoqërisë civile, përfaqësuesve të partive politike. Procesi i testimit i filmuar gjendet shumë lehtë po të kërkohet në internet, pasi media e ka pasqyruar në çdo edicion informativë të datës 13-14 prill 2013, si dhe në median e shkruar të atyre ditëve.

Gjithashtu, pamjet filmike dhe fotografike në lidhje me zhvillimin e testeve gjenden edhe në Protokoll-Arkivën e KQZ-së.

Në përfundim të testimit raporti i KQZ-së, me gjithë ose ndonjë aspekt teknik të evidentuar konkludoi se testimi përgjithësisht plotësoi pritshmëritë e përcaktuara në Kodin Zgjedhor në këtë proces.

Sipas pikës 1, seksioni 3, Shtojca II, faqe 99 të Kodit Zgjedhor është kompetencë e KQZ-së hartimi i raportit dhe vlerësimi i suksesshëm ose jo i testimit dhe jo raportet e partive politike të cilat ju i keni referuar.

**Përsa më sipër edhe konstatimi Juaj në paragrafin 4, të faqes 8, të procesverbalit nr.2 (likujdimin e faturës me vlerën 414, 322.5 Euro, si dëm ekonomik) nuk qëndron.**

Rezultoi i sqaruar dhe më lart se Urdhëri i shpenzimit nr.201, datë 22.05.2013, me vlerën 414, 332.2 Euro është bërë pas miratimit të raportit përfundimtar të testimit nga KQZ-ja, ku testi rezultoi i realizuar.

Në këto kushte, opinionet tuaja në lidhje me likujdimin e faturës me vlerën 414, 322.5 Euro, si dëm ekonomik është i gabuar.

Vendimi i KQZ-së nr.576, datë 17.06.2013 “Për zbatimin e numërimit me dorë në zonën zgjedhore qarku Fier”

Në lidhje me opinionin tuaj në faqen 9, të procesverbalit paragrafi 2,3 sqarojmë se:

Pas regjistrimit të partive politike si subjekte pjesëmarrëse në zgjedhje, në datën 20 maj 2013, fleta e votimit në zonën zgjedhore, qarku Fier rezultoi me 67 subjekte.

Kjo fletë votimi sikurse e kemi cituar më sipër në këto prapësime i kalonte përmasat e mundëshme të një formati të lexueshëm dhe të numërueshëm elektronikisht. Një format me përmasa më të mëdha se A3, është teknikisht i palexueshëm në kohë të shpejtë nga skanerat optik.

Në këto kushte, me vendimin nr.576, datë 17.06.2013, KQZ vendosi: **“Zbatimin e numërimit me dorë në zonën zgjedhore qarku Fier.”** (në pjesën arsyetuese të këtij vendimi dhe konkretisht në faqen 3, të saj rreshti 4,5,6 citohet se: **“Kontrata me shoqërinë “... ” me objekt realizimin e projektit të sistemit elektronik të numërimit në zonën zgjedhore, qarku Fier, në mbështetje të rubrikës 9, pika d dhe e, e saj përfundon në mënyrë të parakohshme”.**

Kjo vendimmarrje erdhi si rezultat i vendimit të KQZ-së, nr.175, datë 08.03.2013 **“Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të fletës së votimit për zonën zgjedhore, qarku Fier, i cili vendosi për fletën e votimit me orientim “portret”, me arsyetimin se “Shprehja e saktë e vullnetit të zgjedhësve është parimi kryesor që garanton integritetin e zgjedhjeve”.**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

**Përsa më lart, në zbatim të të gjithë referimeve ligjore është vërtetuar fakti që:** Asnjë nga personat e cituar nuk ka asnjë përgjegjësi të shkaktimit të dëmit ekonomik, pasi çdo veprim në lidhje me zbatimin e kontratave, nr.26/22 prot, datë 16.03.2013, dhe nr.25/29 prot, datë 25.03.2013 është bërë në zbatim të Kodit Zgjedhor (shtojca II dhe Shtojca III) të Ligjit “Për Prokurimin Publik”, dhe në zbatim të vendimeve të KQZ-së, të poshtëshënuara (bashkëlidhur)

- 1- Vendimin e KQZ-së, nr.23, datë 28.12.2012 “Miratimi i procedurës prokuruese që do të përdoret për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet teknologjike SEN dhe SEV, që do të aplikohen në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 Qershor 2013”.
- 2- Vendimin nr.175, datë 08.03.2013 “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të fletës së votimit për zonën zgjedhore, qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 Qershor 2013”.
- 3- Vendimi nr.182, datë 02.04.2013 “Per miratimin e procedurave që do të ndiqen për plotësimin e fletëve të votimit (fletë votimi test) që do të përdoren gjatë testimit paraprak të SEN.
- 4- Vendimi nr.442, datë 20.05.2013 “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 Qershor 2013” për zonën zgjedhore qarku Fier.
- 5- Vendimi nr.576, datë 17.06.2013 “Për zbatimin e numërimit me dorë në zonën zgjedhore qarku Fier”.
- 6- Vendimi nr.589, datë 18.06.2013 “Për zbatimin e procedurave të identifikimit dhe regjistrimit të pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 Qershor 2013, në mënyrë manuale dhe mos aplikimin e teknologjisë elektronike për këtë qëllim SEV, në qarkun e Tiranës”.

**Në përfundim sqarojmë:**

Kodi Zgjedhor, të dy projektet elektronike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013, i ka përcaktuar si projekte pilote, të cilat do të testonin mundësin e përdorimit të tyre në këto zgjedhje apo dhe në të ardhmen. Për këtë arsye, Kodi Zgjedhor ka parashikuar kompetencën e KQZ-së, për të vendosur numërimin me dorë të votave në çdo fazë të procesit dhe vendimmarrja në këtë rast është me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të KQZ-së.

Sipas nenit 21/1, pika 3 të Kodit Zgjedhor, në rastet e defekteve teknike që çënojnë integritetin e teknologjisë që aplikohet apo që e bëjnë zbatimin e tyre të pamundur në zgjedhje, KQZ-ja mund të vendosë zbatimin e votimit ose numërimit me dorë, sipas këtij Kodi.

**Personat të cilët ju ngarkoni me përgjegjësi për shkaktim të dëmit ekonomik, në çdo rast kanë zbatuar vendimet e KQZ-së dhe legjislacionin në fuqi. Nuk ka asnjë veprim/mosveprim apo vendimarrje nga ana e personave të cituar në procesverbal, të cilët të kenë ndikuar në zbatimin apo dështimin e teknologjive elektronike.**

**Duke shpresuar se, të gjitha prapësimet tona do të merren në konsideratë nga ana Juaj,**

**Përgjigje e Grupit të Auditimit:**

*Edhe për këtë pjesë të observimeve janë të ngjashme kontratat dhe difektet e tyre në parashikime dhe zbatim si dhe në afatin kur është lidhur kjo kontratë që ka të bëjë me riskun e shtuar të dështimit. Gjithashtu dhe supervizimi teknik i këtij projekti ku theksojmë se: Raporti i paraqitur bashkëlidhur observacionit, por që grupi i auditimit e dispononte gjatë auditimit, nuk është konsideruar dokumentacion i rregullt nga ana jonë për arsyen e thjeshtë se ai është një dokumentacion që është i pa nënshkruar nga hartuesit dhe i tillë është në dosjet e disponuara dhe nga Prokuroria. Përsa i përket materialeve për realizimin e këtij*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

*projekti asnjë person as sot nuk mund të tregoj se çfar makinerie ka ardhur në shqipëri me çfar matrikulli dhe sa në sasi. Sigurisht nga KQZ pretendohet se nuk ka qenë punë e tyre por duhej ti kërkonte KLSH. Për këto arsye dhe përse trajtohet në këtë material dhe në procesverbal këto observime nuk merren parasysh. Këtu nuk është fjala për pjesët përshkruese të procedurave në këto observime.*

**Observacionet në lidhje me Projektraportin e Auditimit dhe ato të takimit përmbyllës të datës 01.06.2016 vazhdojnë të jenë të njëjtat.**

**Pranohet në takimin përmbyllës nga personat se Raporti i SEN qarkut Fier është i pa firmosur por që ai është i hartuar nga ata. Gjithashtu u pretendua se: ...përveç asaj ka Raporte të Audituesve teknicienë të emërtuar nga KQZ dhe mjafton ti referoheni atyre dhe mos ti referoheni fare Raportit tonë. Për këtë qëllim u paraqitën raportet më datë 03.06.2016 në KLSH.**

**Konstatimi KLSH:**

**Këto raporte nuk kanë të bëjnë me Projektin SEN por atë SEV të Qarkut Tiranë. Gjë që është trajtuar dhe në fillim të kësaj pike.**

**Është e vërtetë dhe pranohet observimi se miratimi i fletës së votimit ka qenë me 42 subjekte në formatin portret në Vendimin e KQZ nr.175, datë 08.03.2013. Nga KLSH formati me 66 subjekte është përmendur si një mundësi e pranuar nga kontraktori por në të dy rastet mënyra e palosjes së fletës së votimit është e modelit në treshë. Kjo gjë është e dokumentuar dhe në provën e realizuar për këtë qëllim. Pra problematika me mënyrën e palosjes është e njëjtë dhe do të sillte të njëjtin efekt gabimi për numërimin nga makineria.**

**Dëmi ekonomik i konstatuar nga KLSH për këto dy Projekte (SEV dhe SEN ) ka ardhur si pasojë e kontratave të hartuara me kushte favorizuese për kontraktin (konstatim ky dhe i Avokaturës së Shtetit) si dhe se këto kontrata në zbatim të vetë Vendimit të KQZ nr.23, datë 28.12.2012 (nëqoftëse ajo do të zbatohet rigorozisht) nuk duhej të lidheshin për të cilën është ngarkuar me përgjegjësi nënshkruesja e këtyre kontratave zni. \_\_\_\_\_, duke sjellë një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën prej: 2,563,349.5 EURO e cila është paguar në favor të kompanisë INDRA Sistemas S.A.**

**Këto kontrata kanë parashikuar grafik pagesash duke mos u lidhur me qëllimin final realizimin e shërbimit.**

**Observacion ka paraqitur dhe z. \_\_\_\_\_ me shkresën e tij të datës 30.03.2016 e protokolluar në KLSH me nr. 1131/8 datë 01.04.2016. Observuesi vazhdon të kundërshtoj faktin se nuk ka qenë Drejtor Projekti. Por citon se autorizimi i KQZ me shkresën nr. 25/28 datë 25.03.2013 e ka caktuar në pozicionin e supervizorit. Ky observim nuk pranohet për arsyen se dhe nga ana e Grupit të Auditimit është cituar pikërisht ky autorizim dhe detyra e tij si supervizor për ndjekjen e zbatimit të këtyre dy kontratave. Fakti i përdorimit të emërtimit si Drejtues Projekti nuk është një term i vendosur nga KLSH por nga gjithë korenspondenca që Observuesi ka në këtë proces ku dhe vetë personalisht firmos poshtë një titulli të tillë. Nuk kuptohet sesi observuesi bën observacion ndaj grupit të auditimit për përdorimin e këtij termi dhe në observacion pretendon se: *"..deklarimet tuaja që synojnë të më ngarkojnë me detyrën e Drejtorit të Projektit janë tërësisht të pasakta"*.**

**Ky observacion nuk merret parasysh pasi nga ana e Grupit të auditimit ndaj personit është kërkuar zbatim i detyrës në cilësinë e supervizorit të këtyre dy projekteve ( SEN dhe SEV)**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

dhe termi Drejtor i Projektit nuk ka të bëjë me ndryshim të punëve të ngarkuara. Ndërsa përsa i përket termit mjafton të shohësh korendimentin që vetë observuesi ka nënshkruar. Çuditërisht vetë observuesi në observimin e tij paraqet bashkalidhur një shkresë të datës 10.04.2013 ku z. (observuesi) nënshkruan vetë në cilësinë "Drejtori i Projektit të KQZ". (*Kjo gjë nuk ka të bëjë me memorien e pretenduar nga observuesi*). Përsa i përket observimit se çfarë dispozite ligjore ka shkelur observuesi, observacioni nuk merret parasysh për arsye se sipas të dy kontratave të lidhura nga KQZ për projektet "SEV" dhe "SEN" të cilat janë të ngjashme perdoren termit supervisor i kontratës neni 3 germa "e" e kontratës SEV neni 4 germa "e" e kontratës SEN përdoret termi: "menaxheri i projektit" në nenin 7 "detyrimet e palëve" germa "b" pika "ii", në të dy kontratat, ku citohet: "*KQZ merr përsipër të: emëroj një përgjegjës projekt me autoritet të mjaftueshëm që të marrë vendime në këtë projekt*". Kontratat kanë fuqinë e ligjit në bazë të nenit 690 të Kodit Civil ku citohet: "*Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët*". Supervisor apo menaxheri i projektit për KQZ apo dhe Drejtori i Projektit si faktikisht është nënshkruar dokumentacioni i përdorur në këto projekte kanë të njëjtën detyrë supervizionin e të gjithë procedurave për realizimin e këtyre projekteve duke dokumentuar garantimin, në këtë rast mjaft teknik, të realizimit të qëllimit për të cilën janë lidhur këto kontrata. Pikërisht në lidhje me këtë detyrë nga ana e z. nuk mundi dhe as ishte në dijeni se si duhej të vepronte dhe as që e kishte idenë e chip-ave të kartës ID.

Gjithashtu nuk disponohet asnjë dokumentacion mbi materialet e hyra në doganë për realizimin e projekteve. Në observacione i kërkohet llogari grupit të auditimit që këto dokumenta ti kërkonte në doganë duke harruar faktin se materialet si laptop apo pajisjet e numërimit apo të leximit janë pajisjet për të cilat paguan dhe ka paguar qiranë KQZ dhe këto pajisje janë individualisht të përcaktuara pasi në çdo rast kanë numer identifikimi të cilat duhej të ishin të listuara dhe jo ti paraqitet KLSH, me observacione, nga Kryetarja e KQZ fatura doganore me regjim të përkohshëm për materiale rifurxho!!.

**Në lidhje me observimet për Projektraportin nga z. janë bërë observacione me shkresën e datës 17.05.2016 protokolluar në KLSH me nr. 1131/12 datë 17.05.2016. Këto observacione janë pothuaj të njëjta me ato në lidhje me procesverbalin e mbajtur. Ato kanë gjithmonë justifikimin për ta quajtur vehten vetëm Supervisor duke luajtur me termit e përdorur në kontrata nga keqhartimi tyre. Të njëjtën qëndrim mbajti personi dhe në takimin Përmbyllës të datës 01.06.2016 në ambientet e KLSH ku ai ishte pjesëmarrës. Mund të theksojmë se mjafton observacioni i z. për të konstatuar se kontratat janë hartuar pa nivelin e kërkuar duke i dhënë të drejtë si Avokaturës së Shtetit në konkluzionet e saj por dhe KLSH. Gjë kjo me të cilën është ngarkuar me përgjegjësi të drejtpërdrejtë Kryetarja e KQZ si nënshkruësja e tyre.**

**Në lidhje me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të KLSH me nr. 1131/5 datë 21.03.2016 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme u kthye përgjigje me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme (nënshkruar: "me urdhër e porosi z. ") me nr. 1921 prot datë 25.03.2016 (e me nr. 1131/6 prot. datë 31.03.2016 të KLSH).**

Në këtë shkresë pyetjeve tona të bëra Ministria e Brendshme i përgjigjet si më poshtë:  
**Pyetja 1.** Sa Chip-a përmban karta e identitetit dhe pasaporta biometrike e shtetasve shqiptar?





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

**Pyetja 2.** Nëse janë dy Chip-a çfarë informacioni kanë për mbajtësit e tyre?

**Përgjigja:**

*-Letërnjoftimi elektronik (Karta identitetit) përmban dy chipa, një me kontakt dhe një pa kontakt.*

*Informacioni që përmbahet është i detajuar në dokumentin me nr. JAJ-13-0444 att. 2 të kompanisë (janë të dhënat alfanumerike të qytetarit dhe informacionet biometrike, gishtat, firma dhe foto. Në letërnjoftimin elektronik përmbahet dhe autoriteti lëshues dhe të dhënat e validitetit të dokumentit. Gjithashtu në vitin 2014 janë shtuar dhe certifikatat për autentifikim dhe firmë elektronike.*

*- Pasaporta ka vetëm një chip pa kontakt sipas standardit ICAO.*

*Informacioni që përmbahet janë të dhënat alfanumerike të shtetasve njësoj si në letërnjoftimin elektronik, si dhe informacionet biometrike, gishtat dhe foto. Gjithashtu përmbahet dhe autoriteti lëshues dhe të dhënat e validitetit të dokumentit.*

**Pyetja 3.** A janë chipa-at e kartave ID të lëshuara para vitit 2014 të lexueshme qoftë dhe nga pajisjet e prodhuesit të tyre?

**Përgjigje:**

*Chip-at e letërnjoftimit elektronik janë të lexueshme që nga fillimi i prodhimit të tyre në vitin 2009 sipas specifikimit të dhënë në mënyrë të detajuar në shkresën e dërguar nga kompania me nr. JAJ-13-0444 att.2.*

*Duke filluar që nga Janari 2014, letërnjoftimi elektronik përmban (ka të ngarkuara) certifikatat vetëm në Chipin me kontakt të nevojshme për përdorimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet platformës dhe të gjithë dokumentet e personalizuar para kësaj date mund ti kenë (ngarkojnë) këto certifikata shtesë, në momentin që kërkohet nga shtetasi në zyrat e aplikimit për dokumente identiteti (letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike)*

**Pyetja 4.** A ka Ministria e Brendshme apo ndonjë strukturë e saj aparaturat për leximin e chipit me kontakt apo pa kontakt?

**Përgjigje:**

*1. Pasaporta biometrike lexohet nëpërmjet chipit pa kontakt në çdo pikë kufitare të çdo shteti dhe specifikisht në Shqipëri në pikat e kontrollit kufitar.*

*2. Letërnjoftimi elektronik lexohet nëpërmjet chipit pa kontakt në pikat e kontrollit kufitar në Shqipëri dhe në pikat kufitare të shteteve ku është pranuar ndërmjet shteteve me marrëveshje letërnjoftimi elektronik si dokument udhëtimi.*

*3. Letërnjoftimi elektronik lexohet gjatë shpërndarjes së tyre në zyrat e shpërndarjes së kompanisë (Kompanisë koncensionare dhe prodhuese të dokumenteve) dhe gjithashtu bëhet një verifikim biometrik dhe ndryshim i PIN-i gjatë këtij procesi.*

*4. Një lexues që përdoret për leximin e letërnjoftimit elektronik është MSO-1350 pajisje që përdoret në zyrat e shpërndarjes së kompanisë.*

Përsa i përket kërkesës së KLSH për demonstrim leximi të këtyre Chip-ave në prezencë të përfaqësuesit të KLSH, në shkresën e Ministrisë së Brendshme **përgjigja është:**  
*Demonstrimi i kërkuar prej grupit të auditimit mund të kryhet në një nga zyrat e aplikimit për dokumente biometrike në Tiranë.*

*( Bashkalidhur kësaj shkresë "Kthim përgjigje" janë vendosur dhe dokumentacion e kompanisë Aleat sh.p.k dërguar me një shkresë të datës 03.05.2013 Ministrisë së Brendshme).*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

*Këto dokumente disponoheshin në dokumentacionin që KQZ i vuri në dispozicion grupit të auditimit.*

**Komente të Grupit të Auditimit të KLSH:**

**Në lidhje me përgjigjet e pyetjes nr. 4, KLSH konstaton se:** Në pikat kufitare të çdo shteti dhe specifikisht të Shqipërisë nuk lexohen Chip-at me kontakt apo pa kontakt si për pasaportat biometrike por dhe për kartat ID në këto pika lexohet MRZ dhe kjo gjë duhet të dihej mirë nga kthyesit e përgjigjes.

Në lidhje me leximin nga ..... dhe ndryshimi i Pinit nga ana e tyre. Konstatojmë se nga ana e Grupit të auditimit kërkohet leximi i kartave dhe pasaportave ( chip-at) në vitin 2013 e më parë kur u realizua dhe Projekti SEV dhe jo për veprimtari që ka filluar pas vitit 2014.

*Përsa i përket përgjigjes se: Një lexues që përdoret për leximin e letërnjoftimit elektronik është MSO-1350 pajisje që përdoret në zyrat e shpërndarjes së kompanisë .....*

*Konstatojmë se duhet të ishte shteti Shqiptar i pajisur me pajisje për lexim Chipi.*

**Observacion në formën e një shkrese kthim përgjigje është bërë dhe nga zni. ....**

**me detyrë Përgjigje e Drejtores së Sistemeve Informatike.**

Kthyer përgjigje me shkresën nr.1921/2 prot. datë 01.04.2016 në lidhje me procesverbalin nr. 2 datë 25.03.2016 të protokolluar në KQZ në të njëjtën datë me nr. 226/9 prot.

Në këtë shkresë theksohet se: *në atë kohë kam pasur detyrën si Drejtore e Dokumenteve të identitetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjëndjes Civile në Ministrinë e Brendshme. Duke sqaruar se ka dhënë konsulencë të specializuar vetëm për projektin SEV dhe jo për projektin SEN. Gjithashtu sqaron se nuk kam qenë anëtare e Njësisë së Prokurimit për Projektet ( SEV dhe SEN). Në lidhje me këtë sqarojmë se sipas shkresës së Ministrit të Brendshëm të asaj kohe me nr. 7536/1 prot. datë 09.11.2012 jam caktuar si konsulente e specializuar në Projektin SEN dhe SEV.*

**Përgjigje e grupit të auditimit:** *Znj. .... është caktuar si një nga katër anëtarët e Njësisë së Prokurimit për Projektin SEV. Nga ana e KLSH në material cilësohet pikërisht për këtë detyrë që ka kryer në këtë prokurim. Në pamundësi për tu kontaktuar dhe duke qenë se nga ana e saj sipas Përfaqësuesit të KQZ kërkohej që nga ana e KLSH të kishte një kërkesë me shkrim ku të ishin përcaktuar dhe pyetjet konkrete që do ti adresonte grupi i auditimit. Nga ana e KLSH u dërgua shkresë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme me pyetjet konkrete. Përgjigja e të cilës është bërë me shkresë të cituar më lart në material ku dhe observuesja një kopje të kësaj shkrese ia ka bashkangjitur observacionit të saj.*

**Në lidhje më prapsimet për Projektraportin e Auditimit të bëra nga zni. ....**  
**me shkresën nr. 1921/3 prot. Datë 22.04.2016 ( nr. 1131/10, datë 25.04.2016 të KLSH) konstatojmë se, këto observacione janë pothuaj të njëjta me ato në lidhje me procesverbalin e mbajtur si dhe me përgjigjet e dhëna nga shkresa që KLSH i ka drejtuar Ministrisë së Brendshme në lidhje me Kartat ID dhe Pasaportat Biometrike. Megjithëse KLSH në shkresën e saj kërkonte një demostrim për leximin e Chipave duke e konsideruar atë thelbësore, ajo nuk u realizua nga Ministria e Brendshme. Çështja adresohet prej tyre në institucione të tjera dhe citohen dispozita ligjore e kontraktuale për përmbajtjen e Chipave. KLSH kërkon të di gjëndjen e përmbajtjes të të dhënave faktike të tyre ( Chipave ) deri në realizimin e zgjedhjeve të vitit 2013 dhe jo atë juridike ( përmbajtjen e të dhënave sipas akteve ligjore) të tyre. Për këtë qëllim duke e konsideruar çështjen mjaft teknike ky materjal do të mund të veçohet nga KLSH me qëllim adresimin e saj në struktura më të specializuara shtetërore.**



**KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

Përsa i përket faktit nëse ka qenë apo jo anëtare e Njesisë së Prokurimit të Projektit SEV Qarkut Tiranë, KLSH i referohet Urdhërit të Prokurimit të KQZ nr.1, datë 03.01.2013 (firmosur nga znj. Aliona Mansaku) ku në pikën 2 të saj citohet se: znj. Miranda Harizaj është një ndër anëtarët e Njesisë së Prokurimit për Sistemin SEV Qarku Tiranës. Meqenëse vazhdon të insistojë në mos qenien në cilësinë e anëtares së Njesisë së Prokurimit për Projektin SEV të Qarkut Tiranë dhe se nuk njihet me ndonjë Urdhër, më poshtë po japim një mënyrë të skanuar Dokumentin përkatës.

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
 PËR QARKUN E TIRANËS  
 BULEVARDI "11 BELLIN" NR. 1  
 TIRANË

Nr. 25 Prot


**URDHËR PROKURIMI**

Nr. 1 datë: 3.01.2013

Në mbështetje të nenit 6, nenit 32 pika 1/b, nenit 33 pika 2/c të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Kreu IV pika 4 dhe 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 10.1.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i azhurnuar, Vendimin e KQZ nr.23, datë 28.12.2012, "Për miratimin e procedurës prokuruese që do të përdoret në përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet teknologjike SEN dhe SEV, që do të aplikohen në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23.06.2013", si dhe për arsye të nevojës ekstreme në të cilën ndodhet Autoriteti jonë Kontraktor, për implementimin e sistemit elektronik të numërimit të votave, të parashkuar në nenin 179/1 të ligjit 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

**URDHËR DJ**

1. Me fonde publike të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, të zhvillohet procedura prokuruese "procedura me negociim, pa votim paraprak të njoftimit të kontratës", pa fond limit dhe objekt "Realizimi i sistemit të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV), në Qarkun e Tiranës". Kjo procedurë do të përdoret në pamundësi të llogaritjes së fondit limit si dhe për shkak të një nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashkuara, që nuk i ngarkohen autoritetit tonë kontraktor, siç është detyrimi i KQZ-së për realizimin e sistemit të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve dhe kohës mjaft të kufizuar në dispozicion për realizimin e këtij sistemi, parashkuar në nenet 32 pika 1/b dhe 33 pika 2/c të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar,



2. Njësia e prokurimit të përbëhet nga:
- Jurist
  - DTI
  - Specialiste
  - Financiere

*Ky urdhër hyn në fuqi menjshërë.*

Adresa:  
 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
 Bulevardi "11 Bellin" nr. 1  
 Tiranë  
 Tel./Fax:  
 +355 (0) 22 55 55 55  
 Web: www.kqz.gov.al  
 E-mail:  
 kqz@kqz.gov.al



*[Signature]*  
 Titullar i Autoritetit Kontraktor

Kopje:  
 Afat i rrafshës: 3 vjet  
 KQZ/DF/MG  
 KQZ/NJP/BK

Urdhër Prokurimi Nr. 1 datë 3.1.2013  
 "Realizimi i sistemit të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV), në Qarkun e Tiranës"



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

**VII. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm**

Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në KQZ, në këtë proces rezultoi se: strukturat përgjegjëse të KQZ-së, përgjithësisht kishin njohuri mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij.

Gjatë vitit 2014, z. ... , Sekretar i Përgjithshëm i KQZ në cilësinë e Nëpunësit Autorizues për vitin 2014, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 9, pika ç, ku citohet "Nëpunësi autorizues i njësisë publike bën caktimin dhe shkarkimin e nëpunësit zbatues", me anë të autorizimeve të veçanta, i ka deleguar një pjesë të kompetencave dhe të drejtën e nënshkrimeve si nëpunës zbatues znj. ... , për kryerjen e veprimeve ekonomike financiare për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, auditimi u fokusua në funksionimin menaxherial të realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij në të gjithë komponentët si "Mjedisi i kontrollit", "Menaxhimi i riskut", "Aktivitetet e kontrollit", "Informimi dhe Komunikimi" si dhe "Monitorimi", në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", në të cilën titullari i njësisë në sektorin publik zbaton menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin.

Me shkresën nr. 2066, datë 11.03.2015, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së z. ... në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, ka dërguar në Ministrinë e Financave, "PyetëSORIN e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, deklaratë dhe raportin për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2014", sipas nenit 18 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Auditimi u bazua në testet e kontrollit në procedura pune, për të vlerësuar përputhshmërinë me përgjigjet e pyetësorit të vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dërguar në Ministrinë e Financave, Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit me shkresën nr. 2066, datë 11.03.2015 (që nuk është brenda afatit dhe konform nenit 18 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010), ku thuhet se :

"... depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual".

***Nga auditimi sipas drejtimeve të përcaktuara dhe bazuar në Raportin vjetor mbi cilësinë dhe gjendjen e kontrollit të brendshëm rezultoi se:***

**VII.1. Mjedisi i kontrollit**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, funksionon në bazë të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Vendim i KQZ-së nr. 40, datë 2.11.2010 "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionit të administratës së KQZ-së", urdhrave dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të Kodit Zgjedhor etj.

Këto aktet ligjore e nënligjore krijojnë kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Struktura dhe organika e miratuar përbëhet nga 7 anëtarë dhe 48 nëpunës/punonjës, e cila garanton realizimin në ushtrimin e funksioneve në zbatim të detyrimeve ligjore të KQZ-së, ndarjen e detyrave funksionale, hierarkinë dhe rregullat përkatëse për të drejtat, përgjegjësitë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

shmangien e konfliktit, linjat e raportimit, etj. Detyrat funksionale të administratës së KQZ-se janë përcaktuara në përshkrimet e punës për çdo pozicion pune, në kontratat individuale të punës si dhe në aktet e sipërcituara. Në bazë të strukturë organikës së miratuar në çdo rast me vendim të KQZ-së është kryer ndarja e detyrave dhe e përgjegjësive, e vartësisë funksionale dhe administrative si dhe linja e raportimit. Nga drejtuesi i strukturës sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin nëpunës civil apo punonjës mbështetës. Në përzgjedhjen e nëpunësve civilë dhe punonjësve mbështetës të KQZ-se, janë zbatuar kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, dhe Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Përgjatë auditimit u vërejt se ekzistonin deklarata e misionit të miratuar dhe udhëzimi lidhur me menaxhimin e proceseve të vendosjes së objektivave.

**VII.1.1. Vendosja e objektivave.**

Misioni dhe Objektivat e KQZ-së janë të parashikuara në dispozitat e Kodit Zgjedhor, në kompetencat e KQZ-së, në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës së KQZ-së, miratuar me vendim të KQZ-së nr. 40, datë 02.11.2010. KQZ me daljen e dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve, harton plan veprimin, në të cilin përfshihen edhe strategji për veprimtari të caktuara, si Strategjia për edukimin zgjedhor të shtetasve dhe Strategjia për trajnimin e komisionerëve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta me aktet përkatëse. Me vendimin nr. 161, datë 24.12.2014 KQZ miratoi Planin Orientues të Veprimeve për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2015, i cili shërben si kornizë udhëzuese për veprimet dhe aktet nënligjore. Nëpunësit e institucionit janë të informuar me të gjitha aktet e nxjerra nga KQZ-ja dhe është detyrë funksionale e tyre për të zbatuar me korrektësi këto vendime. Të gjitha këto akte janë të hedhura elektronikisht në arkivën e KQZ-së dhe mund të shihen online në faqen e ëëbit nga të interesuarit. Përgatitja e projekt-buxhetit si edhe detajimit të tij, bëhej në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë. Objektivat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë në funksion të qëllimit të institucionit për realizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme të njohura nga garuesit në zgjedhje dhe brenda standarteve demokratike të kërkuara nga faktorët ndërkombëtarë. Këto objektiva synojnë hartimin e politikave, programeve e procedurave për përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve, sipas rregullave të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Disa prej tyre janë :

- Nxjerrja, në bazë dhe për zbatim të ligjit dhe brenda sferës së juridiksionit të saj të vendimeve dhe udhëzimeve me fuqi juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda afateve kohore të parashikuara në Kodin Zgjedhor.
- Marrjen e vendimeve për njësimin e praktikave zgjedhore referuar zgjedhjeve të kaluara dhe vendimeve të Kolegjit Zgjedhor.
- Zhvillimin me shpenzimet e veta (të KQZ-së) të kurseve të trajnimit për administratën e KQZ-së dhe për komisionerët e niveleve të dyta dhe të treta (KZAZ, KQV, GNV).
- Zhvillimin e aktiviteteve dhe programeve të trajnimit për administratën zgjedhore në mënyrë periodike jashtë periudhës zgjedhore.
- Zhvillimin e politikave për sensibilizimin, informimin dhe edukimin zgjedhor të shtetasve në mënyrë periodike,
- Miradministrimin dhe zhvillimin në çdo kohë të zgjedhjeve të pjeshme,
- Ndërtimin e programeve aplikative në funksion të realizimit të detyrave të përcaktuara në ligj dhe zhvillimit të sistemit të integruar të administrimit të zgjedhjeve.



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTARI AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

**VII.1.2. Etika personale dhe profesionale.**

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2014 nga kjo njësi publike është hartuar Rregullorja e Brendshme e miratuar me Vendimin nr. 40, datë 02.11.2010, e ndryshuar, "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës së KQZ-së". Urdhri nr. 77, datë 08.04.2009, "Për caktimin e disa rregullave për disiplinën në punë dhe etikën e punonjësve në Administratën e KQZ-së", ku punonjësit e administratës urdhërohen të zbatojnë rregullat për zbatimin e disiplinës në punë, të etikës dhe marrëdhëniet midis eprorëve dhe vartësve.

Në përshkrimet e punës për nëpunësit civilë dhe kontratat e punës të lidhura me punonjësit e tjerë në organikë, janë përcaktuar detyrimet që punonjësi ka për disiplinën në punë, zbatimin e etikës dhe marrëdhëniet midis eprorit dhe vartësit, si dhe masat që do të merren për mos zbatimin e tyre. Në lidhje me ushtrimin e kompetencave të punonjësve para organit që i ka emëruar, ka gjetur zbatim pika 9 e nenit 4, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ku është përcaktuar se "...në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë.

Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Po kështu, sipas nenit 4, pika 20, Përgjegjësia e menaxherit (Sekretarit të Përgjithshëm) lidhet me ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se, ajo është kryer sipas parashikimit. Nëpërmjet mbikëqyrjes, menaxheri jep udhëzime dhe kryen trajnimin e nevojshëm për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna prej tij kuptohen dhe arrihen nga punonjësit. Përsa i përket kuadrit rregullator ligjor për etikën, kjo njësi publike i referohet Rregullores së Brendshme me Vendimin nr. 40, datë 2.11.2010 "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës së KQZ-së", Urdhrit nr. 77, datë 08.04.2009, "Për caktimin e disa rregullave për disiplinën në punë dhe etikën e punonjësve në Administratën e KQZ-së".

**VII.1.3. Struktura organizative në funksion të objektivave të njësisë publike.**

Nga auditimi u konstatua se Struktura e KQZ-së ka nevojë për përmirësime dhe përshtatje me aktet e Këshillit të Ministrave "Për strukturë organikë dhe strukturën e pagave". Për vitin 2014 KQZ-ja është gjendur në pamundësi të marrjes së një vendimi të tillë për shkak të mungesës së disa anëtarëve. Mund të themi se për nga karakteri i aktivitetit institucional i KQZ-së, struktura organizative e administratës së KQZ-së, ka qenë efiçente në realizimin e detyrave. Kjo strukturë përcaktohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas Kodit Zgjedhor. Çdo departament/drejtori/sector, ka përgjegjësitë dhe detyrat të përcaktuara qartë dhe veçmas nga drejtoritë/departamentet /sectorët e tjerë. Këto përgjegjësi janë të përshkruara në Rregulloren e Brendshme, në Përshkrimet e Punës dhe në Kontratat e Punës të lidhura me punonjësit mbështetës të Institucionit. Sipas kërkesave të nenit 27 pika 2 të Ligjit nr. 10296 për MFK është krijuar Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) i cili dhe është i përbërë nga Kryetarja e KQZ-së, Zv/Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm dhe gjithë drejtorët.

Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

financiar dhe kontrollin" është caktuar Nëpunës Autorizues në përputhje me kërkesat e ligjit z me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së, ndërsa Nëpunës Zbatues është caktuar znj. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës. *Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me nenin 12 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues" pika 3, gërma "a" të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" urdhër - shpenzimet janë firmosur nga Përgjegjësja e Sektorit të Financës dhe jo nga Drejtoresha e Drejtorisë së Financës që është Nëpunës Zbatues.* Për sa i përket menaxhimit të programeve buxhetore, KQZ ka vetëm një program buxhetor në vitin kur zhvillohen zgjedhje, shtohet një program tjetër "Zgjedhjeve të përgjithshme/lokale", dhe drejtues i programit buxhetor është Sekretari i Përgjithshëm. Nga auditimi konstatohet se në KQZ nuk ka një strukturë të miratuar të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, sepse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ qendror i pavarur dhe nuk ka njësi varësie.

#### **VII.1.4. Mënyrat e të vepruarit dhe Menaxhimi.**

Në lidhje me veprimet e titullarit/drejtorit të njesisë (KQZ-së) në cilësinë e menaxherit të institucionit, konstatohet se për vitin 2014 nuk janë dhënë apo janë marrë masa për rastet e shkeljes së etikës apo të sjelljes pasi nuk ka patur të tilla. Ndërsa për vitin 2015 është dhënë një masë disiplinore "Largim nga shërbimi civil" me vendim nr. 17, datë 12.10.2015. Bazuar në nenet 63, gërma b, në nenin 66 pika 1 gërma "e", të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar, VKM nr. 171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësit civil, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", Vendimit nr. 7779, datë 12.10.2015, të Komisionit Disiplinor, "Për shqyrtimin e shkeljes disiplinore, mospërbushje të detyrave që burojnë nga ligji i nëpunësit civil, thyerje të etikës në punë, mosplotësimi i detyrave të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë". Konstatohet se rregullat e brendshme janë të miratuara nga Titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave.

#### **VII.1.5. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.**

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve të administratës së KQZ-së, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore u konstatua se, përshkrimet e punës mbahen në dosjen e secilit punonjës sëbashku me dokumentat e tjera të punonjësit. Përshkrimet e punës janë miratuar për çdo pozicion pune, në të cilat të përfshihen detyrat individuale që duhen kryer, kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme dhe linjat e raportimit. Ashtu sikurse edhe përshkrimet e punës, edhe vlerësimet periodike të punonjësve administroheshin në dosjen e secilit punonjës, lidhur me detyrat që ata kryejnë si pjesë e përgjegjësive të tyre, ku në fund të vitit 2014 janë bërë vlerësimet periodike. Punonjësi janë informuar për vlerësimin periodik dhe kanë nënshkruar.

#### **VII.2. Menaxhimi i riskut.**

Nisur nga kontrollat e bëra nga grupi i auditimit rezultoi se z. ( ), në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në KQZ, në zbatim të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, është koordinator risku por kjo kompetencë rezulton se nuk është deleguar. Në zbatim të nenit 21 të këtij ligji, konstatohet që nuk ka pasur një procedurë konkrete për formalizimin dhe dokumentimin e procedurave për menaxhimin e riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit. Ka pasur vetëm disa raste specifike dhe kryesisht të lidhura me administrimin e procesit zgjedhor. Nga auditimi konstatohet se për vitin 2014 nuk ka një regjistër risku për këtë institucion duke mos përmbushur kështu nenin 8, pika 8/a të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ku shprehet qartë se "Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

*financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: Hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njërive publike që ato drejtojnë, të planeve strategjike vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planveprimeve për arritjen e objektivave”, dhe nenin 12, pika 3, gërma "d".*

Nga observimet e bëra në shkresën nr. 226/12, datë 17.05.2016 të KQZ mbi Projektraportin e Auditimit, një konkluzioni i tillë është pranuar, ku citohet: “... Pas konstatimit nga ana e auditimit të jashtëm të kryer nga grupi juaj i auditimit, Sekretari i Përgjithshëm do të marrë të gjitha masat për formalizimin e regjistrimit të menaxhimit të riskut në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

### **VII.3. Aktivitetet e kontrollit.**

Aktivitetet e kontrollit janë politikat dhe procedurat e vendosura për të adresuar risqet dhe për arritur objektivat e institucionit. Ato përfshijnë një gamë veprimesh kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues. Në lidhje me aktivitetet e kontrollit, është e rëndësishme një ndarje e përshtatshme e detyrave, në mënyrë që i njëjti person/strukturë të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy,ose më shumë detyrave që lidhen me miratimin, zbatimin dhe regjistrimin e operacioneve, vendosja e rregullave të brendshme mbi kontrollin para faktit ose paraprak të ligjshmërisë, veprime të përshtatshme kontrolli për sistemet e IT-së, etj.

Në KQZ sistemet e kontrollit të brendshëm funksionojnë duke ju referuar Rregullores së Brendshme të institucionit, urdhrave dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të Kodit Zgjedhor. Nëpunësi Autorizues dhe ai Zbatues nënshkruajnë të gjitha angazhimet e institucionit në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH" dhe nenin 9 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Ndërsa urdhër - shpenzimet sic e theksuam edhe më lart nuk nënshkruhen nga Nëpunësi Zbatues por nga Përgjegjësjë e Sektorit të Financës.

### **VII.4. Informimi dhe Komunikimi**

Komunikimi dhe Informimi si mjete thelbësore për zbatimin e objektivave të institucionit në tërësi realizohet përmes punonjësve duke respektuar nivelin e hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Informacioni dhe komunikimi lidhen me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit.

Administrimi i informacionit në KQZ është i ndarë në dy drejtime :

- Administrimi i përditshëm i informacionit në institucionin e KQZ-së (anëtarë, administratë) dhe,
- Administrimi i informacionit zgjedhor në shërbim të institucionit, subjekteve zgjedhore dhe publikut.

Informacionet publikohen nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së në internet (<http://www.cec.org.al>).

Për administrimin e informacionit në KQZ është ndërtuar një rrjet i brendshëm (*intranet*) në të cilin janë instaluar :

- 46 kompjutera personal (PC),
- dy servera e paisje të tjera të nevojshme për funksionimin e një rrjeti.

Nëpërmjet intranetit, punonjësit kishin mundësi të shkëmbejnë informacion me njëri tjetrin me aplikacionin “mesazher” që administrohet në një server. Në po këtë server administrohej





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

dhe posta elektronike që shërbente edhe për komunikime edhe me të tretët. Intraneti u jepte mundësi punonjësve të përdornin shërbimet që ofronte arkiva elektronike e KQZ-së.

Në një server tjetër administrohej gjithë arkiva elektronike e KQZ-së ku përfshiheshin projektaktet që diskutohen në mbledhje të KQZ-së, aktet që miraton KQZ, urdhrat e brendshëm, etj. Në po këtë server çdo përdorues kishte një "llogari" të vetën për të ruajtur kopje të materialeve që ka në PC. Nëpërmjet intranetit dhe paisjeve audio-video të instaluar në sallën e mbledhjeve të KQZ-së (tani do të instalohen në sallën e re, godina e re), bëhej i mundur regjistrimi i mbledhjeve të KQZ në një nga serverat. Gjithashtu mbledhjet transmetohen direkt në faqen e internetit të KQZ-së.

Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, si një organ që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të tyre, veç të tjerave i duhet të administrojë një informacion tepër të gjerë, duke filluar me të dhënat për QV-të, numrin e zgjedhësve në to, vendndodhjen e tyre, administruesit e tyre (anëtarët e komisioneve të Qv-ve), vendet e numërimit të votave me paisjet përkatëse e deri te anëtarët e grupeve të numërimit, informacioni për rezultatet, hedhja e tabelës së rezultateve në proces në sistem, transmetimi i tyre nga VNV në KQZ e publikimi edhe në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, llogaritja e nominimi i mandateve për kandidatët fitues deri në shpalljen e rezultatit përfundimtarë.

KQZ-ja synon që për të ardhmen tu kërkojë donatorëve të financojnë për të zhvilluar një aplikacion të quajtur "Sistemi Elektronik i Eelektronik i Menaxhimit të Dokumentacionit (EDMS)". Nëpërmjet këtij aplikacioni do të mundësohet, administrimi elektronik i të gjithë dokumentacionit që qarkullon në KQZ. Aplikacioni do të mundësojë veç të tjerash ndjekjen dhe auditimin e etapave për të nxjerrë raporte sipas nevojave, si dhe për të parë se ku ndodhet një dokument, hapat që janë ndjekur deri në një moment të caktuar etj, **kjo gjë që nuk mundësohet aktualisht.**

Me ndihmën e donatorëve janë zhvilluar deri tani modulet kryesor dhe mendohet që deri në zgjedhjet e ardhshme të mundësohet zhvillimi i moduleve të tjera. *Për këtë sistem deri tani janë zhvilluar ose janë në proces zhvillimi modulet:*

- Ndjekja e shpërndarjes të materialeve zgjedhore,
- Menaxhimi i funksioneve në ditën e zgjedhjeve (hapja e votimit, pjesëmarrja në orë të caktuara, bllokimi eventual i votimit, mbyllja e votimit),
- Menaxhimi i procesit për regjistrimin e subjekteve zgjedhore, verifikimi dhe vlefshmëria e të drejtës të kandidateve për të kandiduar, publikimi në internet. Synohet që aplikimi për regjistrimin në zgjedhje të subjekteve të bëhet online,
- Menaxhimi i informacionit për financimin dhe shpenzimet për fushatën zgjedhore të subjekteve zgjedhore. Në proces synohet që raportimi i subjekteve zgjedhore të bëhet online,
- Konsolidimi i rezultateve ku menaxhohet hedhja, kontrolli dhe transmetimin e rezultateve nga Vendi i Numërimit të Votave (VNV) në KQZ,
- Moduli "Rezultatet e natës së zgjedhjeve" (*Election night results*), nëpërmjet të cilit publikohet në dinamik rezultatet paraprake të zgjedhjeve në sallën e mediave në KQZ dhe në faqen e internetit.

*Module të planifikuara për t'u zhvilluar:*

- Moduli për menaxhimin e fletës së votimit, zgjedhjet rastësore në renditje, dizajnimin e fletës së votimit dhe përgatitja për tu printuar;



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

- Moduli për menaxhimin e informacionit për ndarjet administrative dhe zgjedhore (qark, bashki, zona të administrimit zgjedhor, vende të numërimit të votave dhe qendrave të votimit);
- Moduli për menaxhimin e të dhënave për administratën zgjedhore;
- Moduli për menaxhimin buxhetor/financiar për komisionet e nivelit të dytë;
- Modulet për shpërndarjen e mandateve dhe historinë e tyre;
- Modulet për përgatitjen e raporteve për buletin zgjedhor.

**Qendra e të dhënave (QDH) në KQZ** përbëhet nga 20 kompjutera, katër servera, një printer/fotokopjues/skaner dhe paisje të tjera të nevojshme për funksionimin e rrjetit. Kjo Qendër, për efekt sigurie funksionon në një rrjet më vete. Në këtë Qendër në periudhë zgjedhore punojnë përveç punonjësve të DTI-së edhe punonjës të përkohshëm që planifikohen gjatë periudhës zgjedhore.

Në QDH administrohet informacioni para zgjedhor (të dhënat për qv-të, njësitë vendore, njësitë administrative, zonat e administrimit zgjedhor, subjektet zgjedhore, listat shumëmemorore të kandidatëve për deputet e këshilltarë, kandidatët për kryetar bashkisë, administratën zgjedhore, vëzhguesit etj). Ditën e zgjedhjeve e në vazhdim QDH lidhet me VNV-të dhe merr informacionin që dërgohet prej tyre. Ky informacion në bazë të akteve ligjore e nënligjore sistemohet e kontrollohet në këtë Qendër, publikohet e paraqitet për miratim deri në rezultatin përfundimtarë të zgjedhjeve.

#### **VII.5. Monitorimi**

Nga auditimi u konstatua se në mënyrë permanente, kryesisht gjatë periudhës zgjedhore Sekretari i Përgjithshëm, ju kërkon Drejtorëve të Drejtorive raportim në lidhje me monitorimin e rregull të progresit lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimin e shkaqeve për dështimet e mundshme në arritjen e këtyre objektivave. Kjo kërkesë lidhet me funksionet e çdo punonjësi në hartimin dhe nënshkrimin e dokumentave financiare, konform ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 4 "Përkufizime", ku është përcaktuar: "Kontrolli i brendshëm financiar publik (KBFP)" është tërësia e sistemit të kontrollit të brendshëm që ushtrohet nga njësitë publike, për të garantuar se menaxhimi financiar dhe kontrolli i njësive të sektorit publik është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi. Kontrolli i brendshëm financiar publik përfshin të gjitha veprimtaritë, me qëllim kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve të njësive publike". Raporti i monitorimit për vitin 2014 është dërguar në Ministrinë e Financave/ Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit me shkresën nr. 2066, datë 11.03.2015. Në raportin e monitorimit jepën konkluzione në lidhje me realizimin e objektivave, realizimin e produkteve dhe shpenzimeve si dhe rritjen e numrit të seminareve për kualifikimin e personelit në zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Për sa trajtuam në këtë pikë të audituar sipas programit të auditimit, arrijmë në konkluzionin se: Në kuadrin e zbatueshmërisë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, është e nevojshme që në të gjitha hallkat dhe strukturat menaxhuese të rritet kërkesa për përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollit. Për këtë duhet të punohet më shumë për mënyrën e analizës së Menaxhimit të Riskut si dhe të gjitha detyrimeve të tjera, të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financës për menaxhimin e buxhetit dhe aktiveve,



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

me qëllim aftësimin e tyre për identifikimin në kohë të risqeve, menaxhimin e tyre përmes kontrolleve cilësore. Për të rritur efikasitetin e Kontrollit të Brendshëm, gjithashtu janë të domosdoshme kualifikimet, trajnimet periodike mbi menaxhimin e riskut, për të rritur efikasitetin në përdorimin e fondeve dhe përsosjen e koncepteve menaxheriale në kuadër të zbatimit të ligjit të MFK-së.

*Në lidhje me këtë pikë u mbajt Aktverifikimi nr. 3 datë 15.03.2016 për të cilën nuk u paraqitën vërejtje. Vërejtje nuk u paraqitën as në lidhje me Projektraportin e Auditimit.*

**VIII. Probleme të ndryshme të dalta gjatë Auditimit.**

**- Zbatimi i kriterëve për subjektet politike të cilat nuk kanë kaluar pragun ligjor në zgjedhjet e mëparshme, paraqitja e tyre në formularin e debitorëve dhe humbja e të drejtës për financime në zgjedhjet e mëpasshme.**

VIII.1. Nga auditimi i ushtruar në pagesat e kryera në favor të subjekteve zgjedhore për pushtetin vendor 2011, u konstatua se KQZ ka vepruar konform me kreun II "Financimi i zgjedhjeve" neni 86 "Fondet për financimin e zgjedhjeve dhe neni 87 "Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondeve publike për subjektet zgjedhore". Megjithatë duhet theksuar se, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 87, nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve që kanë lindur në zgjedhjet paraardhëse për partitë që nuk kanë fituar asnjë mandat, në zgjedhjet e radhës duhet të kthejnë shumën përkatëse të përfutur. Në të kundërt, sipas pikës 4 të këtij neni, në se partitë nuk kthejnë fondet përkatëse sipas pikës 3, humbasin të drejtën e regjistrimit si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e radhës, pavarësisht llojit të tyre, as vetëm as si pjestare e ndonjë koalicioni. Në kundërshtim me nenin 87 të "Kodit Zgjedhor" janë regjistruar në koalicione në zgjedhjet vendore të vitit 2011, pa shlyer detyrimet e mbartura nga periudhat e mëparshme, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Partitë Politike	Viti i krijimit	Detyrime për t'u kthyer nga subjektet që nuk kanë kaluar pragun sipas kodit zgjedhor
1	Partia Socialiste	2003	305.855
2	Partia Demokratike	2003	1.143.450
3	Partia Social Demokrate	2003	172.615
4	Partia Social Demokrate	2009	5 136 667
5	Partia Agrare Ambientaliste	2009	2 644 556
6	Partia Aleanca Demokratike	2009	1 920 479
7	Partia Demokracia Sociale	2009	1 711 151
8	Partia Demokristiane	2009	1 315 153
	<b>Totali</b>		<b>14.349.926</b>

Nga tabela e mësipërme rezulton se, në kundërshtim me "Kodin Zgjedhor", KQZ duhet të bashkërendonte punën me Ministrinë e Financave, e cila para çeljes së fondeve për partitë sipas listës së miratuar nga KQZ, duhet të zbriste më parë detyrimin e mbartur nga zgjedhjet e mëparshme për çdo subjekt politik, konform pikës 3 të nenit 87 "Kodi Zgjedhor".

VIII.2. Nga auditimi në zbatim të nenit 91 "Për auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore", u konstatua se, për auditimin e fondeve të çelura nga buxheti në favor të 34 partive politike dhe atyre të përfuturara nëpërmjet sponsorizimeve për zgjedhjet e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

“Kuvendit të Shqipërisë” dhe nga burimet e veta, KQZ ka përzgjedhur nga një listë shumëmemërore, konform nenit 92, të “Kodit Zgjedhor”, duke emëruar ekspertë kontabël të licencuar me të cilët ka lidhur 34 kontrata në vlerën gjithsej 3.268.000 lekë, nga këta, për vitin 2010 ka likuiduar 20 ekspertë kontabël në vlerën prej 2.728.000 lekë.

Për auditimin e partive politike për financimin e veprimtarisë së tyre, sipas ligjit nr. 10374, datë 10.02.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, sipas nenit 23, i ndryshuar, auditimi i fondeve të partive të përfituara nga buxheti i shtetit dhe ato nga sponsorizimet bëhet nga ekspertë kontabël të përzgjedhur nga KQZ. Fondet për pagesën e ekspertëve përballohen nga vetë partitë.

Për sa më lart, për vitin 2012 KQZ nuk ka planifikuar fonde për auditimin e veprimtarive të partive politike, pasi partitë do të paguajnë vetë ekspertët kontabël të autorizuar për auditimin e veprimtarive të tyre ekonomiko-financiare.

**Në përfundim të auditimit, për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave të mëposhtme:**

### **A.MASA PËR PËRMIRËSIME LIGJORE**

Në zbatim të “Kodit Zgjedhor në RSH” i ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012 dhe me Ligjin nr. 31/2015 datë 02.04.2015, neni 91 “Auditimi i fondeve dhe i shpenzimeve të fushatës zgjedhore” pika 1, përcakton detyrimin e KQZ për të emëruar një ose shumë ekspertë kontabël të licencuar, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore..., pra në Kod përcaktohet detyrimi për auditimin e fondeve të fushatës zgjedhore duke nënkuptuar një proces auditimi të shkëputur nga aktivitetit vjetor i subjekteve zgjedhore.

Në pikën 2, kërkohej që subjektet zgjedhore duhet të vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KOZ-ja çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, sipas këtij Kodi.

Në Ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, në nenin 15/2 cilësohet “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive, sipas rregullave të këtij ligji. Në kërkesat e pikës 2, theksohet “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë dhe për zbatimin e këtij ligji, harton dhe miraton rregullat për raportimin e financimit, për monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin financiar të partive politike, si dhe për formatet e standardizuara për raportimin financiar vjetor; miraton formatin e regjistrit të posaçëm të fondeve jopublike të partive politike, si dhe formatin për formën dhe përmbajtjen e deklaratës së dhurimit të fondeve jopublike, .....nxjerr akte nënligjore në bazë dhe për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.”

Ndërsa bazuar në nenin 23, raportet financiare të partive dërgohen një herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), së bashku me raportin e auditimit të përgatitur nga kontabilistë të certifikuar sipas përkrahjes së ligjit.

Në Ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” në nenin 2 “Fusha e Zbatimit” pika 2, cilësohet “Ky ligj zbatohet edhe nga njësitë e tjera, që nuk kanë qëllime fitimprurëse, me përjashtim të rasteve kur pasqyrat financiare dhe kontabiliteti i tyre është subjekt i ligjeve ose i rregullimeve të veçanta”. Për sa kohë që në Ligjin “Për Partitë Politike”, nuk gjejmë referencë për rregullime të veçanta, kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar janë të njëjta me çdo njësi tjetër.

Dispozitat ligjore në fuqi nuk mundësojnë rregullime të detajuara lidhur me regjistrimet kontabël, paraqitjen e tyre dhe nëse duhet të mbahen për një afat kohor të parashikuar. Partitë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

politike në Shqipëri nuk i publikojnë vetë informacionet financiare as për publikun e gjerë, as për anëtarët e tyre. I vetmi informacion është ai i mundësuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe i publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive dhe fushatave zgjedhore. Megjithatë konstatojmë se roli i këtij institucioni është minimizuar vetëm me përzgjedhjen e listës së ekspertëve kontabël të licencuar për auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të partive politike, pa ndonjë rol aktiv në rritjen e transparencës së fondeve të partive politike (*Kjo trajtohet më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja nr. 19 deri në faqen nr.27*).

### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga KQZ të ndërmerret iniciativa ligjore për hartimin e një Ligji “Për Financimin dhe Auditimin e Subjekteve Politike” me qëllim të krijimit të një kuadri rregullator të mënyrës, kushteve të financimit, administrimit, mbikëqyrjes, transparencës dhe raportimit të përdorimit të pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike sipas praktikave më të mira që rregullojnë këtë fushë.

Theksojmë nevojën për hartimin e një kuadri të plotë rregullativ që do të mundësojë krijimin e kontabilitetit të brendshëm të partive, raportimin e standartizuar të partive tek autoritetet mbikëqyrëse, kuptueshmëri të raporteve financiare, intensitet dhe besueshmëri të raportimit financiar, si dhe aktivitet monitorues nga shoqëria civile dhe qytetarët, kjo do të garantonte transparencën në financimin e partive dhe uljen e shkallës së risqeve të korrupsionit në sistemin e financimit politik.

**Menjëherë**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga auditimi i programimit të buxhetit të vitit 2015, konstatojmë se, nivelet e shpenzimeve ndonjëse ishte një vit zgjedhor janë programuar sipas tavanëve të miratuara nga Ministria e Financave, në nivelet e vitit 2014, pa parashikuar shpenzimet që nevojiten për zhvillimin e zgjedhjeve. Ky programim i gabuar ka sjellë ndryshime gjatë vitit, kështu Ministria e Financave me shkresën nr. 18282, datë 24.7.2014 ka dërguar detajimin e shpenzimeve operative për vitin 2015, duke shtuar shpenzimet korente si vit zgjedhor në shumën 684,800 mijë lekë, të ndarë respektivisht në shpenzime menaxhimi dhe administrimi në shumën 64,800 mijë lekë, shpenzime për zgjedhjet lokale në shumën 612,000 mijë lekë, e për investime në vlerën prej 8,000 mijë lekë.

Për vitin 2015 sipas kërkesave të KQZ janë bërë ndryshime në zërat e shpenzimeve në referencë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 501, datë 30.07.2014, sipas të cilit, institucionit i është transferuar një godinë pronë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me sipërfaqe objekti 673 m<sup>2</sup>, me destinacion “Ndërtim i godinës së re të KQZ-së”. Për financimin e objektit të ri Ministria e Financave me shkresën nr. 2135/1, datë 16.02.2015 ka akorduar nga fondi i rezervë i KM në vlerën prej 57,937,000 lekë me tvsh për ndërtimin e objektit, “Zyra të reja të KQZ-së”. Programimi i shpenzimeve në projektbuxhetin afatmesëm është rritur në mënyrë të paargumentuar, për faktin se midis programimit, çeljes së fondeve nga Ministria e Financave dhe realizimit të tyre, u konstatojmë mosrealizime të theksuara të shpenzimeve.

Në ligjin për buxhetin e vitit 2015, për zhvillimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore, KQZ-së i janë akorduar 445,740 mijë lekë, nga 684,800 mijë lekë të programuara, të cilat janë realizuar në masën 395,961 mijë lekë ose 88.7 %. Shpenzimet operative për



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

zgjedhjet vendore janë realizuar në masën 88.7 % ose 49,779 mijë lekë më pak se programimi. Konstatuam se për këtë vit në treguesit e projekt buxhetit janë programuar dhe realizuar shpenzime për blerjen e 1,000 copë kuti votimi në vlerën prej 5,274,829 lekë së bashku shpenzimet për zhdoganimin e tyre. Sipas të dhënave të kontabilitetit konstatohet se në magazinë ka gjendje 19,188 copë kuti votimi me vlerë 80,835 mijë lekë ose dy herë më tepër nga niveli i nevojave për të përballuar zgjedhjet e pushtetit vendor. Rezulton se janë rreth 13,000 copë kuti që nuk mund të përdoren pasi nuk pranohen nga partitë politike të cilat ndryshojnë kërkesat lidhur me karakteristikat e kutive të votimit (kuti me kode apo vula sigurie, me ngjyrë të bardhë, etj), duke sjellë si pasojë ngurtësimin e fondeve publike në mallra stoqe në magazinë (Kjo trajtohet më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja nr. 15 deri në faqen nr.18).

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga ana e KQZ-së të merren masa për një programim të kujdesshëm, të shpenzimeve operative për vitet zgjedhore, me qëllim përdorimin efektiv të fondeve publike, duke patur si objektiv shfrytëzimin dhe vënien në përdorim të rezervave të materialeve zgjedhore mbi normativë të krijuara ndër vite.

**Në vazhdimësi**

2. Në zgjedhjet vendore 2015, subjektet zgjedhore pjesëmarrëse janë financuar në vlerën 65 milionë lekë. Shpërndarja e këtij fondi është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 87/2 të Ligjit “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Janë financuar (parapaguar) 61 subjekte politike, më pas, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve, KQZ ka bërë rillogaritjet dhe ka përcaktuar se 46 subjekte politike duhet të kthejnë vlerën prej 11,688,138 lekë, si diferencë midis paradhënies së përfituar dhe shumës që duhet të përfitonin bazuar në nivelin e rezultetit të arritur (numrit të votave në zgjedhjet vendore). Ky detyrim i takon 31 subjekteve politike që nuk kanë kaluar pragun 0.5 %, (në vlerë 2,583,323 lekë), dhe 15 subjekteve politike (në vlerën prej 9,104,825 lekë), që ndonëse kanë kaluar pragun, niveli i financimit duhet të ishte më i ulët referuar nivelit të rezultetit të arritur. Nga të dhënat që disponon KQZ, konstatuam se subjektet zgjedhore (partitë politike) fituese nuk kanë kërkuar të drejtën për fonde shtesë bazuar në nivelin e rezultetit të arritur.

Ndërkohë nga të dhënat e pasqyrave financiare të KQZ, konstatuam se janë debitorë 8 subjekte zgjedhore, për detyrime të lidhura me zgjedhjet e vitit 2003 në shumën prej 1,621,920 lekë dhe për detyrime në zgjedhjet e vitit 2009 në shumën 12,728,006 lekë. Nuk konstatuam përpjekje për mbledhjen e këtyre detyrimeve ndërkohë që KQZ vazhdon të financojë pjesëmarrjet zgjedhore për këto subjekte zgjedhore në vazhdimësi (Kjo trajtohet më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqen 42).

**Për sa më sipër rekomandoj:**

KQZ në zbatim të nenit 87, pika 8, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të iniciojë procedurat përkatëse administrative për rikthimin e menjëhershëm të fondeve publike nga subjektet debitorë si dhe të kërkojë marrjen e masave për të filluar procedurat e penalizimit të subjekteve zgjedhore debitorë deri në përjashtim të tyre nga zgjedhjet e tjera të radhës për papërgjegjshmëri në administrimin e fondeve publike të përfituara përtej të drejtës që i jep Kodi Zgjedhor.

**Menjëherë**

3. Konstatohet se në zgjedhjet vendore të muajit qershor 2015, fondi i vënë në dispozicion, i ka kaluar 5 Partive Politike të renditura të parat (rreth 40 milionë lekë), ndërsa për 40



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

subjekte politike niveli i përfitimit ka qënë vetëm 83,333 lekë secili. Konstatuam se 31 subjekte zgjedhore (parti politike), ndonëse kanë përfituar fonde publike, nuk kanë deklaruar pranë KQZ asnjë financim apo donacion tjetër, po kështu edhe 19 kandidatë të pavarur nuk kanë përfituar fonde publike dhe nuk kanë deklaruar asnjë të ardhur apo donacion tjetër. Në zbatim të “Kodit Zgjedhor në RSH” i ndryshuar me Ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe me Ligjin nr. 31/2015 datë 02.04.2015, neni 91 “Auditimi i fondeve dhe i shpenzimeve të fushatës zgjedhore” pika 1, *“Jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, KQZ-ja emëron me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar, të përzgjedhur sipas nenit 92 të këtij Kodi, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore...”*. 2. *Subjektet zgjedhore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni duhet të vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, sipas këtij Kodi.* Ndërsa neni 92 pika 4 parashikon *“...Buxheti për zgjedhjet duhet të parashikojë edhe fondin e nevojshëm për auditimin e subjekteve zgjedhore”*.

Eksperti kontabël i licensuar është një profesion i rregulluar dhe vepron brenda një kuadri të mirëpërcaktuar. Me Vendimin nr.109, datë 20.12.2014 të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve (IEKA), miratuar edhe me Vendimin nr.1, datë 09.03.2015 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, niveli referues i orëve të punës për totalin e të ardhurave deri në 70 milion është 30 ore, dhe duke ditur se tarifa normale orare e miratuar po nga Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve (IEKA) është 3000 lekë/ora atëherë fondi që duhej të programohej për këtë fushatë duhet të ishte shumë më i ulët se shpenzimi aktual. Nisur nga fakti që nga KQZ janë kontraktuar ekspertë kontabël për të cilët janë shpenzuar 4,239,000 lekë, nënkuptohet që Institucioni nuk ka patur një vlerësim të drejtë të fondit të përdorur për auditimin e fondeve të alokuara për zgjedhjet vendore 2015. Të dhënat tregojnë se për auditimin e subjekteve zgjedhore të cilat janë financuar me 83,333 lekë (40 subjekte politike) është paguar vlera 2,976,000 lekë që i korespondon 992 orë auditimi të faturuar nga ekspertët e kontraktuar, pra për vlerën e financimit prej 3,333,320 lekë është paguar 2,976,000 lekë si shpenzim auditimi. Gjithashtu për auditimin e 18 kandidatëve të pavarur të cilët nuk kanë deklaruar të ardhura por as dhe shpenzime për këto zgjedhje, është paguar vlera prej 1,293,000 lekësh (441 orë auditimi).

Nga vlerësimi i bërë Raporteve të Auditimit për disa subjekte zgjedhore përfitues të financimeve publike nga KQZ, konstatohet se nga ekspertët kontabël nuk rezulton të jenë bërë verifikime për të dhënat financiare të deklaruara. Në disa raste deklarohet pamundësi të auditimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të shumë subjekteve zgjedhore, pasi nuk kishin deklaruar në KQZ adresë të selisë, apo numër kontakti. Konstatuam 3 raste, ku raportet e auditimit janë hartuar vetëm në bazë të deklaratave të subjekteve zgjedhore, 1 rast ku raporti është hartuar ditën e deklarimit të subjektit zgjedhor dhe në dy raste është hartuar 1 ditë më vonë se deklarata e subjektit, fakt që tregon se ka formalitet në shërbimin e kryer (Kjo trajtohet më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja nr.19 deri në faqen nr.27).

**Për sa më sipër rekomandoj :**

Të nxirret përgjegjësia institucionale për programimin e fryrë të shpenzimeve të auditimit, si dhe të rriten kërkesat për një monitorim të kujdesshëm të shërbimit të auditimit të marrë për të eliminuar raste të pagesave për shërbim të pakryer.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

Në çdo rast për programimin e fondeve të auditimit të kihet parasysh kuadri rregullator i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, për të mundësuar realizimin e misioneve të auditimit në kushtet e efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore.

Nga ana e KQZ të kërkohet nga ekspertët të cilët kanë përfituar fonde për një shërbim të pakryer (për shkak se nuk kanë gjetur subjektet zgjedhore), kthimi i shumave në buxhetin e shtetit, kur është e mundur, dhe të mos kontraktohen më nga institucioni.

**Menjëherë**

4. Nga verifikimi i kryer në inventarin fizik për gjendjen fizike të aktiveve dhe të objekteve inventar konstatohet se, në magazinë gjenden sasira të konsiderueshme për mallra, materiale dhe objekte inventari të destinuara vetëm për veprimtaritë zgjedhore (parlamentare dhe vendore) që kanë si origjinë blerjet dhe furnizimet e kryera ndër vite, të cilat kanë jo vetëm kosto të lartë por edhe vlera përdorimi. Sipas inventarit fizik të kryer në magazinë në muajin janar 2015, KQZ disponon materiale dhe objekte zgjedhore në sasira të konsiderueshme të cilat sipas kontabilitetit llogariten në vlerën prej 208,529,995 lekë (36,640 copë kuti votimi të dimensioneve, formave dhe ngjyrave të ndryshme në vlerën prej 166,576,691 lekë, 188,692 copë kode dhe vula sigurie në vlerën prej 41,953,304 lekë). Sipas të dhënave historike të disponueshme në institucion për zgjedhjet e përgjithshme të Kuvendit nevojiten mesatarisht 8,000 kuti votimi, ndërsa për zgjedhjet e pushtetit vendor nevojiten mesatarisht rreth 12.000 copë kuti votimi, fakt që tregon menaxhim jo të drejtë të nevojave (*Kjo trajtohet më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja nr. 42 deri në faqen nr. 43*).

**Për sa më sipër rekomandoj:**

KQZ të marrë në analizë këtë problematikë të konstatuar nga auditimi dhe të vlerësojë masa konkrete për të mundësuar përdorimin e të gjitha materialeve që disponohen në magazinë. Ndërkohë të ketë një programim të kujdesshëm të nevojave në mënyrë që të mos ketë shpenzime të tepërta për administrimin e zgjedhjeve.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

5. Konstatohet se Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së është nëpunës Autorizues, sipas kërkesave të nenit 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe koordinatori i riskut, pasi kjo kompetencë nuk i është deleguar ndonjë nëpunësi tjetër. Konstatuam që nuk ka pasur një procedurë konkrete për formalizimin dhe dokumentimin e procedurave për menaxhimin e riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit. Për vitin 2014 nuk ka patur një regjistër risku për institucionin duke mos përmbushur kështu kërkesat e nenit 8, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ku shprehet qartë se "Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: *Hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ato drejtojnë, të planeve strategjike vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planveprimeve për arritjen e objektivave*". (*Kjo trajtohet më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja nr. 82 deri në faqen nr.98*).

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga ana e nëpunësit Autorizues të merren masa për ndërtimin e regjistrit të riskut me qëllim që të identifikohen, analizohen dhe kontrollohen risqet, në mënyrë që mos të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit dhe sidomos administrimin e procesit zgjedhor.





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, TIRANË

Menjëherë

6. Nga auditimi u konstatua se, Listëpagesat e dorëzuara në thesar nga ana e KQZ janë të nënshkruara nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe nga Drejtori i Financës por nuk janë të nënshkruara nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore në kundërshtim kjo me pikën 69, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Për pagesën e përfituar për raportet mjekësore gjatë viteve 2014 dhe 2015, rezultoi se nuk është mbajtur tatimi veprim që bie në kundërshtim me nenin 8 "E ardhura e tatueshme" pika "a" të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, dhe pika 2 "Tatimi mbi të ardhurat personale", pika 2.3 "Të ardhurat e tatueshme", pika 2.3.1 të Udhëzimit nr. 5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. (Kjo trajtohet më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja nr. 82 deri në faqen nr.98).

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga ana e KQZ të merren masa që Listë pagesat e punonjësve të administratës të nënshkruhen edhe nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore. Nga KQZ të taten përfitimet që vijnë nga raportet mjekësore të cilat paguhen nga llogaria 600 e institucionit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në vazhdimësi

### C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Sipas memorandumit të bashkëpunimit me nr. 518, datë 15.04.2014 midis KQZ dhe USAID është nënshkruar marrëveshja me kompaninë Maqedonase " " me objekt: "Të përshkruajë rolet, rezultatet dhe përgjegjësitë që lidhen me zbatimin e softëareve-it në programin AlbERT, përditësimin të administrimit të zgjedhjeve lokale për KQZ të planifikuara gjatë periudhës Prill-Shtator 2014".

Në përfundim të shërbimit të kryer nuk është llogaritur dhe ndalur tatimi në burim në masën 15 % mbi të ardhurat e realizuara në shumën prej 789,031 lekë, si subjekt i pa regjistruar në QKR për kohën që do ushtrojë këtë veprimtari dhe për sa kohë që nga ana e KQZ-së nuk janë plotësuar praktikatat për përfitimin e përjashtimit bazuar në Marrëveshjen e eliminimit të taksimit të dyfishtë midis Shqipërisë dhe Maqedonisë. Faturat e paraqitura nga shoqëria e kontraktuar janë të printuara në format letër model A4, pa asnjë të dhënë që të provojë miratimin nga shteti Maqedonas, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 4, germa "h", ku përcaktohet se: "të ardhurat e realizuara nga shërbimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një person jorezident", dhe neni 33, pika 4, ku përcaktohet se: "Një tatimpagues jorezident, i cili përfiton të ardhura si ato të përmendura në shkronjat "d", "dh" ose "e" të paragrafit të parë të këtij neni, mund të taten njëllor si në rastin kur këto të ardhura të ishin përfituar në ndjekjen e një veprimtarie të ndërmarrë prej tij nëpërmjet një njësie të përhershme në Republikën e Shqipërisë" dhe me udhëzimin e ministrit të financave nr. 5, datë 30.01.2006 "Për Tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar" me ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014, neni 9, "Tarifat tatimore", pika 2.4 "Të ardhura të tatueshme" ku është përcaktuar se, të ardhurat e tjera që nuk përfshihen ndryshe në dispozitat të tjera të këtij ligji taten në masën 15 % (Kjo trajtohet më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja nr. 37 deri në faqen nr.39).



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË KOMISIONIN QENDROR**  
**TË ZGJEDHJEVE, TIRANË**

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga KQZ të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **789,031 lekë** nga shoqëria "Maqedoni, për sa përfituar më tepër si rrjedhojë e mosndalimit të tatimit mbi të ardhurave e realizuara në projektin e realizuar me objekt: "Përshtatjen e zgjedhjeve vendore me modulet e zgjedhjeve parlamentare, të përshkruajë rolet, rezultatet dhe përgjegjësitë që lidhen me zbatimin e softwar-it në programin ALBERT".

**Menjëherë**

2. Nga auditimi për shpenzimet e kryera nëpërmjet veprimeve të bankës për periudhën objekt auditimi prej datës 01.01.2014 deri 31.12.2015, u konstatua se, Kryetare e KQZ-së znj. [Emri i kryetarit] përfituar bonus për shpenzime transporti gjithsej në vlerën prej 495,000 lekë, pagesë e cila nuk është bashkuar me pagën mujore dhe nuk është llogaritur dhe ndalur tatimi në burim në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, neni 9, "Tarifat tatimore" ku është përcaktuar se: "Pagat dhe shpërblimet, në lidhje me marrëdhëniet e punës aktuale, do të tatonen sipas tarifave të përshkruara në pasqyrën nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji, dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar ku përcaktohet se: "Tatimi mbi të ardhurat personale, përfshin të gjitha llojet e të ardhurave të individëve, të parashikuara në këtë ligj, neni 7 "Shtrirja e detyrimit", si rrjedhojë e këtij veprimi të ardhurat e përfituara nga bonusi nuk janë llogaritur dhe ndalur tatimi në burim në masën 23%, në vlerën prej **109,150 lekë** (Kjo trajtohet më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqen nr.39-40).

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga KQZ të merren masat procedurale administrative për të arkëtuar dhe derdhur detyrimin e tatimit mbi të ardhurat në vlerën prej **109,150 lekë** nga znj.

**Menjëherë**

## **D. DËM EKONOMIK PA MUNDËSI ARKËTIMI**

**Dëmi ekonomik i vlerësuar prej: 2,563,349.5 EURO**, është dëmi i shkaktuar fondeve buxhetore nga dështimi i dy projekteve të cilat do të hapnin rrugën për numërimin elektronik të rezultateve zgjedhore e konkretisht: Projekti, SEN Qarku Fier në vlerën prej: 966,752.5 EURO dhe për Projektin, SEV të Qarkut Tiranë në vlerën prej: 1,596,597 EURO.

**Shuma e konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit ka ardhur nga lidhja e kontratave në kapërcim të afateve ligjore si dhe lidhja e këtyre kontratave me kushte të favorshme për kontraktorin dhe të disfavorshme për shtetin, për të cilën nga auditimi është ngarkuar me përgjegjësi znj. [Emri i kontraktorit] si nënshkruese e këtyre kontratave (Kjo trajtohet më hollësisht në Pikën VI.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga faqja nr. 49 deri në faqen nr.83).**

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**